



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

---

# RAPORTI I GJELBËR 2023



# Raporti i Gjellbër i Kosovës 2023

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

20 Dhjetor, 2023

## Fjala hyrëse

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të planit të punës ka hartuar Raportin e Gjelbër 2023, raport i cili po publikohet për të 11<sup>-in</sup> vit me radhë dhe i cili ofron informacione për gjendjen e përgjithshme të sektorit të bujqësisë, për politikën dhe strategjitë zhvillimore, përkrahjen publike, shkëmbimin tregtar dhe shumë të dhëna tjera të cilat shërbejnë si tregues mbi zhvillimin e bujqësisë në vendin tonë.

Në Kosovë, bujqësia kontribuon në BPV-në e përgjithshme 7.4% apo 658 mil. € dhe llogaritet si një ndër sektorët më të rëndësishëm të vendit tonë. Duke përcjellë me vëmendje zhvillimet globale të cilat kanë shoqëruar ekonominë e secilit vend, e edhe atë të vendit tonë, ne kemi punuar që politikën tona t'i orientojmë në fushat ku vendi ka më shumë nevojë duke ofruar rritje në nivelin e përkrahjes për të krijuar një sektor sa më të qëndrueshëm.

MBPZHR gjatë këtij viti ka vazhduar realizimin e aktiviteteve për fuqizimin dhe promovimin e sektorit të bujqësisë. Kemi rritur mbështetjen e sektorit përmes programeve tona duke u përkushtuar që fermerët dhe bizneset tona të kenë mbështetjen maksimale dhe korrekte. Duke ju falënderuar kësaj mbështetje, gjatë këtij viti kemi pas rritje të rëndësishme të sipërfaqeve të mbjella. Kjo mbështetje ka ndikuar edhe në rritjen e eksportit të produkteve bujqësore dhe ushqimore. Për herë të parë, këtë vit kemi pas rënie të importit në sasinë e produkteve të importuara gjersa eksporti ka vazhduar të rritet.

Për herë të parë që kur ka filluar zbatimi i Programit të Zhvillimit Rural, me PZHR 2022 janë mbështetur të gjithë aplikuesit e suksesshëm për grante në bujqësi. Në këtë vit po ashtu është rritur përkrahja në formën e pagesave direkte, me çka kemi arritur të zbusim efektet negative të çmimeve të rritura të inputeve bujqësore, të shkaktuara si pasojë e Pandemisë COVID-19 por edhe për shkak të invazionit rus në Ukrainë. Tek disa kultura bujqësore, kjo përkrahje është rritur mbi 200% krahasuar me vitin paraprak.

Është punuar shumë në pjesën legjislative dhe si rezultat janë proceduar në Qeveri disa Ligje si dhe janë aprovuar shumë akte nënligjore të cilat mbështesin implementimin e politikave bujqësore dhe mundësojnë përkrahje më të madhe financiare në arritjen e shumë qëllimeve tona, duke kompletuar ciklin e zinxhirit në sektorin e bujqësisë. Janë miratuar:

1. Strategjia për Zhvillimin e Bujqësisë 2022 - 2028
2. Planit i Veprimit i Strategjisë për Zhvillimin e Bujqësisë - 2022-2024
3. Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë në Kosovë 2022-2030
4. Plani i Veprimit i Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë - 2022-2024.

MBPZhR, në kuadër të aktiviteteve të saj me partnerët ndërkombëtar, e ka ngritur nivelin e bashkëpunimit me ç'rast janë nënshkruar një varg marrëveshjesh dhe memorandume bashkëpunimi.

Mbesim të përkushtuar gjithnjë e më shumë në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit si dhe arritjen e objektivave tona strategjike, me qëllim që t'i fuqizojmë edhe më tutje kapacitetet e sektorëve nën përgjegjësinë tonë.

Faton Peci  
Ministër



## Hyrje

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas planit të punës ka vazhduar edhe këtë vit me publikimin e Raportit të Gjellbër për vitin 2023. Raporti i Gjellbër vazhdon të mbetet një prej raporteve më të rëndësishme në sektorin e bujqësisë në nivel vendi, tashmë për 11 vite me radhë.

Si një Raport i cili pasqyron gjendjen e sektorit të bujqësisë në vendin tonë, Raporti i Gjellbër 2023, në përmbajtjen e tij vazhdon që në kaptinat e tij të paraqes të dhënat për mjedisin e përgjithshëm ekonomik, prodhimin bujqësor dhe përdorimin e tij, pylltarinë, tregtinë, sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, politikat bujqësore të cilat përfshijnë pagesat direkte/subvencionet si dhe përkrahjen e zhvillimit rural/grantet investive, si dhe pjesën e shtojcave e cila përmban të dhëna mbi legjislacionin. Të gjitha këto të dhëna ofrohen të përmbledhura dhe të përpunuara në bashkëpunim me të gjitha departamentet dhe agjencitë brenda MBPZhR-së, si dhe institucionet dhe agjencitë tjera jashtë ombrellës së ministrisë.

Gjithë këta akterë të cekur më lartë të cilët kontribuojnë në kaptinat e fushave të tyre në kuadër të Raportit të Gjellbër, ndihmojnë që ky raport të jetë sa më i kompletuar deri në aprovimin final të tij nga ana e Ministrit.

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore përbërë nga **(Delvina Hana Bakija, Hakile Xhaferi, Adelina Maksuti, Skender Bajrami, Belgin Dabiqaj dhe Shkëlqim Duraku)**, i cili harton dhe e publikon Raportin e Gjellbër, vazhdonë të jetë i përkushtuar që raporti të jetë sa më përmbajtësor dhe në shërbim të sektorit, si i vetmi burim mbi gjendjen e statistikave bujqësore në vend. Gjithashtu këtë vit kontribut në përgatitjen e Raportit të Gjellbër kanë dhënë edhe Kreshnike Arifi (pjesë e DAESB-së deri në Gusht 2023) dhe studentja Yllka Dibrani nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë e angazhuar si praktikante për një periudhë të caktuar në DAESB.

Synimi ynë është të vazhdojmë të punojnë me përkushtim maksimal dhe njëherit u jemi falënderues gjithë lexuesve dhe shfrytëzuesve të cilët në çfarëdo mënyre japin kontributin e tyre në Raportin e Gjellbër.

Delvina Hana Bakija



Drejtoreshë e Departamentit të Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore

# Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave.....	7
Lista e figurave.....	10
Lista e shkurtesave.....	12
<b>1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik .....</b>	<b>14</b>
1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik.....	16
1.2 Puna dhe punësimi.....	17
1.3 Llogaritë ekonomike në bujqësi.....	19
1.3.1 Prodhimet bujqësore .....	19
1.3.2 Të ardhurat sipërmarrëse .....	22
1.3.3 Inputet në bujqësi .....	23
1.4 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore .....	25
1.4.1 Çmimet e inputeve bujqësore .....	25
1.4.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore .....	27
Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore .....	27
Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore .....	28
Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore .....	30
Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së.....	32
1.5 Privatizimi i tokave bujqësore .....	34
1.6 Bizneset bujqësore – Agroindustria .....	37
<b>2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij.....</b>	<b>41</b>
2.1 Përdorimi i tokës bujqësore.....	41
2.2 Prodhimtaria bimore.....	44
2.2.1 Drithërat.....	44
2.2.2 Perimet.....	47
2.2.3 Pemët.....	53
2.2.4 Vreshtat dhe verërat.....	58
Vreshtat.....	58
Verërat.....	63
Analizat fiziko - kimike të verës.....	65
2.2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra.....	66
2.2.6 Kulturat industriale.....	67
2.3 Ujitja e tokës bujqësore .....	68
2.4 Blegtoria.....	70
2.4.1 Gjedhet.....	70
2.4.2 Dhentë dhe dhitë .....	72
2.4.3 Derrat dhe kafshët tjera të fermës.....	72
2.4.4 Shpezëtaria .....	73
2.4.5 Bletaria .....	74
<b>3 Pylltaria .....</b>	<b>75</b>
<b>4 Tregtia dhe trendet e konsumit .....</b>	<b>85</b>
4.1 Trendet e konsumit .....	85
4.2 Tregtia e përgjithshme .....	87
4.3 Tregtia e produkteve bujqësore .....	87

4.3.1 Tregtia sipas grupeve të shteteve .....	89
Tregtia me vendet e CEFTA-s.....	89
Tregtia me vendet e BE-së.....	92
Tregtia me vendet e treta .....	94
4.3.2 Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24).....	96
Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24).....	96
Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24).....	97
<b>5 Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit .....</b>	<b>98</b>
5.1 Emetimi i gazrave serrë .....	102
<b>6 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural .....</b>	<b>107</b>
6.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve.....	107
6.2 Pagesat Direkte/Subvencionet .....	109
6.2.1 Pagesat Direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor.....	115
Primi i sigurimit bujqësor .....	119
6.2.2 Pagesat Direkte për blegtori dhe qumësht .....	119
6.2.3 Mbështetja e inputeve në bujqësi.....	122
Mbështetja e fidanëve.....	122
Mbështetja për naftë .....	122
Mbështetja për pleh .....	122
6.3 Agro Kreditë dhe fondi garantues .....	123
6.3.1 Agro Kreditë.....	123
6.3.2 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – FKGK.....	127
6.4 Sigurimet në fushën e bujqësisë.....	128
Zhvillimi dhe Shitja e Produkteve Indeks të Sigurimit Bujqësor .....	128
Dëmet/ humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit .....	130
Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.....	130
Kampanjat Publike Vetëdijësuese .....	131
Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore.....	132
6.5 Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive .....	132
6.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve .....	135
Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor.....	135
Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor .....	137
6.7 Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare .....	138
<b>7 Shtojcat.....</b>	<b>139</b>
7.1 Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural .....	139
Legjislacioni kombëtar në fuqi për vitin 2022.....	139
7.1.1 Ligjet e miratuara gjatë vitit 2022 .....	139
7.1.2 Udhëzimet Administrative të miratuara në vitin 2022.....	140
7.2 Personat përgjegjës për Raportin e Gjellbër, 2023 .....	142

## Lista e tabelave

Tabela 1:	Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale, në '000 €.....	15
Tabela 2:	Indikatorët kryesor të tregut të punës sipas variablave, 2021-2022 (%).....	18
Tabela 3:	Shkalla e punësimit dhe e papunësisë, 2021-2022 (%).....	19
Tabela 4:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2022, (2015=100).....	26
Tabela 5:	Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2016-2022.....	26
Tabela 6:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg.....	29
Tabela 7:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg.....	30
Tabela 8:	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg.....	31
Tabela 9:	Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg.....	32
Tabela 10:	Çmimet e disa prodhimeve në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2022, €/kg.....	33
Tabela 11:	Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë, sipas regjioneve, 2005-2022.....	34
Tabela 12:	Shitja e tokave bujqësore, 2005-2022.....	36
Tabela 13:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2018-2022.....	37
Tabela 14:	Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2018-2022.....	38
Tabela 15:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2022.....	39
Tabela 16:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, ha.....	41
Tabela 17:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2018-2022.....	44
Tabela 18:	Bilanci i furnizimit për grurin, 2018-2022.....	45
Tabela 19:	Bilanci i furnizimit për misrin, 2018-2022.....	46
Tabela 20:	Sipërfaqja me perime, 2018 - 2022.....	47
Tabela 21:	Prodhimi i perimeve, 2018 - 2022.....	48
Tabela 22:	Rendimenti i perimeve, 2018 - 2022.....	49
Tabela 23:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave të dyta pas korrjes së parë.....	50
Tabela 24:	Bilanci i furnizimit për domaten, 2018-2022.....	51
Tabela 25:	Bilanci i furnizimit për specin, 2018-2022.....	52
Tabela 26:	Bilanci i furnizimit për pataten, 2018-2022.....	53
Tabela 27:	Sipërfaqja dhe prodhimi i pemëve, 2018 - 2022.....	54
Tabela 28:	Rendimenti i pemëve, 2018 - 2022.....	55
Tabela 29:	Bilanci i furnizimit për mollën, 2018-2022.....	56
Tabela 30:	Bilanci i furnizimit për kumbullën, 2018-2022.....	57
Tabela 31:	Bilanci i furnizimit për dredhëzën, 2018-2022.....	58
Tabela 32:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i rrushit, 2018-2022.....	58
Tabela 33:	Bilanci i furnizimit për rrush tryeze, 2018-2022.....	60
Tabela 34:	Varietetet e rrushit të tryezës, 2022.....	61
Tabela 35:	Varietetet e rrushit të verës, 2022.....	62
Tabela 36:	Prodhimi i verës 2018-2022, '000 litra.....	63
Tabela 37:	Prodhimi i verës sipas kompanive, 2022.....	64
Tabela 38:	Analizat fiziko - kimike të verës për periudhën 2018 - 2022.....	65
Tabela 39:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra, 2018-2022.....	66



Tabela 40:	Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave industriale, 2018-2022.....	67
Tabela 41:	Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2022 .....	68
Tabela 42:	Format e ujitjes dhe sasia e përgjithshme e ujit të shpenzuar në sip. e tokave bujqësore në Kosovë, 2022 .....	69
Tabela 43:	Fondi dhe struktura e gjedheve, 2018-2022.....	70
Tabela 44:	Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2018-2022.....	71
Tabela 45:	Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2018-2022 .....	71
Tabela 46:	Numri i dhenve dhe dhive, 2018-2022.....	72
Tabela 47:	Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2018-2022 .....	72
Tabela 48:	Numri i shpezëve dhe vezëve 2018-2022, në '000.....	73
Tabela 49:	Numri i koshereve të bletëve, 2018-2022 .....	74
Tabela 50:	Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit (ha) .....	75
Tabela 51:	Tabela mbi licencat.....	78
Tabela 52:	Pëlqimet për themelim, dhënia në menaxhim dhe PM .....	79
Tabela 53:	Hartimi i Planeve Menaxhuese në vitin 2022 .....	80
Tabela 54:	Planifikimi vjetor në pyjet shtetërore, m <sup>3</sup> .....	80
Tabela 55:	Realizimi i planit në shfrytëzim në pyjet shtetërore, m <sup>3</sup> .....	80
Tabela 56:	Planifikimi dhe realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore 2022 sipas DKR .....	81
Tabela 57:	Plani i shfrytëzimit të pyjeve në pronën private në m <sup>3</sup> , 2022.....	81
Tabela 58:	Realizimi i aktiviteteve në pyjet private, 2022 .....	82
Tabela 59:	Kallëzimet apo fletëparaqitjet e ngritura për Janar - Dhjetor 2022 .....	83
Tabela 60:	Paraqitja e materialit drunorë të konfiskuar nga prerësit e paligjshëm .....	83
Tabela 61:	Paraqitja e rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqet pyjore të përfshira në vitin 2022 .....	84
Tabela 62:	Prodhimtaria e fidanëve, 2022 .....	84
Tabela 63:	Konsumi i përgjithshëm në Kosovë, 2022 .....	85
Tabela 64:	Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit, 2022.....	85
Tabela 65:	Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë, 2022 (%).....	86
Tabela 66:	Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, 2022 (%) .....	86
Tabela 67:	Eksporti-Importi i përgjithshëm, në '000 €.....	87
Tabela 68:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, në '000 €.....	87
Tabela 69:	Eksporti, Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2022 në '000 € .....	89
Tabela 70:	Eksporti- Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në '000 € .....	90
Tabela 71:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, në '000 €.....	91
Tabela 72:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së, në '000 €.....	92
Tabela 73:	Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 € (majtas) dhe Eksporti sipas vendeve të BE-së në % (djathtas) .....	93
Tabela 74:	Importi sipas vendeve të BE-së, në '000€ (majtas) dhe Importi sipas vendeve të BE-së në % (djathtas) .....	94
Tabela 75:	Eksporti dhe Importi nga Vendet e Treta, në '000 €.....	94
Tabela 76:	Eksporti i produkteve bujqësore 2018-2022, në '000 € .....	96
Tabela 77:	Importi i produkteve bujqësore 2018-2022, në '0000 €.....	97
Tabela 78:	Shpërndarja e vaksinave sipas sëmundjeve të kafshëve .....	98

Tabela 79:	Marrja e mostrave të gjakut për analiza laboratorike .....	98
Tabela 80:	Asgjësimi i kafshëve sipas sëmundjeve infektive .....	99
Tabela 81:	Lëshimi i lejeve të importit.....	99
Tabela 82:	Licencimi i subjekteve afariste.....	99
Tabela 83:	Aktivitetet e inspektoriati gjatë vitit 2022.....	100
Tabela 84:	Aktivitetet e sektorit fitosanitar kufitar .....	100
Tabela 85:	Aktivitetet e kryera nga sektori i mikrobiologjisë së ushqimit.....	100
Tabela 86:	Mostrat e testuara në sektorin e kimisë ushqimore .....	101
Tabela 87:	Parametrat e testuar sipas aparaturave .....	101
Tabela 88:	Lloji dhe numri i analizave të sektorit të patologjisë .....	101
Tabela 89:	Numri i mostrave të testuara, 2022 .....	102
Tabela 90:	Emetimet bujqësore dhe emetimet e parashikuara në disa vende të BE-së.....	104
Tabela 91:	Emetimet GHG nga sektori i bujqësisë në Kosovë, 2021 .....	105
Tabela 92:	Pagesat direkte për njësi, PPD 2022 .....	108
Tabela 93:	Pagesat direkte 2018-2022, në € .....	111
Tabela 94:	Pagesat direkte sipas gjinisë në vitin 2022, në € .....	113
Tabela 95:	Pagesat direkte sipas tipit të fermerit në vitin 2022, në € .....	114
Tabela 96:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2018-2022.....	116
Tabela 97:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2018-2022.....	119
Tabela 98:	Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2022.....	122
Tabela 99:	Agro kreditë 2018 – 2022 .....	124
Tabela 100:	Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara, 2021.....	127
Tabela 101:	Produktet e Sigurimit Indeks dhe tradicional për Kosovë për vitin 2022.....	129
Tabela 102:	Buxheti i paraparë i PZhR, 2022 .....	133
Tabela 103:	Projektet e miratuara PZhR, 2022.....	134
Tabela 104:	Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative .....	136
Tabela 105:	Aktivitetet e zhvilluara në terren nga këshilltarët .....	136
Tabela 106:	Kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural.....	137

## Lista e figurave

Figura 1:	Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2018-2022, (në %) .....	16
Figura 2:	Indikatorët kryesor të tregut të punës, 2021-2022 (%) .....	18
Figura 3:	Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2018-2022 .....	20
Figura 4:	Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2022.....	20
Figura 5:	Shitja e mishit sipas llojeve të kafshëve (majtas) dhe produkteve tjera blegtorale (djathtas), 2022 .....	21
Figura 6:	Prodhimet bimore në mil. €, 2018-2022 .....	21
Figura 7:	Blegtoria në mil. €, 2018-2022.....	22
Figura 8:	Produktet blegtorale në mil. €, 2018-2022.....	22
Figura 9:	Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2018-2022 .....	23
Figura 10:	Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2018-2022.....	23
Figura 11:	Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2022 .....	24
Figura 12:	Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2022.....	24
Figura 13:	Indeksi vjetor i çmimeve të inpueteve bujqësore 2015-2022, (2015=100).....	25
Figura 14:	Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg .....	28
Figura 15:	Çmimi mesatar për sipërfaqet e shitura të tokave bujqësore dhe vlera totale e shitjeve 2005-2022 .....	35
Figura 16:	Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2022.....	35
Figura 17:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2018-2022.....	38
Figura 18:	Qarkullimi, numri i të punësuarve dhe numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë sipas regjioneve (%), 2022.....	39
Figura 19:	Tokë e punueshme - ara dhe livadhe e kullosa .....	42
Figura 20:	Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave .....	42
Figura 21:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2022 .....	43
Figura 22:	Sipërfaqja e vreshtave në ha, 2018-2022.....	59
Figura 23:	Prodhimi i rrushit në tonë, 2018-2022.....	59
Figura 24:	Prodhimi i verës 2018-2022, '000 litra .....	63
Figura 25:	Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës).....	75
Figura 26:	Eksport, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në '000 € .....	88
Figura 27:	Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm (djathtas).....	88
Figura 28:	Eksporti sipas grupeve të shteteve (majtas), Importi sipas grupeve të shteteve (djathtas), 2022 në % .....	89
Figura 29:	Pjesëmarrja e CEFTA-s në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e CEFTA-s në importin bujqësor (djathtas).....	90
Figura 30:	Eksporti sipas vendeve të CEFTA-s (majtas), Importi sipas vendeve të CEFTA-s (djathtas), 2022.....	91
Figura 31:	Pjesëmarrja e BE-së në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e BE-së në importin bujqësor (djathtas) .....	92
Figura 32:	Eksporti në Vendet e Treta, (majtas) dhe Importi nga Vendet e Treta (djathtas), në % .....	95
Figura 33:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2022.....	109
Figura 34:	Pagesat direkte 2018-2022, në 1000 €.....	109
Figura 35:	Rritja e pagesave direkte për njësi në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 .....	110
Figura 36:	Pagesat direkte sipas sektorëve 2022, në mil. € .....	112

Figura 37:	Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë në vitin 2022 .....	112
Figura 38:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas gjinisë në vitin 2022.....	112
Figura 39:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas tipit të fermerit në vitin 2022 .....	114
Figura 40:	Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2022 .....	118
Figura 41:	Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2022 .....	118
Figura 42:	Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2022 .....	121
Figura 43:	Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2022.....	121
Figura 44:	Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000).....	124
Figura 45:	Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. € .....	125
Figura 46:	Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 € .....	126
Figura 47:	Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, % .....	126
Figura 48:	Proporcioni i shpërndarjes së kredive, % .....	128
Figura 49:	Sipërfaqja totale e siguruar në ha dhe nr. i fermerëve të siguruar .....	130

## Lista e shkurtesave

AEB	Anketa e Ekonomive Bujqësore
AFK	Agjencia për Financim në Kosovë
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimi të Biznesve
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AZhB	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
BE	Bashkimi Evropian
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka Private për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BVSH	Bruto Vlera e Shtuar
CEFTA	Marrëveshja për tregti të lirë me vendet e Evropës Qendrore
CNVP	Lidhja e Vlerave Natyrore dhe Njerëzve
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
DKR	Drejtoritë Koordinuese Rajonale
DPBT	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve
DShKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike
DVV	Departamenti i Vertarisë dhe Vreshtarisë
ESR	Rregullorja e BE-së për Ndarjen e Përpjekjeve
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Gg	Giga gram
GHG	Emetimi i gazrave serrë
GLV	Grupe Lokale të Veprimit
IFP	Institucione Financiare Partnere
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IMF	Institucionet Mikro Financiare
INP	Inventarizimi Nacional i Pyjeve
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
IRF	Institucione të Regjistruara Financiare
IFC	Korporata Ndërkombëtare Financiare
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KASH	Koeriza Afatmesme e Shpenzimeve
KEP	Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës
KRK	Kreditimi Rural i Kosovës
KGMAMF	Kosovo Grameen Mission Arcobaleno Microcredit Fund
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NEET	As në Arsim, Punësim e as në Aftësim
NIF	Numri Identifikues i Fermës
NLB	NLB Banka
NSH	Ndërmarrja Shoqërore
PBZHR	Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
PCB	Procredit Bank
PM	Plane Menaxhuese
PPD	Programi i Pagesave Direkte
PPJD	Produkte pyjore jo drusore
PT	Testi i Aftësisë (Proficiencës)

PZhR	Programi i Zhvillimit Rural
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
QIKK	Qendrat Informative Këshilluese Komunale
RBKO	Raiffeisen Bank
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SISB	Sistemi Informativ i Sigurimit Bujqësor
SZhP	Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve
SKKBZhR	Strategjia Kombëtare e Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
TBC	Sëmundja e Tuberkulozit
TEB	Banka Ekonomike Turke
UA	Udhëzim Administrativ
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VGJP	Vendgjetitë e përbashkëta
WVI	KosInvest World Vision

# 1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik

Kosova si çdo vend në mbarë globin, gjatë vitit 2022 ka vazhduar të përballet me pasojat e çështjeve globale të cilat e kanë shoqëruar ekonominë e secilit vend, qoftë përmes rritjes së çmimeve, qoftë përmes politikave monetare dhe ndryshimeve tjera të cilat janë reflektuar si pasojë e këtyre krizave. Mirëpo, pavarësisht sfidave dhe problemeve të dhënat tregojnë se rritja reale për vitin 2022 ishte 5.2%.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2022, të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 2.48 mld. €, që paraqet një rritje vjetore prej 13.7%. Kjo rritje i atribuohet normës së lartë të inflacionit dhe përpjekjeve të ndërmarra për formalizimin e ekonomisë. Shpenzimet buxhetore po ashtu shënuan rritje prej 10.5% dhe arritën vlerën prej 2.49 mld. €. Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 0.1% të BPV-së. Në kuadër të të hyrave tatimore, të gjitha kategoritë kanë shënuar rritje. Rritja më e lartë është shënuar tek të hyrat tatimore direkte, të cilat arritën vlerën prej 413.8 mil. €, dhe të hyrat tatimore indirekte që shënuan rritje prej 12.3% dhe arritën vlerën 1.87 mld. €. Të hyrat jo tatimore shënuan rritje prej 13% në vlerë prej 266.8 mil. €. Sa i përket shpenzimeve buxhetore, kategoria që shënoi rritje më të lartë ishte ajo e shpenzimeve rrjedhëse të cilat shënuan rritje prej 13%, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rënie të lehtë prej 0.1%.

Sa i përket inflacionit, mesatarja vjetore në vitin 2022 shënoi 11.6%. Duke kalkuluar këtu edhe vlerën e mallrave ushqimore dhe energjetike në shportën e konsumatorit, që ishin ndër shkaktarët kryesor të përshpejtimit të inflacionit për vitin 2022, e që u përkthyen në çmime të ngritura të importit dhe rrjedhimisht konsumit<sup>1</sup>.

Gjatë vitit 2022 Bruto Produkti Vendor (BPV) ka shënuar rritje për 5.2%. BPV për kokë banori shënoi 5,037 €, ndërsa BPV me çmime aktuale në vitin 2022 ishte 8,936 mil. €.

Aktivitetet ekonomike me rritje reale gjatë vitit 2022 ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (10.8%), Informimi dhe komunikimi (9.2%), Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (7%), Aktivitetet administrative dhe mbështetëse (6.7%), Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (6.4%), Industria përpunuese (5.6%), Transporti dhe magazinimi (5.4%), Arti, zbavitja dhe rekreacioni (4.7%), Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi (4.5%), Afarizmi me pasuri të patundshme (4.1%), Hotelet dhe restorantet (3.7%), Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale (3.6%), Edukimi (3.2%), Furnizimi me ujë (3%), Industria nxjerrëse (2.9%), Shërbimet tjera (2.6%) dhe Furnizimi me energji elektrike dhe me gaz (1.4%). Ndërsa aktivitetet ekonomike me rënie gjatë vitit 2022 ishin: Ndërtimtaria (3.1%), Administrimi publik dhe i mbrojtjes dhe Sigurimi i detyrueshëm social (0.5%).

---

<sup>1</sup> BQK-Raporti vjetor 2022

Rritje reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2022, kishte tek kategoritë: Importi i shërbimeve (21.3%), Eksporti i shërbimeve (20%), Eksporti i mallrave (16.1%), Shpenzimet e konsumit final (4%), Importi i mallrave (2.2%) dhe Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (0.2%). Kurse, komponentët kryesorë të BPV-së me rënie ishin: Ndryshimet në inventar (10.6%) dhe Formimi i kapitalit bruto (3.8%).

**Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale, në '000 €**

Aktiviteti	2018	2019	2020	2021	2022
A Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	435,728	510,773	498,526	550,948	657,626
B Industria nxjerrëse	145,613	141,292	134,574	148,345	137,493
C Industria përpunuese	875,803	907,614	904,149	1,025,892	1,177,447
D Furnizimi me energji elektrike, me gaz	233,085	238,927	264,917	288,349	338,570
E Furnizimi me ujë	47,734	46,478	43,089	45,905	49,219
F Ndërtimtaria	559,677	577,092	519,420	675,879	761,288
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	833,724	900,211	867,439	1,084,213	1,278,434
H Transporti dhe magazinimi	298,045	309,376	262,999	341,917	395,463
I Hotelet dhe restorantet	129,050	146,705	110,855	163,847	188,105
J Informimi dhe komunikimi	124,441	130,784	134,577	150,124	178,262
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	237,273	272,558	277,337	294,751	348,642
L Afarizmi me pasuri të patundshme	474,820	490,441	493,438	512,555	544,622
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	97,762	99,929	107,358	113,918	121,612
N Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	49,338	52,125	49,589	54,486	58,984
O Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	386,556	419,183	444,284	436,988	448,001
P Edukimi	254,655	258,019	257,380	270,776	274,076
Q Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	143,698	154,599	180,459	184,884	184,744
R Art, zbavitje dhe rekreacion	28,855	17,284	13,228	14,228	14,361
S Shërbime tjera	23,935	25,245	26,905	27,760	28,472
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës	-	-	-	-	-
BVSH me çmime bazë	5,379,793	5,698,635	5,590,522	6,385,766	7,185,421
Tatimet në produkte	1,341,373	1,419,039	1,278,134	1,654,901	1,856,280
Subvencionet në produkte	(49,644)	(61,502)	(97,055)	(82,791)	(105,525)
<b>Bruto Produkti Vendor</b>	<b>6,671,522</b>	<b>7,056,172</b>	<b>6,771,601</b>	<b>7,957,876</b>	<b>8,936,177</b>


Burimi: ASK - Bruto Produkti Vendor 2018-2022

Të dhënat e publikuara nga ASK mbi bruto produktin vendor sipas aktiviteteve ekonomike, tregojnë për pjesëmarrjen e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor.

Nëse analizojmë pjesëmarrjen e kategorisë apo aktivitetit të bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe peshkimit, vërejmë se pjesëmarrja më e madhe e bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe peshkimit për periudhën 2018-2022, në Bruto Produktin Vendor ishte në vitin 2020 dhe 2022 nga (7.4%), pasuar nga viti 2019 që ishte 7.2%, dhe viti 2021 me pjesëmarrje prej 6.9%. Ndërsa, pjesëmarrje më e ulët e kësaj kategorie apo aktiviteti në Bruto Produktin Vendor për periudhën 2018-2022, paraqitet në vitin 2018 me 6.5%.



**Figura 1: Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2018-2022, (në %)**



Burimi: ASK - Bruto Produkti Vendor 2018-2022

## 1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik

Nisur nga fakti se sektori i bujqësisë ka luajtur dhe vazhdon të luaj një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, dhe duke pasur parasysh situatën me krizat e fundit globale, është vërejtur se bujqësia ka një rol kyç dhe është e ndërlidhur me secilën hallkë të sistemit të zhvillimit ekonomik.

Në Kosovë bujqësia kontribuon në BPV 7.4%, apo 658 mil. €. Nëse i referohemi sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore për vitin 2022, sipas të dhënave të raportuara nga ASK ishte 420,482 ha, nga ku pjesa më e madhe prej 51.6% përbëhet nga kategoria livadhe dhe kullota, pasuar nga toka e punueshme me përqindje prej 44.8%, si dhe përqindja prej 3.6% apo 15,079 ha që janë: kopshtet, plantacionet e pemëve, vreshtave dhe fidanishtet.

Sa i përket mbështetjes që MBPZhR e ofron përmes dy programeve vjetore, atij për Pagesa Direkte/subvencione dhe Programit për Zhvillim Rural/grantet investive gjatë vitit 2022, referuar Programit të Pagesave Direket/subvencioneve janë përkrahur gjithsej 26 kategori me gjithsej buxhet të shpenzuar prej 57.5 mil. €, që në raport me vitin 2021 mbështetja pothuajse është dyfishuar.

Ndërsa sa i përket Programit të Zhvillimit Rural/granteve investive, ku për vitin 2022 janë mbështetur Masa 1, Masa 3, Masa 5 dhe Masa 7, me një shumë totale të projekteve të miratuara prej 24.2 mil. €, si mbështetje publike në raport me shumën e përgjithshme të projekteve prej 36 mil. €.

Lidhur me shkëmbimin tregtar të Kosovës me vendet tjera, në vitin 2022 vlera e eksportit të produkteve bujqësore ishte 118.9 mil. €, që paraqet rritje prej 28.4% në krahasim me vitin paraprak. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ pasi që vlera e importit në vitin 2022 ishte rreth 1.2 mld €, me rritje prej 24.0% në krahasim me vitin 2021.

Përkundër rëndësisë së madhe që ka zhvillimi i bujqësisë për sigurimin e ushqimit në vendin tonë dhe zhvillimin e zonave rurale, për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori vazhdojnë

të paraqiten sfida të shumta, si infrastrukturë jo e zhvilluar, qasje e pamjaftueshme në tregje, aplikimi jo i mjaftueshëm i teknologjisë dhe cilësia e arsimit dhe shërbimit social. Niveli i zhvillimit rural ndërlihet me procesin e përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve që jetojnë në zonat rurale, përmes shfrytëzimit të burimeve natyrore, si bujqësia dhe pylltaria si dhe aktivitetet tjera.

## **1.2 Puna dhe punësimi**

Të dhënat e fundit na tregojnë se afërsisht dy të tretat e popullsisë së Kosovës janë në moshë pune, dhe angazhohen në tregun e punës në mënyre aktive (të punësuar apo të pa punësuar). Duke ju referuar shifrave të fundit sipas analizave pritet që popullsia në moshë pune në Kosovë të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme, pasi që vazhdojmë të cilësohemi si një ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë.

Nisur nga kjo që u cek më lartë, dhe bazuar në të dhënat e fundit popullsia në moshë pune apo shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë është 38.6% apo 461,894 persona, nga ku 12.6% apo 58,081 persona janë të papunë. Nga përqindja totale e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore prej 38.6%, femrat përbëjnë 22% të fuqisë punëtore, ndërsa meshkujt përbëjnë 55.5%. Kurse në përgjithësi 61.4% e popullsisë në moshë pune, është joaktive.

Nëse i referohemi punësimit sipas aktiviteteve për vitin 2022, sektorët si tregtia, arsimi, ndërtimtaria, prodhimi dhe administrata publike vazhdojnë të punësojnë numrin më të madh të personave.

Ndërsa nëse referohemi sipas gjinisë sektorët si arsimi, tregtia dhe kujdesi shëndetësor punësojnë 55.6% të femrave, ndërsa sektorët si tregtia, ndërtimtaria dhe prodhimi janë sektorët të cilët mbulohen më shumë nga meshkujt duke punësuar 44.2% të personave të punësuar në Kosovë.

Sipas sektorëve përqindja e gjithsej personave të punësuar në vendin tonë është si në vijim: tregtia punëson 19.3%, ndërtimtaria 11%, arsimi 10.8%, prodhimi 8.9% dhe administrata publike dhe mbrojtja me 8.1%.


**Tabela 2: Indikatorët kryesor të tregut të punës sipas variablave, 2021-2022 (%)**

Indikatorët kryesorë të tregut të punës	2021			2022		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	56.6	22.0	39.3	55.5	22.0	38.6
Shkalla e joaktivitetit	43.4	78.0	60.7	44.5	78.0	61.4
Raporti punësim ndaj popullsisë - shkalla e punësimit	45.9	16.5	31.1	49.4	18.4	33.8
Shkalla e papunësisë	19.0	25.0	20.7	11.0	16.5	12.6
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	33.7	46.5	38.0	18.6	27.0	21.4
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	31.8	32.4	32.1	32.2	33.8	33.0
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm	14.9	6.8	12.7	15.7	6.9	13.3

Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '21, '22

Nëse analizojmë indikatorët kryesorë të tregut të punës mes vitit 2021 dhe 2022, vërehet se shkalla e punësimit në vitin 2022 ishte pak më e lartë (33.8%), për dallim nga viti 2021 që ishte 31.1%. Sa i përket indikatorit të shkallës së papunësisë ky indikator për vitin 2022 ishte 12.6%, ndërsa për vitin 2021 ishte 20.7%, indikatorin e papunësisë tek të rinjtë e grup moshës (15-24) vjeç gjatë viti 2022 shënoj 21.4%, kurse gjatë vitit 2021 ishte 38.0%. Pasuar nga indikatorë të tjerë të cilët variojnë në përqindje të vogla apo me ndonjë dallim jo shumë të madh mes viteve 2021 dhe 2022.

**Figura 2: Indikatorët kryesor të tregut të punës, 2021-2022 (%)**



Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '21, '22

Të dhënat lidhur me shkallën e punësimit dhe të papunësisë sipas grup moshave tregojnë se në vitin 2022, krahasuar me vitin paraprak (2021), shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka shënuar rënie për 0.7 pikë %.

Në vitin 2022, shkalla e punësimit ishte 33.8%, ndërsa shkalla e papunësisë ishte 12.6%, dhe shkalla e pasivitetit ishte 61.4%.

**Tabela 3: Shkalla e punësimit dhe e papunësisë, 2021-2022 (%)**

Grup moshë	Shkalla e punësimit		Shkalla e papunësisë	
	2021	2022	2021	2022
15-24	13.4	15.4	38.0	21.4
25-34	38.8	42.1	25.9	16.9
35-44	40.4	44.8	17.3	11.1
45-54	37.7	39.3	13.9	8.3
55-64	32.1	32.1	7.7	5.1
<b>15-64</b>	<b>31.1</b>	<b>33.8</b>	<b>20.7</b>	<b>12.6</b>

Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '21, '22

### **1.3 Llogaritë ekonomike në bujqësi**

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi kanë për qëllim të paraqesin vlerën e produkteve dhe shërbimeve bujqësore të prodhuara gjatë vitit kontabël që janë shitur nga njësitë bujqësore apo janë mbajtur në stoqet e fermës, apo dhe janë përdorur për përpunim të mëtejshëm nga ana e prodhuesve bujqësor. Gjithashtu kanë edhe për qëllim të prezantojnë zhvillimin ekonomik në fushën e bujqësisë në mënyrë që të përdoret si bazë për vlerësimin e ndryshimeve të politikave të sektorit bujqësor.


Llogaritë Ekonomike për Bujqësi paraqesin të dhëna të cilat përdoren për të llogaritur treguesit e të ardhurave për sektorin e bujqësisë dhe raportojnë vlerat e prodhimit dhe shpenzimet, si me çmimet e prodhimit ashtu dhe me çmimet bazë.

#### **1.3.1 Prodhimet bujqësore**

Prodhimet bimore për vitin 2022 llogariten 654 mil. €, apo vlerë 23% më e lartë krahasuar me vitin 2021 (532 mil. €), kjo rritje i dedikohet rritjes së vlerës së prodhimit të drithërave, bimëve foragjere, perimeve dhe prodhimeve të kopshtit, si dhe pemëve dhe patateve. Kurse, sa i përket prodhimeve blegtorale vlera e tyre llogaritet 315 mil. €, apo 14% më e lartë krahasuar me vitin 2021 (277 mil. €).

Nëse i referohemi figurës së mëposhtme ku paraqiten vlerat e prodhimeve bimore dhe blegtorale për periudhën 5 vjeçare, vërehet se viti 2022 është viti me vlerat më të larta sa i përket prodhimeve blegtorale dhe prodhimeve bimore.


**Figura 3: Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2018-2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18, '19, '20, '21, '22 përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Nëse i referohemi figurës së mëposhtme vërejmë se sa i përket pjesëmarrjes së kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, kategoria e drithërave prinë me 28% në totalin e përgjithshëm, pasuar nga bimët foragjere me 24.9% dhe perimet dhe prodhimet e kopshtit me 22.4%, për të vazhduar më pas me kategoritë tjera si pemët, patatet, etj.

**Figura 4: Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2022**




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2022, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Lidhur me shitjen e mishit sipas llojit të kafshëve gjatë vitit 2022, sipas të dhënave vërejmë se në totalin e përgjithshëm gjedhet marrin pjesë me 45.3%, delet dhe dhitë 19.8%, derrat 13.1%, shpezët 12.2% dhe kafshët tjera 9.5%.

Ndërsa sa i përket shitjes së produkteve tjera blegtorale për vitin 2022, në raport totalin e përgjithshëm vezët marrin pjesë me 24.4%, qumështi 75.6% dhe produktet tjera që përfshinë mjaltin dhe leshin e papërpunuar marrin pjesë me 0.1%.


**Figura 5: Shitja e mishit sipas llojeve të kafshëve (majtas) dhe produkteve tjera blegtorale (djathtas), 2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2022, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Sa i përket prodhimeve bimore, gjatë periudhës 2018-2022, vërehet se ka pas ndryshime të vogla vit pas viti. Por nëse i referohemi vitit 2022 sikurse edhe në figurën e mëposhtme krahasuar me vitet paraprake gjitha kategoritë kanë shënuar rritje, por krahasuar me vitin 2021 nisur nga drithërat rritja është 46%, bimët foragjere 22%, perimet dhe prodhimet e kopshtit 20%, patatet 10%, pemët 7%, kurse prodhimet tjera bimore kanë shënuar ulje prej 19%.


**Figura 6: Prodhimet bimore në mil. €, 2018-2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18, '19, '20, '21, '22 përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Prodhimet blegtorale vlerat me çmime aktuale gjatë periudhës 2018-2022, kanë pasur ulje dhe ngritje të lehta varësisht prej kategorive. Gjatë vitit 2022, pothuajse të gjitha kategoritë kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2021, përpos kategorisë së shpezëve që shënoi ulje për 13%, kategoritë tjera si dele dhe dhi shënuan rritje për 21%, kafshët tjera 19%, gjedhet 14% dhe derrat 10%.


**Figura 7: Blegtoria në mil. €, 2018-2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18, '19, '20, '21, '22 përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Sa i përket produkteve blegtorale gjatë vitit 2022, vlera e tyre ka qenë më e larta për periudhën 2018-2022, ndërsa krahasuar me vitin 2021, prodhimitaria e vezëve ka shënuar rritje në vlerë për 22%, kurse ajo e qumështit 16%, sa i përket produkteve tjera blegtorale nuk ka pasur ndryshime gjatë viteve.

**Figura 8: Produktet blegtorale në mil. €, 2018-2022**




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18, '19, '20, '21, '22 përpunuar nga DAESB – MBPZHR

### 1.3.2 Të ardhurat sipërmarrëse

Sa i përket të ardhurave mbi prodhimin e industrisë bujqësore, konsumin e ndërmjetëm dhe vlerën e shtuar bruto, viti 2022 për periudhën e paraqitur 2018-2022, është viti me vlerën më të lartë.

Gjatë vitit 2022, prodhimet e industrisë bujqësore shënuan vlerë prej 1,016 mil. €, apo 19% rritje krahasuar me vitin 2021, vlera e shtuar bruto shënoi vlerë prej 622 mil. € apo 20% rritje, kategoria e konsumit të ndërmjetëm shënoi vlerë prej gjithsej 394 mil. € apo 16% më e lartë se në vitin 2021 që ishte 340 mil. €.


**Figura 9: Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2018-2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18, '19, '20, '21, '22 përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Lidhur me të hyrat e agreguara të paraqitura në figurën në vijim, për periudhën 2018-2022, viti 2022 paraqitet si viti me vlerën më të lartë të të hyrave. Ku gjatë këtij viti vlera e shtuar bruto me çmime bazë llogaritet 622 mil. € apo 20% më e lartë se sa në vitin 2021, vlera e shtuar neto me çmime bazë shënoi 484 mil. € apo 24% më e lartë se në vitin 2021 si dhe të ardhurat sipërmarrëse 470 mil. € apo me rritje 25% krahasuar me vitin 2021.

**Figura 10: Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2018-2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18, '19, '20, '21, '22 përpunuar nga DAESB - MBPZHR

### 1.3.3 Inputet në bujqësi


Nga të dhënat e Llogarive Ekonomike për Bujqësi të vitit 2022, vlen të ceket se struktura e konsumit të ndërmjetëm bujqësor këtë vit, nuk dallon shumë me atë të vitit 2021. shumica e kategorive në vitin 2021, krahasuar me vitin 2022 kishin përqindje të pjesëmarrje të njëjtë, dallim shumë të vogël përbëjnë kategoritë e ushqimit të kafshëve, farave dhe materialit mbëltues, shërbimeve bujqësore, plehërat dhe përmirësuesit e tokës si dhe energjia dhe lubrifikantët, të cilat kanë shënuar rritje shumë të lehtë, kategoritë tjera përqindjen e pjesëmarrjes e kanë pasur të njëjtë sikurse në vitin 2021.

Sa i përket strukturës së konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2022, të dhënat na tregojnë se pjesëmarrje më e madhe në këtë strukturë paraqet kategoria e ushqimit të kafshëve me 53%, pasuar nga kategoria e plehrave dhe përmirësuesit e tokës me 14%, mallrat dhe shërbimet tjera me 9%, energjia dhe lubrifikantët 7%, shërbimet bujqësore 5%, shpenzimet veterinerë dhe



mirëmbajtja e materialeve me nga 3%, produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet 2%, si dhe kategoria e mirëmbajtjes së ndërtesave me pjesëmarrje prej 1%.

**Figura 11: Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2022**




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2022, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Lidhur me inputet në bujqësi për vitin 2022, sikurse kategoritë e strukturës së konsumit të ndërmjetëm edhe kategoritë e inpleteve në bujqësi krahasuar me vitin 2021 nuk paraqiten me ndonjë dallim të madh.

Referuar të dhënave në figurën e mëposhtme, inputet në bujqësi sipas kategorive për vitin 2022 kanë këtë pjesëmarrje: konsumi i ndërmjetëm 72%, konsumi i kapitalit fiks 25%, ndërsa kategoritë tjera si kompensimi i punëtorëve, qiraja dhe shpenzimet tjera për shfrytëzimin e tokës dhe ndërtesave dhe interesi i papaguar kanë pjesëmarrje me nga 1%.

**Figura 12: Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2022**



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2022, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

## 1.4 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore

### 1.4.1 Çmimet e inputeve bujqësore

Indekset e çmimeve të inputeve bujqësore matin ndryshimet e çmimeve në kostot aktuale të prodhimit brenda ekonomisë. Përkatësisht, një indeks i çmimeve të inputeve matë ndryshimet në koston e shportës së blerjeve që hyjnë si inpute në procesin e prodhimit, por këtu nuk hyjnë inputet primare si toka, puna dhe kapitali.


Tabela e mëposhtme e indeksit vjetor të çmimeve të inputeve bujqësore përfshinë të dhëna për indeksin e çmimeve në Kosovë për periudhën 2015-2022. Çmimet e inputeve bujqësore janë mbledhur nga ASK në barnatore bujqësore, barnatore veterinerë, nga kompanitë, tregjet dhe vendet tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit nga ASK.

Produktet që përbëjnë bazën e indeksit të çmimeve të inputeve marrin pjesë në njërin nga dy grupet kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (konsumi i ndërmjetëm), si dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (formimi i kapitalit).

Nga të gjitha kategoritë e paraqitura në tabelën në vijim, kategoria me më së shumti rritje të çmimit në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021 është ajo e plehrave të thjeshta brenda kategorisë së plehrave dhe përmirësuesve të tokës për 91.0% dhe plehrave të përbëra me 72.9%. Gjithashtu rritje e theksuar është shënuar edhe tek energjia dhe lubrifikantët për 32.9% dhe lëndë për ushqim të kafshëve për 29.4%. Rënie të çmimit nuk ka pasur në asnjë kategori të inputeve.

Indeksi vjetor i inputeve në vitin 2022 ka shënuar ngritje për 31.5% për Input 1, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, ndërsa indeksi për Input 2 kishte rritje për 10.7%. Indeksi i çmimeve të inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) krahasuar me vitin e 2021, në vitin 2022 është ngrit për 21.7%.

**Figura 13: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2022, (2015=100)**



Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2015-2022, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

**Tabela 4: Indeksi vjetor i çmimeve të inpueteve bujqësore 2015-2022, (2015=100)**

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi (Input 1)</b>	<b>100.0</b>	<b>98.1</b>	<b>95.4</b>	<b>94.0</b>	<b>95.8</b>	<b>92.5</b>	<b>103.1</b>	<b>135.6</b>	<b>31.5</b>
Farërat dhe materiali mbëltues	100.0	98.9	87.2	78.1	83.7	82.7	83.5	86.4	3.4
Energji; lubrifikant	100.0	93.7	100.9	106.5	106.3	92.0	105.2	139.8	32.9
-Energjia elektrike	100.0	98.8	106.1	97.6	95.7	95.7	96.3	98.6	2.4
-Lëndë djegëse	100.0	92.3	100.2	109.9	110.2	90.5	107.8	152.1	41.1
-Lubrifikant	100.0	93.8	92.7	92.7	92.8	99.0	102.1	121.2	18.7
Plehrat dhe përmirësuesit e tokës	100.0	97.6	89.5	85.9	88.5	87.3	113.4	203.5	79.4
-Plehrat e thjeshtë	100.0	94.0	87.7	83.5	85.1	84.2	109.0	208.2	91.0
-Plehrat e përbëra	100.0	99.7	90.7	87.3	90.5	89.2	116.1	200.7	72.9
Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet	100.0	104.2	103.8	105.4	106.3	103.5	105.9	115.7	9.3
Shpenzimet veterinare	100.0	98.7	98.0	97.5	99.3	98.0	100.7	104.4	3.7
Lëndë për ushqim kafshësh	100.0	109.5	103.6	103.2	107.6	110.1	120.5	155.9	29.4
-Lëndë të thjeshta ushqimi	100.0	111.5	103.4	103.0	107.9	108.9	119.4	157.5	31.9
-Lëndë të përbëra ushqimi	100.0	97.9	104.9	104.7	105.7	117.0	127.1	146.8	15.5
Mirëmbajtja e materialeve	100.0	100.1	99.9	99.8	99.5	99.2	99.5	103.7	4.2
Mirëmbajtja e ndërtesave	100.0	98.2	98.8	98.6	99.3	101.5	104.8	113.0	7.8
Mallrat dhe shërbimet tjera	100.0	99.9	100.8	100.9	101.4	101.3	105.0	105.9	0.9
<b>Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2)</b>	<b>100.0</b>	<b>102.5</b>	<b>103.5</b>	<b>102.6</b>	<b>109.9</b>	<b>111.2</b>	<b>116.8</b>	<b>129.4</b>	<b>10.7</b>
Traktor	100.0	106.9	107.7	105.2	119.0	120.5	130.6	143.3	9.7
Tjera	100.0	98.5	99.8	100.3	101.8	103.0	104.6	117.1	11.9
<b>Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>99.0</b>	<b>97.8</b>	<b>102.1</b>	<b>100.8</b>	<b>109.2</b>	<b>132.8</b>	<b>21.7</b>

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inpueteve dhe çmimet në bujqësi 2015-2022, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela në vijim përmban të dhëna lidhur me çmimet vjetore të energjisë elektrike dhe naftës për periudhën 2016-2022. Sa i përket çmimit të energjisë elektrike, në vitin 2022 është rritur për 3.5% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa çmimi i naftës është rritur për 13.2%.

**Tabela 5: Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2016-2022**

Energjia dhe Lubrifikantët	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Energjia elektrike çmimi për 100 kwh	6.1	6.4	5.8	5.6	5.6	5.7	5.9	3.5
Nafta - çmimi për 100 litra	93.5	102.1	112.7	113.0	92.6	110.2	124.7	13.2

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inpueteve dhe çmimet në bujqësi 2015-2022, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## **1.4.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore**

Vitet e fundit karakterizohen me gjendje të jashtëzakonshme në ekonominë globale e cila gjithashtu është reflektuar në ekonominë e Kosovës, fillimisht me Covid-19 pastaj me luftën në Ukrainë, gjë që ndikuan mjaft shumë te ne në bujqësinë tonë e cila ka mjaftë varësi nga importi.

Zhvillimin e sektorit të bujqësisë, MBPZhR vazhdon ta përkrah përmes granteve dhe subvencioneve, duke ndikuar në rritjen e prodhimit dhe kualitetit si dhe për të zbutur sadopak importin, i cili ndikon direkt në çmimet e prodhimeve vendore.

Prodhimtaria vendore në bujqësi nuk po arrin t'i plotësoj të gjitha nevojat për konsum, përkundër përkrahjes së vazhdueshme. Nisur nga ky fakt, për plotësimin e nevojave për konsum një pjesë e madhe e prodhimeve importohen, edhe pse çdo vit eksporti po shënon rritje, sasia e lartë e importit vazhdon të ndikoj në thellimin e mëtutjeshëm të bilancit negativ tregtar.

MBPZhR ka angazhuar një operator ekonomik për mbledhjen e çmimeve të prodhimeve bujqësore për vite me radhë, ku merren çmimet e produkteve bujqësore nga 7 regjione dhe të njëjtat prezantohen në mesatare vjetore në nivel vendi, me qëllim që të hartojmë analiza, programe dhe strategji të ndryshme për sektorin e bujqësisë.

Në vazhdim janë paraqitur çmimet e disa prodhimeve bujqësore në nivel të fermës, çmimet e konsumit me shumicë dhe pakicë, çmimet e importit si dhe vlera për njësi e produkteve të importuara për periudhën 2019–2022.

### **Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore**

Në tabelën në vijim, janë paraqitur çmimet vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë. Bazuar në të dhënat nga tabela, çmimet në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, kanë pasur mjaft luhatje. Rënie të dukshme të çmimit kanë pasur: spinaqi, mjedra, kumbulla dhe molla, ndërsa ngritje më të madhe në çmime nga prodhimet e listuara në tabelë, kanë shënuar: pulë ferme, kungulli, kungull misiri, gruri, misri, etj.

**Figura 14: Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg**

Prodhime	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 (%)
Grurë	0.18	0.19	0.20	0.29	45
Misër	0.22	0.25	0.28	0.32	14
Domate	0.57	0.33	0.52	0.66	27
Fasule	2.03	2.31	2.38	2.49	5
Kungull *	0.81	0.17	0.16	0.25	56
Kungull misiri *	0.81	0.22	0.29	0.39	34
Lakër	0.19	0.23	0.31	0.36	16
Patate	0.27	0.28	0.42	0.49	17
Qepë	0.46	0.37	0.41	0.48	17
Shalqi	0.19	0.18	0.21	0.21	0
Spec	0.76	0.54	0.62	0.78	26
Spinaq	0.94	0.76	1.16	0.86	-26
Trangull	0.48	0.31	0.54	0.67	24
Arrë	2.16	2.06	2.13	2.57	21
Dardhë	0.81	0.72	0.91	0.89	-2
Dredhëz	1.12	1.16	1.22	1.19	-2
Kumbull	0.51	0.71	0.81	0.78	-4
Mjedër	1.77	1.73	3.50	3.12	-11
Mollë	0.39	0.31	0.44	0.43	-2
Rrush tryeze	0.68	0.63	0.53	0.69	30
Mëzet dhe Mëshqerra	1.97	2.21	2.53	2.71	7
Pulë ferme	1.68	1.72	1.89	3.12	65
Qumësht	0.21	0.23	0.31	0.34	10
Vezë **	2.07	2.26	2.12	2.54	20
Mjaltë	11.85	13.60	11.50	14.54	26

Burimi: DAESB – MBPZhR; \*Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; \*\* njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

## Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore janë prezantuar si çmime vjetore të tregut me shumicë dhe pakicë për vitet 2019-2022.

Bazuar në çmimet vjetore të tregut me shumicë të cilat janë të paraqitura në tabelën vijuese për disa prodhime bujqësore, vërejmë se gjatë vitit 2022 ka pasur lëvizje të çmimeve krahasuar me vitin 2021, ngritje në çmime kanë shënuar: kungulli, pulë ferme, domatja, kungull misiri, qumështi, rrush tryeze dhe vezët, ndërsa prodhimet që kanë shënuar rënie në çmim në krahasim me vitin paraprak janë: molla, kumbulla, mjedra dhe misri.

**Tabela 6: Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg**

Prodhime	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 (%)
Grurë	0.23	0.33	0.31	0.36	16
Misër	0.48	0.53	0.39	0.37	-5
Domate	0.66	0.65	0.78	1.17	50
Fasule	2.35	2.44	2.50	2.84	14
Kungull *	0.95	0.31	0.27	0.53	96
Kungull misiri *	1.15	0.38	0.46	0.69	50
Lakër	0.46	0.39	0.47	0.55	17
Patate	0.39	0.39	0.40	0.51	28
Qepë	0.53	0.54	0.48	0.62	29
Shalqi	0.23	0.37	0.24	0.25	4
Spec	0.92	0.97	0.94	1.27	35
Spinaq	1.01	0.95	0.94	1.00	6
Trangull	0.55	0.57	0.75	0.91	21
Arrë	2.33	2.38	2.71	3.05	13
Dardhë	0.96	1.20	1.32	1.37	4
Dredhëz	1.33	1.82	1.67	1.75	5
Kumbull	0.59	0.69	1.09	0.91	-17
Mjedër	2.17	2.07	4.00	3.72	-7
Mollë	0.49	0.64	0.73	0.58	-21
Rrush tryeze	0.79	0.99	1.02	1.41	38
Mëzet dhe Mëshqerra	3.31	2.93	2.65	2.89	9
Pulë ferme	1.93	1.91	2.08	3.78	82
Qumësht	0.43	0.29	0.42	0.59	40
Vezë **	2.19	2.36	2.29	3.15	38
Mjaltë	6.85	7.22	10.51	11.34	8

Burimi: DAESB – MBPZhR; \*Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; \*\* njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

Lidhur me çmimet vjetore të tregut me pakicë vërehet që ka pas mjaft ndryshime të çmimeve të prodhimeve bujqësore gjatë vitit 2022, dukshëm ka pas rënie të çmimeve të: kumbulla, molla, misri dhe mjedra, ndërsa pulë ferme, kungull, kungull misiri, vezë dhe domate kanë shënuar rritje të çmimeve.

**Tabela 7: Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg**

Prodhimi	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 (%)
Grurë	0.36	0.38	0.36	0.42	17
Misër	0.54	0.62	0.46	0.42	-9
Domate	0.80	0.77	0.94	1.26	34
Fasule	2.66	2.60	2.67	3.01	13
Kungull *	1.16	0.42	0.34	0.61	79
Kungull misiri *	1.22	0.45	0.51	0.75	47
Lakër	0.55	0.47	0.55	0.55	0
Patate	0.50	0.48	0.49	0.60	22
Qepë	0.65	0.64	0.57	0.71	25
Shalqi	0.30	0.45	0.28	0.28	0
Spec	1.06	1.08	1.08	1.38	28
Spinaq	1.18	1.07	1.08	1.08	0
Trangull	0.67	0.65	0.86	1.06	23
Arrë	2.61	2.56	2.96	3.22	9
Dardhë	1.13	1.35	1.45	1.48	2
Dredhëz	1.49	1.97	1.87	1.93	3
Kumbull	0.75	0.79	1.48	1.08	-27
Mjedër	2.44	2.26	4.25	3.93	-8
Mollë	0.60	0.74	0.84	0.69	-18
Rrush tryeze	0.98	1.09	1.20	1.52	27
Mëzet dhe Mëshqerra	3.75	3.02	2.49	3.05	22
Pulë ferme	2.33	2.13	2.38	4.51	89
Qumësht	0.51	0.48	0.49	0.60	22
Vezë **	2.50	2.61	2.57	3.61	40
Mjaltë	7.40	7.50	10.77	11.42	6

Burimi: DAESB – MBPZhR; \*Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; \*\* njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

## Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore

Në Kosovë zakonisht jashtë sezonës së prodhimeve bujqësore vendore, në tregun tonë hasim prodhime të importuara çmimet e të cilave ndryshojnë dukshëm.

Çmimet e shitjes me shumicë, në të shumtën e rasteve janë më të larta se çmimet e prodhimit vendor, kurse në rastin e çmimeve të importit, për prodhimet me pjesëmarrje të lartë të importeve, kjo rregull mund të mos vlejë sepse disa produkte kanë kosto të lartë të prodhimit në vend, dhe si rrjedhojë çmimet e prodhimit në fermë mund të jenë më të larta sesa ato të importit.

Në tabelën vijuese janë të paraqitura çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, ku çmimet të cilat kanë pësuar rënie në raport me vitin paraprak janë: spinaqi, kumbulla, misri, lakra etj., ndërsa rritje më të dukshme në çmim kanë shënuar: kungull misiri, kungulli, vezët, mjaltja, speci dhe domatja.

**Tabela 8: Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg**

Prodhime	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 (%)
Grurë	0.38	0.38	0.36	0.35	-3
Misër	0.53	0.45	0.43	0.32	-26
Domate	0.97	1.19	0.97	1.36	40
Fasule	1.97	2.01	2.36	2.77	17
Kungull *	1.12	0.28	0.31	0.41	32
Kungull misiri *	0.90	0.46	0.43	0.52	21
Lakër	0.56	0.64	0.52	0.44	-15
Patate	0.55	0.84	0.56	0.70	25
Qepë	0.52	0.61	0.55	0.58	5
Shalqi	1.61	0.85	0.79	0.89	13
Spec	1.46	1.50	1.23	1.86	51
Spinaq	1.49	1.19	1.21	0.78	-36
Trangull	1.08	1.21	1.00	1.12	12
Arrë	2.40	2.06	2.42	2.67	10
Dardhë	1.34	1.47	1.48	1.36	-8
Dredhëz	2.69	2.94	2.63	2.30	-13
Kumbull	3.49	2.34	2.19	1.56	-29
Mjedër	1.70	-	-	-	-
Mollë	0.78	0.82	0.77	0.72	-6
Rrush tryeze	2.66	1.97	2.78	2.48	-11
Mëzet dhe Mëshqerra	3.05	2.87	2.98	2.75	-8
Pulë ferme	2.35	2.21	2.72	-	-
Qumësht	-	-	-	-	-
Vezë **	2.35	2.15	2.21	3.31	50
Mjaltë	7.85	8.60	7.54	11.39	51

Burimi: DAESB – MBPZhR; \*Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; \*\* njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

Tabela më poshtë paraqet vlerën për njësi të importit të prodhimeve bujqësore. Shumica e prodhimeve kanë shënuar ngritje të dukshme krahasuar me vitin 2021, si: domatja, gruri, misri, mëzet dhe mëshqerra, specat dhe qumështi, ndërsa zvogëlim çmimesh krahasuar me vitin paraprak paraqitet tek: mjedra, qepa, dardha dhe dredhëza ndërsa prodhimet tjera kanë dallime më të ulëta.



**Tabela 9: Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg**

Prodhimi	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 (%)
Grurë	0.20	0.19	0.22	0.33	52
Misër	0.17	0.16	0.22	0.29	32
Domate	0.38	0.35	0.35	0.52	47
Fasule	0.88	0.93	0.86	0.87	2
Kungull dhe Kungull misiri*	0.47	0.52	0.56	0.55	-1
Lakër	0.26	0.16	0.22	0.23	5
Patate	0.30	0.20	0.23	0.29	27
Qepë	0.55	0.47	0.47	0.32	-31
Shalqi	0.16	0.15	0.15	0.18	23
Spec	0.54	0.46	0.42	0.54	29
Spinaq	0.48	0.50	0.57	0.69	21
Trangull	0.35	0.29	0.38	0.44	15
Arrë	1.42	1.52	1.45	1.59	10
Dardhë	0.68	0.67	0.62	0.51	-18
Dredhëz	0.68	0.69	0.93	0.85	-8
Kumbull	0.33	0.31	0.39	0.43	10
Mjedër	0.51	2.21	3.55	0.85	-76
Mollë	0.35	0.32	0.30	0.32	8
Rrush tryeze	0.50	0.46	0.46	0.51	10
Mëzet dhe Mëshqerra	1.33	1.32	1.37	1.86	35
Pulë ferme	1.99	1.99	1.99	2.39	20
Qumësht	0.57	0.55	0.55	0.69	26
Vezë **	-	1.11	1.35	1.50	11
Mjaltë	4.83	4.98	5.06	6.05	19

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR; \* Në të dhënat doganore, kungull dhe kungull misiri janë të përfshira në një kod doganor; \*\* njësia 30 copë

### **Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së**

Krahasimin e çmimeve të disa vende të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, mund ta shohim në tabelën vijuese, ku janë të paraqitura çmimet e prodhimeve bujqësore për disa kultura siç janë: gruri, misri, lakra, patatja, molla, vezët dhe mjalti.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të themi se Kosova ka çmime relativisht të larta në krahasim me vendet e BE-së. Prodhimet tek të cilat Kosova ka çmime më të larta janë: mjaltja, patatja dhe misri, kurse çmimi i vezëve, grurit, mollës dhe lakrës është më i ulët.

**Tabela 10: Çmimet e disa prodhimeve në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2022, €/kg**

Shtetet	Grurë	Misër	Lakër	Patate	Mollë	Vezë *	Mjaltë
Bullgaria	0.31	0.29	0.22	0.28	0.32	10.29	3.70
Çekia	0.31	0.28	0.40	0.23	0.54	9.65	-
Greqia	0.38	0.37	0.43	0.63	0.65	20.81	6.03
Hungaria	0.32	0.29	0.37	0.33	0.33	8.45	3.61
Austria	0.28	0.31	-	0.26	0.81	18.79	11.60
Rumania	0.30	0.28	0.48	0.49	0.61	10.95	4.36
Kosova	0.29	0.32	0.36	0.49	0.43	8.47	14.54

Burimi: Eurostat; DAESB - MBPZhr, \* misër kokërr, \*\* njësia për 100 copë

Si përfundim, duke parë çmimet e paraqitura më lartë, mund të themi se Kosova si treg i vogël me prodhim të ulët vendor është shumë e varur nga importi e si rezultat edhe çmimet diktohen nga kjo si dhe vazhdojnë të mbesin të larta duke pasur parasysh standardin e jetesës.

Ndryshimet e çmimeve në tregun ndërkombëtar dhe në vendet e regjionit kanë ndikim në çmimet e tregut në vendin tonë dhe duke marrë parasysh të ardhurat e ulëta, rritja e çmimeve sidomos të prodhimeve bazike, ndikon negativisht në standardin jetësor të popullatës së Kosovës.

## 1.5 Privatizimi i tokave bujqësore

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka vazhduar edhe për vitin 2022 me procesin e privatizimit të tokave dhe pronave shoqërore si një organ i pavarur publik dhe që ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë të Ligjit.

Duke krahasuar të dhënat e tokave të privatizuara gjatë vitit 2022, vërehet se kishte një rritje shumë të ulët të shitjeve në vitin 2022. Pjesëmarrje më të madhe në gjithsej totalin e shitjes së tokave bujqësore apo të privatizuara edhe për vitin 2022 sikurse gjatë viteve tjera ka pasur në regjionin e Pejës 37.9%, pasuar nga Prizreni 21.6%, Mitrovica 20.6%, Gjilani 10.6% dhe Prishtina me 9.3%.

Sipërfaqja totale e shitur e tokave bujqësore deri në vitin 2022 ishte 30,823 ha. Sipërfaqja më e madhe e tokave të shitura ishte në regjionin e Pejës (11,687 ha), pasuar nga Prizreni (6,672 ha), Mitrovica (6,349 ha), Gjilani (3,263 ha) dhe Prishtina (2,852 ha).

Në vijim është paraqitur tabela e shitjes së tokave bujqësore sipas regjioneve në Kosovë. Ku shihet se gjithsej vlera e shitjeve apo privatizimi i tokave bujqësore përmes procedurave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në periudhën 2005-2022 ishte 160 mil. €.


**Tabela 11: Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë, sipas regjioneve, 2005-2022**

Regjioni	Sipërfaqja në ari	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqet e shitura (%)	Çmimi mesatar i shitjes €/ari	Çmimi mesatar i shitjes €/ha	Vlera totale e shitjeve €	Vlera e shitjes (%)
Prishtinë	285,165	2,852	9.3	251	25,059	71,458,873	45%
Pejë	1,168,731	11,687	37.9	25	2,520	29,450,673	18%
Prizren	667,159	6,672	21.6	47	4,706	31,393,749	20%
Gjilan	326,317	3,263	10.6	55	5,539	18,074,990	11%
Mitrovicë	634,911	6,349	20.6	15	1,527	9,695,730	6%
Gjithsej	3,082,282	30,823	100.0	52	5,193	160,074,016	100%

Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Duke ju referuar çmimeve të shitjes të cilat AKP i posedon, vërejmë se çmimi më i lartë mesatar i shitjes së një hektari të tokës bujqësore ishte në regjionin e Prishtinës 25,059 €, ndërsa regjionet tjera kanë pasur çmimin e shitjes së një hektari tokë shumë më të ulët si, Gjilani 5,539 €, Prizreni 4,706 €, Peja 2,520 € dhe Mitrovica 1,527 €.


**Figura 15: Çmimi mesatar për sipërfaqet e shitura të tokave bujqësore dhe vlera totale e shitjeve 2005-2022**



Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Siç u tha më lartë sipërfaqja e privatizuar e tokës bujqësore, nga viti 2005-2022 është 30,823 ha, kjo sipërfaqe është shitur në vlerë 160.07 mil. €. Në vitin 2005 janë privatizuar 1,436 ha të tokës bujqësore apo 4.6% të gjithsej tokave bujqësore të privatizuara, vijuar nga viti 2006 dhe 2007, ku numri i hektarëve të tokës së privatizuar ishte 5,372 ha dhe 5,440 ha, respektivisht, me pjesëmarrje prej 18% secila. Një shitje më e madhe e tokave bujqësore është realizuar në vitin 2009, ku u privatizuan 6,790 ha, me një pjesëmarrje më të madhe krahasuar me vitet tjera. Nga viti 2010, kur shitja e tokave bujqësore nga AKP-ja ishte 2,318 ha, vitet në vijim ka pasur më pak shitje të tokave bujqësore. Në vitin 2020 u privatizuan 592 ha apo 1.9% nga totali i tokave bujqësore të shitura nga AKP, në vitin 2021 janë shitur vetëm 13.8 ha apo 0.04%, ndërsa në vitin 2022 janë privatizuar më pak se 1 ha tokë.

**Figura 16: Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2022**



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

Shitja e tokave bujqësore sipas komunave e ndarë në hektarë të shitur, vlerë të shitjes dhe në çmim për ari dhe për hektarë është paraqitur në vijim. Vërehet se çmimet ndryshojnë nga

komuna në komunë, duke marrë parasysh kategorinë dhe faktorë tjerë përcaktues si: boniteti i tokës bujqësore, pozita, burimet ujore afër saj dhe infrastruktura rrugore.

**Tabela 12: Shitja e tokave bujqësore, 2005-2022**

Komuna	Hektar të shitur	Vlera e shitjes	Çmimi €/ari	Çmimi €/ha
Deçan	731.22	2,028,963	27.7	2,775
Dragash	-	-	-	-
Glllogoc	1,140	6,069,038	53.2	5,323
Ferizaj	1,241	8,529,043	68.7	6,872
Fushë Kosovë	565.89	4,431,496	78.3	7,831
Gjakovë	2,352	8,792,953	37.4	3,738
Gjilan	613.01	4,027,406	65.7	6,570
Graçanicë	299.35	17,450,158	582.9	58,293
Hani i Elezit	-	-	-	-
Istog	1,945	6,251,595	32.1	3,215
Junik	359.98	1,494,545	41.5	4,152
Kaçanik	513.56	2,153,004	41.9	4,192
Kamenicë	224.34	385,398	17.2	1,718
Klinë	4,193	6,340,098	15.1	1,512
Kllokot	25.06	635,555	253.6	25,361
Leposaviq	-	-	-	-
Lipjan	678.81	5,120,343	75.4	7,543
Malishevë	1,590	2,101,913	13.2	1,322
Mamushë	47.07	896,111	190.4	19,038
Mitrovica e Jugut	2,836	1,262,087	4.5	445
Mitrovica e Veriut	-	-	-	-
Novobërdë	2.5	505,555	2022.2	202,222
Obiliq	479.69	3,470,832	72.4	7,236
Partesh	-	-	-	-
Pejë	2,106	4,540,020	21.6	2,155
Podujevë	283.57	1,267,282	44.7	4,469
Prishtinë	394.04	38,660,883	981.1	98,114
Prizren	887.75	14,229,422	160.3	16,029
Rahovec	2,338	6,079,794	26.0	2,601
Ranillug	33.21	155,555	46.8	4,684
Shtërpcë	94.37	708,365	75.1	7,506
Shtime	444.26	1,797,199	40.5	4,045
Skenderaj	1,937	1,604,936	8.3	828
Suharekë	1,384	6,424,098	46.4	4,642
Viti	647.41	1,900,701	29.4	2,936
Vushtrri	435.87	759,669	17.4	1,743
Zubin Potok	-	-	-	-
Zveçan	-	-	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>30,823</b>	<b>160,074,016</b>		

Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

## 1.6 Bizneset bujqësore – Agroindustria

Agroindustria i referohet një ndërmarrje që përpunon materiale me origjinë bimore ose shtazore, ku përmes bizneseve bujqësore bëhet e mundur lidhja e drejtpërdrejtë e fermerit me industrinë e përpunimit. Duke ditur dhe vlerësuar rëndësinë e sektorit i cili përbën segment të rëndësishëm të ekonomisë, sigurohet ushqim i sigurt në aspektin sasior dhe po ashtu në anën e sigurisë ushqimore.

Të dhënat për ndërmarrjet e regjistruara në vazhdimësi i referohen Regjistrimit Statistikor të Bizneseve, ky regjistër përmban informacionet kryesore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Republikën e Kosovës dhe paraqet të dhëna dhe analiza të demografisë së bizneseve.

Sa i përket ndërmarrjeve të regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari, gjatë vitit 2022 janë regjistruar 397 ndërmarrje, me pjesëmarrje prej 4.2% në gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike që ishin 9,347.


**Tabela 13: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2018-2022**

Viti	Ndërmarrjet e regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	Gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike	Pjesëmarrja (%)
2018	626	9,805	6.4
2019	121	10,004	1.2
2020	397	9,805	4.0
2021	269	10,649	2.5
2022	397	9,347	4.2

Burimi: ASK - Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Referuar periudhës 2018-2022, numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike prinë në vitin 2021 me gjithsej 10,649 ndërmarrje, ndërsa sa i përket ndërmarrjeve të regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari dallohet viti 2018 me gjithsej 626 ndërmarrje, pasuar me vitin 2022 me 397 ndërmarrje. Figura në vijim paraqet numrin e ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike sipas viteve.

**Figura 17: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2018-2022**



Burimi: ASK - Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sa i përket ndërmarrjeve të agrobizneseve në Kosovë për vitin 2022, llogariten gjithsej 3,164 ndërmarrje aktive me numër të të punësuarve gjithsej 17,178 persona, dhe me qarkullim monetar prej 888.7 mil. €.

**Tabela 14: Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2018-2022**

Viti	Qarkullimi ('000 €)	Numri i të punësuarve	Numri bizneseve aktive
2018	461,626	13,156	2,942
2019	499,821	12,467	2,405
2020	562,980	14,996	2,780
2021	699,399	17,260	3,019
2022	888,725	17,178	3,164

Burimi: ASK - Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sa i përket aktiviteteve të bizneseve bujqësore për vitin 2022, prinë aktiviteti i përpunimit të produkteve ushqimore me qarkullim prej 490.2 mil. €, pasuar nga aktiviteti i prodhimit të pijeve, me qarkullim prej 156.5 mil. €, aktiviteti i prodhimit bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to me qarkullim prej 92.3 mil. €, prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve me qarkullim prej 86.0 mil. €, prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës, me qarkullim prej 43.3 mil. €, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të lëkurës 11.6 mil. €, pasuar nga aktivitetet tjera si pylltari dhe prerja e drunjtëve me qarkullim prej 5.8 mil. € dhe peshkimi dhe akuakultura me qarkullim prej 3.0 mil. €.

**Tabela 15: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2022**

Aktiviteti	Qarkullimi,(‘000 €)	Numri i të punësuarve	Numri i bizneseve aktive
Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to	92,341	2,937	849
Pylltaria dhe prerja e drunjëve	5,825	126	40
Peshkimi dhe Akuakultura	2,986	114	14
Përpunimi i produkteve ushqimore	490,163	9,050	1,503
Prodhimi i pijeve	156,508	1,904	102
Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	11,597	426	39
Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve	85,983	1,979	506
Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	43,322	642	111
<b>Gjithsej</b>	<b>888,725</b>	<b>17,178</b>	<b>3,164</b>


Burimi: ASK - Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Referuar qarkullimit nga agroindustria sipas regjioneve për vitin 2022, qarkullimi më i madh ishte në regjionin e Prishtinës me 29%, regjionin e Prizrenit me 22%, regjionin e Pejës me 16%, pasuar nga regjioni i Gjakovës me 10%, regjioni i Mitrovicës me 9%, regjioni i Gjilanit 8% si dhe regjioni i Ferizajt 6%.

Lidhur me numrin e të punësuarve sa i përket këtij sektori prinë regjioni i Prishtinës me 30%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 17%, regjioni i Pejës 15%, regjioni i Gjakovës dhe i Ferizajt me nga 10%, si dhe regjioni i Mitrovicës dhe Gjilanit me nga 9%.

Sa i përket numrit të bizneseve aktive prinë regjioni i Prishtinës me 25%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 18%, regjioni i Pejës me 14%, regjioni i Gjakovës me 13%, regjioni i Ferizajit me 11%, regjioni i Gjilanit me 10% si dhe regjioni i Mitrovicës me 9%.

**Figura 18: Qarkullimi, numri i të punësuarve dhe numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë sipas regjioneve (%), 2022**







Burimi: ASK - Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## 2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij

### 2.1 Përdorimi i tokës bujqësore

Në vitet e fundit nuk ka ndryshime të mëdha në numrin e hektarëve të tokës bujqësore të shfrytëzuar, pavarësisht tendencës të viteve të fundit që tokës bujqësore t'i ndërrohet destinimi dhe të përdoret për qëllime tjera, tendencë kjo që lidhet me zhvillimin e fundit ekonomik po edhe kërkesën çdo herë në rritje për të jetuar në zonat urbane.

Përdorimi i tokës bujqësore është i ndarë në dy grupe, në grupin e parë e kemi tokën bujqësore të punueshme dhe në grupin e dytë livadhet dhe kullotat që përdoren për kullotjen e bagëtive duke përfshirë edhe tokën e përbashkët.

Në vitin 2022 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,482 ha që paraqet 23 ari tokë bujqësore për kokë banori.

**Tabela 16: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, ha**

	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %	Pjesëmarrja në % 2022
Tokë e punueshme - ara	188,359	188,365	188,372	188,375	188,405	0.02	44.81
-Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	7,818	8,319	8,435	8,491	8,584	1.11	
-Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	468	518	547	562	583	3.65	
Kopshte	1,003	1,122	1,133	1,089	1,080	-0.87	0.26
Plantacione të pemëve	7,687	9,244	10,029	10,144	10,377	2.30	2.47
Plantacione të vreshtave	3,272	3,367	3,437	3,471	3,472	0.03	0.83
Fidanishte	109	111	137	140	150	7.12	0.04
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,152	217,932	217,102	217,107	216,998	-0.05	51.61
<b>Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore</b>	<b>418,582</b>	<b>420,141</b>	<b>420,210</b>	<b>420,327</b>	<b>420,482</b>	<b>0.04</b>	<b>100.00</b>


Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

\*Statistikat e prezantuara në këtë tabelë paraqiten në bazë të grupimit si në AEB të ASK-së dhe ka ndryshime me të dhënat e prezantuara në nënkapitujt 2.2.2 dhe 2.2.3 për arsye të ndryshimit në grupim (p.sh dredhëza tek nënkapitulli 2.1 sipas grupimit të ASK-së është e kategorizuar në perime ndërsa tek nënkapitulli 2.2.3 është e paraqitur tek pemët).

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, pjesa më e madhe prej 51.6% apo 216,998 ha janë livadhe dhe kullota.

Përqindje e lartë prej 44.8% ose 188,405 ha janë tokë e punueshme dhe pjesa tjetër prej 3.6% apo 15,079 ha janë: kopshtet, plantacionet e pemëve, vreshtave dhe fidanishtet.

**Figura 19: Tokë e punueshme - ara dhe livadhe e kullosa**




Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

Në vitin 2022 sipërfaqja me perime në fushë të hapur dhe në serra ka shënuar rritje, ishin 8,584 ha të mbjellura me perime në fushë të hapur që paraqet rritje për 1.1%, ndërsa perime në serra ishin 583 ha që paraqet rritje për 3.7% në krahasim me vitin e kaluar. Sipërfaqja me kopshte ishte 1,080 ha, për 0.9% më pak se sa në vitin 2021.

Sipërfaqet e mbjellura me plantacione të pemëve në vitin 2022 ishin 10,377 ha, që paraqet rritje për 2.3%, ndërsa sipërfaqet me vreshta në vitin 2022 ishin 3,472 ha, vetëm 1 ha më shumë sesa në vitin 2021.


**Figura 20: Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave**



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

Shfrytëzimi i tokës bujqësore në vitin 2022 sipas kategorive ka këtë shpërndarje: Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 51%, Tokë e punueshme-ara 44%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë) dhe kopshte e fidanishte nga 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%.

**Figura 21: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2022**



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore, 2022

## 2.2 Prodhimtaria bimore

### 2.2.1 Drithërat

Sipërfaqja totale e mbjellur me drithëra në vitin 2022 ishte 124,618 ha, që ka shënuar rritje për 140 ha më shumë se sa në vitin 2021. Edhe në vitin 2022 sipërfaqen më të madhe të drithërave e përbëjnë dy kulturat kryesore që janë gruri dhe misri, 64% apo 79,984 e sipërfaqes totale të drithërave ishte e mbjellur me grurë dhe 32% apo 39,797 ha ishin të mbjellura me misër. Drithërat tjera si elbi, thekra, tërshëra dhe grupi tjetër i drithërave kokërr kishin sipërfaqe më të vogla.

Në vitin 2022 prodhimi ka shënuar rritje tek të gjitha kulturat. Prodhimi i grurit dhe misrit është rritur për 2.8%, prodhimi i elbit dhe tërshërës për 4.8%, i thekrës për 5.8% dhe drithërave të tjera kokërr për 12.5%. Kjo rritje ishte më shumë si rezultat i rritjes së rendimentit por edhe asaj se sipërfaqet shënuar një rritje të vogël.

Nga gjithsej sipërfaqja e mbjell me drithëra, 71% është subvencionuar përmes programit të pagesave direkte, ndërsa sa i përket prodhimit është subvencionuar vetëm sasia e grurit, ku sasia e grurit të subvencionuar përbënë 20% të gjithsej prodhimit të grurit.

**Tabela 17: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2018-2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>					
<b>Drithëra</b>	123,869	124,199	124,714	124,477	124,618	0.1
Grurë	81,123	80,273	80,473	79,970	79,984	0.0
Misër	38,453	39,441	39,684	39,710	39,797	0.2
Elb	1,948	1,954	1,982	2,060	2,067	0.3
Thekër	434	420	425	555	567	2.2
Tërshërë	1,797	1,975	2,009	2,030	2,045	0.7
Drithëra të tjera kokërr	113	136	141	153	158	3.4
<b>Prodhimi</b>	<b>t</b>					
<b>Drithëra</b>	441,757	459,404	529,112	504,371	518,724	2.8
Grurë	280,616	284,999	341,818	322,018	330,913	2.8
Misër	151,921	163,930	175,180	170,393	175,226	2.8
Elb	5,124	5,159	5,764	5,610	5,882	4.8
Thekër	1,049	1,010	1,153	1,409	1,492	5.8
Tërshërë	2,751	3,954	4,769	4,500	4,715	4.8
Drithëra të tjera kokërr	296	352	427	441	496	12.5
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>					
Grurë	3.46	3.55	4.25	4.03	4.14	2.7
Misër	3.95	4.16	4.41	4.29	4.40	2.6
Elb	2.63	2.64	2.91	2.72	2.85	4.5
Thekër	2.41	2.41	2.71	2.54	2.63	3.6
Tërshërë	1.53	2.00	2.37	2.22	2.31	4.1
Drithëra të tjera kokërr	2.62	2.59	3.03	2.89	3.14	8.7

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

Grurit përbënë 64.2% të gjithë sipërfaqes së kultivuar me drithëra në vitin 2022. Prodhimi vendor prej 330,913 tonë mbulon 69.7% të nevojave vendore për konsum dhe pjesa tjetër mbulohe nga importi. Në Kosovë pjesa më e madhe e grurit përdoret për konsum njerëzor dhe pjesa tjetër shitet dhe përdoret si ushqim për kafshë. Vlera e prodhimit të grurit ishte 96.0 mil. €, 49% më e lartë krahasuar me vitin 2021, e kjo si rezultat i rritjes së çmimit në 0.29 €/kg por edhe rritjes së prodhimit për 8,895 tonë. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, dhe ka shënuar rritje për shkak të ngritjes së çmimeve por edhe rritjes së sasisë së importuar.

Në vitin 2022, konsumi mesatar për kokë banori për grurë, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje gruri ishte 213 kg.

**Tabela 18: Bilanci i furnizimit për grurin, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me drithëra	ha	123,869	124,199	124,714	124,477	124,618
Sipërfaqja me grurë	ha	81,123	80,273	80,473	79,970	79,984
Pjesëmarrja e grurit	%	65.5	64.6	64.5	64.2	64.2
Rendimenti	t/ha	3.5	3.6	4.2	4.0	4.1
Prodhimi	t	280,616	284,999	341,818	322,018	330,913
Importi i grurit dhe eku. të grurit*	t (p.e)	175,252	220,208	132,952	148,825	149,328
Importi i farës së grurit	t	6,535	5,288	8,724	7,736	8,275
Importi i grurit	t	116,045	149,947	74,491	93,365	100,122
Importi i miellit të grurit	t	20,677	29,388	20,130	16,599	12,930
Importi i produkteve tjera të grurit	t	28,409	27,131	27,352	30,645	28,859
Furnizimi	t	455,868	505,207	474,770	470,843	480,241
Eksporti i grurit dhe eku. të grurit*	t (p.e)	10,326	5,093	8,364	8,395	5,463
Eksporti i farës së grurit	t	130	75	298	546	169
Eksporti i grurit	t	0	0	0	0	0
Eksporti i miellit të grurit	t	7,157	3,389	5,536	5,294	3,407
Eksporti i produkteve tjera të grurit	t	684	813	856	1,029	1,208
Përdorimi vendor	t	445,542	500,114	466,406	462,448	474,778
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	63.0	57.0	73.3	69.6	69.7
Farë gruri	t	24,337	24,082	24,142	23,991	23,995
Humbjet	t	8,418	8,550	10,255	9,661	9,927
Ushqimi për kafshë	t	45,151	45,856	54,999	51,813	53,244
Përdorimi industrial	t	7,914	8,371	10,182	9,307	9,534
Procesimi	t	225,176	270,938	193,729	209,452	216,001
Konsumi njerëzor	t	134,546	142,316	173,100	158,225	162,076
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.23	0.18	0.19	0.20	0.29
Vlera e prodhimit	mil. EUR	64.5	51.3	64.9	64.4	96.0
Bilanci tregtar i grurit dhe eku. të grurit	mil. EUR	-73.1	-81.0	-70.6	-91.9	-107.2
Bilanci tregtar për farë gruri	mil. EUR	-2.1	-1.8	-2.8	-2.6	-4.8
Bilanci tregtar për grurë	mil. EUR	-23.4	-29.0	-15.0	-25.4	-29.7
Bilanci tregtar për miell gruri	mil. EUR	-4.2	-8.0	-4.3	-4.8	-5.3
Bilanci tregtar për produkte tjera të grurit	mil. EUR	-43.5	-42.2	-48.5	-59.1	-67.5
Konsumi për kokë banori	kg	200	232	204	207	213

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZHR

Sqarim: Për të gjitha të dhënat e tregtisë (eksporti dhe importit) viti i prezantuar në tabelë përfshinë periudhën korrik-dhjetor të atij viti dhe janar-qershor të vitit pasues; p.e - nënkupton ekuivalentët e produktit, d.m.th çdo produkt me përmbajtje gruri i konvertuar në grurë; \*Importi i grurit dhe eku. të grurit dhe Eksporti i grurit dhe eku. të grurit, nënkupton eksportin ose importin e sasisë së grurit si dhe të të gjitha produkteve tjera që përmbajnë grurë e që përmes koeficientëve të konvertimit janë të konvertuara në grurë.

Në vitin 2022, 31.9% e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me drithëra është e mbjellë me misër. Me sasinë e prodhuar prej 175,226 tonë Kosova mbulon 81% të nevojave të saj, ku pjesa më e madhe është përdorur si ushqim i kafshëve. Për të përmbushur nevojat e përgjithshme, misër edhe importohet dhe bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 16.7 mil. €, e që u thellua për shkak të çmimeve më të larta në vitin 2022, përkundër faktit se sasia e importuar ishte më e ulët krahasuar me vitin 2021. Konsumi mesatar për kokë banori për misër, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje misri në vitin 2022 ishte 40 kg.

**Tabela 19: Bilanci i furnizimit për misrin, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me drithëra	ha	123,869	124,199	124,714	124,477	124,618
Sipërfaqja me misër	ha	38,453	39,441	39,684	39,710	39,797
Pjesëmarrja e misrit	%	31.0	31.8	31.8	31.9	31.9
Rendimenti	t/ha	3.95	4.16	4.41	4.29	4.40
Prodhimi	t	151,921	163,930	175,180	170,393	175,226
Importi i misrit dhe eku. të misrit*	t (p.e)	54,071	55,498	58,741	48,595	40,803
Importi i farës së misrit	t	589	635	571	521	583
Importi i misrit	t	48,770	50,796	51,540	40,700	32,411
Importi i miellit të misrit	t	796	32	1,365	1,547	81
Importi i produkteve tjera të misrit	t	2,346	2,697	3,076	3,363	4,916
Furnizimi	t	205,992	219,428	233,921	218,988	216,029
Eksporti i misrit dhe eku. të misrit*	t (p.e)	303	328	555	445	548
Eksporti i farës së misrit	t	28	81	157	54	21
Eksporti i misrit	t	63	48	111	1	14
Eksporti i miellit të misrit	t	25	43	71	48	62
Eksporti i produkteve tjera të misrit	t	83	66	90	154	203
Përdorimi vendor	t	205,689	219,100	233,366	218,543	215,482
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	73.9	74.8	75.1	78.0	81.3
Farë misri	t	769	789	794	794	796
Humbjet	t	4,558	4,918	5,255	5,112	5,257
Ushqimi për kafshë	t	117,275	126,579	135,305	131,590	135,339
Përdorimi industrial	t	2,904	2,990	3,157	2,648	2,260
Procesimi	t	13,749	15,145	16,065	15,431	15,958
Konsumi njerëzor	t	66,434	68,679	72,790	62,968	55,872
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.26	0.22	0.25	0.28	0.32
Vlera e prodhimit	mil. EUR	39.5	36.1	43.8	47.7	56.1
Bilanci tregtar i misrit dhe eku. të misrit	mil. EUR	-10.8	-11.6	-13.2	-15.6	-16.7
Bilanci tregtar për farë misri	mil. EUR	-1.0	-1.4	-1.1	-1.6	-2.5
Bilanci tregtar për misër	mil. EUR	-7.8	-8.2	-9.3	-10.3	-8.8
Bilanci tregtar për miell misri	mil. EUR	-0.2	0.0	-0.3	-0.4	0.0
Bilanci tregtar për produkte tjera të misrit	mil. EUR	-1.8	-2.1	-2.5	-3.3	-5.4
Konsumi për kokë banori	kg	45	47	49	44	40

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18/'19/'20/'21/'22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZhr

Sqarim: Për të gjitha të dhënat e tregtisë (eksporti dhe importit) viti i prezantuar në tabelë përfshinë periudhën korrik-dhjetor të atij viti dhe janar-qershor të vitit pasues; p.e - nënkupton ekuivalentët e produktit, d.m.th çdo produkt me përmbajtje misri i konvertuar në misër; \*Importi i misrit dhe eku. të misrit dhe Eksporti i misrit dhe eku. të misrit, nënkupton eksportin ose importin e sasisë së misrit si dhe të të gjitha produkteve tjera që përmbajnë misër e që përmes koeficientëve të konvertimit janë të konvertuara në misër.

## 2.2.2 Perimet

Në Kosovë gjatë vitit 2022, llogariten gjithsej 19,571 ha sipërfaqet me perime të kultivuara në fushë të hapur, në serra dhe në kopshte. Kulturat të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë: patatja (3,884 ha), speci (3,154 ha), kungulli (2,628 ha), fasulja (2,941 ha), qepa (1,376 ha), shalqiri (1,316 ha), lakra (937 ha), kungulli i misirit (926 ha), domatja (805 ha), pjepri (329 ha), trangulli (315 ha), hudhëra (270 ha), spinaqi (162 ha), karota (132 ha) dhe kulturat tjera perimore të cilat ndajnë një sipërfaqe më të vogël nën 100 ha krahasuar me kulturat e prezantuara më lartë.

Nëse analizohet ndryshimi mes vitit 2021 dhe 2022, totali i përgjithshëm i sipërfaqeve me perime është rritur për 0.9%. Nëse i referohemi kulturave perimore vërehet se të gjitha kulturat kanë shënuar rritje të lehtë në sipërfaqe, përpos, rrepkës, bizeles dhe bishtajoreve të tjera të cilat kanë shënuar zvogëlim të sipërfaqeve.

**Tabela 20: Sipërfaqja me perime, 2018 - 2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Sipërfaqja	ha					
Perime	17,886	18,911	19,243	19,399	19,571	0.9
Patate	3,606	3,688	3,771	3,854	3,884	0.8
Domate	757	794	815	800	805	0.6
Patëllxhan i zi	6	8	7	8	9	7.8
Spec	3,038	3,108	3,134	3,146	3,154	0.2
Kungull	2,255	2,502	2,577	2,612	2,628	0.6
Kungull misiri	810	898	913	918	926	0.9
Trangull	273	304	313	305	315	3.3
Shalqi	1,182	1,216	1,303	1,309	1,316	0.5
Pjepër	298	313	318	321	329	2.5
Lakër	832	906	918	923	937	1.5
Lulelakër	46	53	50	52	57	8.8
Spinaq	160	197	150	154	162	5.6
Sallatë	78	88	79	82	84	2.7
Panxhar i kuq	9	9	7	7	9	22.4
Rrepkë (rillkë)	5	5	5	5	4	-11.3
Majdanoz	11	11	11	12	14	14.9
Presh (purri)	72	75	76	78	80	2.5
Qepë	1,185	1,354	1,367	1,369	1,376	0.5
Hudhër	146	234	264	263	270	2.8
Fasule	2,845	2,888	2,904	2,914	2,941	0.9
Bizele	55	67	68	69	68	-2.4
Bishtajoret tjera	69	42	43	46	44	-4.2
Karota	112	121	126	129	132	2.5
Perime tjera	37	29	22	23	26	11.0

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22)



Në aspektin e prodhimit, gjatë vitit 2022 prodhimi i perimeve shënon rritje për 4.6%, gjithsej 295,802 tonë për totalin e sipërfaqes prej 19,571 ha.

Nëse analizojmë të dhënat e prodhimit të kulturave perimore gjatë vitit 2022, vërejmë se sa i përket sasisë së prodhimit, gjitha kulturat perimore kanë shënuar rritje. Mirëpo, edhe këtë vit sikurse në vitin 2021 kulturat afërsisht të njëjta si patatja, speci, shalqiri, lakra, kungulli, kungulli i misirit, domatja kanë sasi prodhimi mbi 20,000 tonë, pasuar nga kulturat tjera si qepa, trangulli, pjepri, fasulja, etj. të cilat shënojnë sasi të ulët të prodhimit nën 20,000 tonë.

**Tabela 21: Prodhimi i perimeve, 2018 – 2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Prodhimi	t					
Perime	265,420	300,559	290,555	282,734	295,802	4.6
Patate	68,790	73,816	74,508	73,984	75,500	2.0
Domate	22,639	22,466	20,242	19,163	20,206	5.4
Patëllxhan i zi	107	155	137	144	174	22.0
Spec	49,907	59,404	53,889	52,381	55,353	5.7
Kungull	20,208	23,050	22,535	22,326	22,551	1.0
Kungull misiri	18,376	21,570	21,712	20,896	21,975	5.2
Trangull	7,009	9,173	9,055	8,480	8,973	5.8
Shalqi	22,918	25,209	26,324	25,971	27,490	5.8
Pjepër	4,141	4,409	4,335	4,103	4,467	8.9
Lakër	21,997	25,259	24,850	24,123	25,546	5.9
Lulelakër	725	1,004	905	885	954	7.8
Spinaq	1,348	2,053	1,452	1,408	1,557	10.6
Sallatë	683	835	677	635	708	11.6
Panxhar i kuq	73	80	56	51	67	32.5
Rrepkë (rillkë)	39	52	49	45	50	10.2
Majdanoz	87	125	123	130	151	15.6
Presh (purri)	1,303	1,440	1,425	1,398	1,465	4.8
Qepë	16,317	19,879	18,859	17,792	19,190	7.9
Hudhër	873	1,628	1,588	1,471	1,594	8.4
Fasule	5,688	6,713	5,708	5,349	5,597	4.6
Bizele	146	169	152	138	154	11.6
Bishtajoret tjera	254	139	126	116	116	0.5
Karota	1,493	1,703	1,694	1,585	1,770	11.7
Perime tjera	298	227	155	162	194	19.8

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22)

Sa i përket rendimentit të perimeve për vitin 2022 të gjitha kulturat kanë shënuar rritje, përpos lulelakrës që shënon një ulje të lehtë me 1%. Rritje më të theksuar në rendiment kishin rrepka, bizelja dhe patëllxhani i zi.

**Tabela 22: Rendimenti i perimeve, 2018 – 2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Rendimenti	t /ha					
Patate	19.08	20.01	19.76	19.20	19.44	1.2
Domate	29.90	28.29	24.84	23.95	25.10	4.8
Patëllxhan i zi	16.90	19.19	18.44	17.34	19.62	13.2
Spec	16.43	19.11	17.19	16.65	17.55	5.4
Kungull	8.96	9.21	8.74	8.55	8.58	0.4
Kungull misiri	22.70	24.01	23.77	22.76	23.72	4.2
Trangull	25.66	30.20	28.91	27.82	28.50	2.5
Shalqi	19.38	20.73	20.20	19.84	20.89	5.3
Pjepër	13.92	14.08	13.64	12.80	13.59	6.2
Lakër	26.44	27.88	27.07	26.13	27.26	4.3
Lulelakër	15.93	18.84	18.00	16.96	16.79	-1.0
Spinaq	8.44	10.41	9.71	9.15	9.58	4.7
Sallatë	8.79	9.47	8.58	7.76	8.43	8.6
Panxhar i kuq	8.43	8.99	7.97	7.13	7.72	8.3
Rrepkë (rillkë)	8.32	10.52	10.07	9.11	11.31	24.2
Majdanoz	8.15	11.20	10.95	10.63	10.69	0.6
Presh (purri)	18.00	19.29	18.82	17.97	18.38	2.3
Qepë	13.77	14.68	13.80	13.00	13.94	7.3
Hudhër	5.97	6.97	6.00	5.59	5.90	5.4
Fasule	2.00	2.32	1.97	1.84	1.90	3.7
Bizele	2.64	2.52	2.23	1.99	2.27	14.3
Bishtajoret tjera	3.67	3.27	2.91	2.53	2.66	4.9
Karota	13.35	14.09	13.46	12.28	13.38	9.0
Perime tjera	8.12	7.79	7.05	6.98	7.53	7.9

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18/'19/'20/'21/'22)

Sa i përket sipërfaqeve me kultura të dyta pas korrjes së parë gjatë vitit 2022, këto sipërfaqe janë rritur për 6.3%. Rritje kanë shënuar të gjitha kulturat e dyta pas korrjes së parë (spinaqi, lakra, qepa dhe sallata), përpos kategorisë të tjerat ku vërehet zvogëlim i sipërfaqeve për 2.2%. Ndërsa sa i përket prodhimit, prodhimi shënon rritje për 14.3% krahasuar me vitin 2021, dhe reflektohet tek të gjitha kulturat e dyta (lakër, spinaq, qepa, sallata dhe të tjerat), rendimenti po ashtu paraqitet me rritje tek të gjitha kulturat.

**Tabela 23: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave të dyta pas korrjes së parë**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Sipërfaqja</b>	ha					
<b>Perime</b>	<b>233</b>	<b>278</b>	<b>281</b>	<b>285</b>	<b>303</b>	<b>6.3</b>
Lakër	99	81	88	91	98	8.1
Spinaq	66	155	145	142	150	5.9
Sallatë	18	4	6	6	6	3.3
Qepë	10	27	28	32	34	7.4
Të tjera	41	11	14	15	15	-2.2
<b>Prodhimi</b>	t					
<b>Perime</b>	<b>3,451</b>	<b>3,000</b>	<b>3,008</b>	<b>2,992</b>	<b>3,421</b>	<b>14.3</b>
Lakër	2,362	2,000	2,106	2,090	2,349	12.4
Spinaq	271	596	466	426	556	30.5
Sallatë	124	14	18	17	20	17.6
Qepë	80	186	187	208	242	16.2
Të tjera	614	204	231	251	254	1.4
<b>Rendimenti</b>	t/ha					
Lakër	23.81	24.68	23.93	23.05	23.96	3.9
Spinaq	4.12	3.84	3.21	3.01	3.70	23.2
Sallatë	6.75	3.46	2.98	2.93	3.33	13.8
Qepë	8.34	6.95	6.68	6.58	7.12	8.3
Të tjera	15.16	17.91	16.48	16.45	17.05	3.6

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22)

Domatja përbën 4.1%, nga gjithsej sipërfaqja e mbjellë me perime prej 19,571 ha për vitin 2022. Sipërfaqja dhe prodhimi i domates kanë shënuar rritje gjatë viti 2022, krahasuar me vitin 2021 për 0.6% sipërfaqja, ndërsa prodhimi 5.4%.

Duke ju referuar të dhënave të cekura më lartë, mund të themi se me kulturën e domates mbulohen gjithsej 64.1% të nevojave për konsum. Pjesa tjetër mbulohet nga importi me 13,176 tonë, ndërsa eksporti shënon 481 tonë, që nëse krahasojmë me vitin 2021 importi ka shënuar rënie, ndërsa eksporti rritje, të dy këto ndryshime të dukshme sa i përket shkëmbimit tregtar.

Çmimi për kulturën e domates për vitin 2022 shënon 0.66 €/kg, ndërsa vlera e prodhimit ishte 12.8 mil. €. Sa i përket bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ edhe për vitin 2022.

**Tabela 24: Bilanci i furnizimit për domaten, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me perime	ha	17,886	18,911	19,243	19,399	19,571
Sipërfaqja me domate	ha	757	794	815	800	805
Pjesëmarrja	%	4.2	4.2	4.2	4.1	4.1
Rendimenti	t/ha	29.90	28.29	24.84	23.95	25.10
Prodhimi	t	22,639	22,466	20,242	19,163	20,206
Importi i domates	t	16,900	15,663	15,547	18,685	13,176
Furnizimi	t	39,539	38,130	35,789	37,848	33,382
Eksporti i domates	t	166	532	205	136	481
Përdorimi vendor	t	39,374	37,598	35,584	37,713	32,901
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	57.5	59.8	56.9	50.8	61.4
Humbjet	t	906	899	810	767	808
Procesimi	t	217	216	194	184	194
Vetë konsumi final	t	4,129	4,098	3,692	3,495	3,686
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	38,468	36,699	34,774	36,946	32,093
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.62	0.57	0.33	0.52	0.66
Vlera e prodhimit	mil. €	13.5	12.3	6.4	9.6	12.8
Bilanci tregtar i domates	mil. €	-6.0	-5.6	-5.3	-6.4	-6.6

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21, '22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Në gjithsej sipërfaqe e mbjellë me perime për vitin 2022 prej 19,571 ha, kultura e specit merr pjesë me 16.1%. Prodhimi arriti 55,353 tonë duke shënuar kështu rritje 5.7% për sa i përket kulturës së specit krahasuar me vitin 2021.

Përmbushja e nevojave për konsum me kulturën e specit shënon 86.5%. Sasia e importuar e specit ishte 10,163 tonë, kurse ajo e eksportuar 1,529 tonë, dukshëm më ndryshe se gjatë vitit 2021.

Çmimi për kulturën e specit për vitin 2022 shënon 0.78 €/kg. Nga gjithsej përdorimi vendor prej 63,987 tonë, për konsum të përgjithshëm janë shfrytëzuar 61,773 tonë, si humbje llogariten 2,214 tonë, ndërsa për procesim janë destinuar 531 tonë.

Vlera e prodhimit të specit shënon 41.4 mil. €, kurse bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ me 4.4 mil. €.

**Tabela 25: Bilanci i furnizimit për specin, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me perime	ha	17,886	18,911	19,243	19,399	19,571
Sipërfaqja me spec	ha	3,038	3,108	3,134	3,146	3,154
Pjesëmarrja	%	17.0	16.4	16.3	16.2	16.1
Rendimenti	t/ha	16.43	19.11	17.19	16.65	17.55
Prodhimi	t	49,907	59,404	53,889	52,381	55,353
Importi i specit	t	11,524	11,001	9,752	11,389	10,163
Furnizimi	t	61,431	70,405	63,641	63,771	65,516
Eksporti i specit	t	582	962	1,862	2,050	1,529
Përdorimi vendor	t	60,850	69,443	61,779	61,721	63,987
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	82.0	85.5	87.2	84.9	86.5
Humbjet	t	1,996	2,376	2,156	2,095	2,214
Procesimi	t	479	570	517	503	531
Vetë konsumi final	t	9,103	10,835	9,829	9,554	10,096
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	58,853	67,067	59,623	59,625	61,773
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.91	0.76	0.54	0.62	0.78
Vlera e prodhimit	mil. €	43.6	43.3	27.9	31.2	41.4
Bilanci tregtar i specit	mil. €	-4.8	-5.4	-3.3	-3.3	-4.4

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21, '22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Kultura e patates shënon gjithsej 3,884 ha apo 19.8% në totalin e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me perime prej 19,571 për vitin 2022.

Sipërfaqja dhe prodhimi i patates shënojnë një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021 ku 0.8% shënon gjithsej sipërfaqja e rritur ndërsa prodhimi 2%, bazuar në këto të dhëna kjo sasi prodhimi arrin të mbulojë 94% të nevojave të brendshme për konsum.

Importi i patates shënon 10,642 tonë, ndërsa eksporti 5,815 tonë. Bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 2.3 mil. €.

Çmimi për kulturën e patates gjatë vitit 2022 shënoi 0.49 €/kg dhe konsumi i përgjithshëm ishte 76,552 tonë. Si humbje llogariten 3,775 tonë, procesim 3,586 tonë, ndërsa konsum final 21,518 tonë.

**Tabela 26: Bilanci i furnizimit për pataten, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me perime	ha	17,886	18,911	19,243	19,399	19,571
Sipërfaqja me patate	ha	3,606	3,688	3,771	3,854	3,884
Pjesëmarrja	%	20.2	19.5	19.6	19.9	19.8
Rendimenti	t/ha	19.08	20.01	19.76	19.20	19.44
Prodhimi	t	68,790	73,816	74,508	73,984	75,500
Importi i patates	t	3,545	5,566	5,151	10,607	10,642
Furnizimi	t	72,335	79,382	79,659	84,591	86,142
Eksporti i patates	t	11,752	10,219	11,879	4,499	5,815
Përdorimi vendor	t	60,583	69,163	67,780	80,093	80,327
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	113.5	106.7	109.9	92.4	94.0
Humbjet	t	3,440	3,691	3,725	3,699	3,775
Procesimi	t	3,268	3,506	3,539	3,514	3,586
Vetë konsumi final	t	19,605	21,037	21,235	21,086	21,518
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	57,144	65,473	64,054	76,393	76,552
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.33	0.27	0.28	0.42	0.49
Vlera e prodhimit	mil. €	21.6	18.9	19.8	29.5	35.1
Bilanci tregtar i patates	mil. €	0.7	-0.2	0.6	-1.8	-2.3

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21, '22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

### 2.2.3 Pemët

Në Kosovë gjatë vitit 2022 janë mbjellë gjithsej 10,619 ha me pemë, apo 2.3% më shumë se sa në vitin 2021. Kjo sipërfaqe njëherit shënon sipërfaqen më të madhe të mbjellë me pemë në vitet e fundit (2018-2022), ku mesatarja e gjithsej e sipërfaqeve të mbjella me pemë për këtë periudhë ishte 9,512 ha.

Vlen të ceket se të gjitha kulturat pemëtare gjatë viti 2022 kanë shënuar rritje të sipërfaqeve në raport me vitin 2021, nisur nga arra me 13.9%, pemët tjera 7.2%, boronica 4.9%, kajsia 4.1%, pjeshka 3.8%, manaferra 3.4%, pasuar nga kulturat tjera pemëtare të cilat shënuan rritje më të lehtë. Ndërsa, kulturat të cilat kishin sipërfaqe më të mëdha gjatë vitit 2022 janë: molla 3,091 ha, kumbulla 2,214 ha, mjedra 1,668 ha, arra 1,540 ha, pasuar nga dardha, lajthia, dredhëza, vishnja, etj. të cilat kishin sipërfaqe nën 1,000 ha.

Sa i përket prodhimit të pemëve që shënon 75,713 tonë për vitin 2022, kjo sasi paraqitet për 12.1% më e lartë krahasuar me vitin 2021. Sa i përket prodhimtarisë të gjitha kulturat kanë shënuar rritje të prodhimtarisë, nisur nga lajthia 68.1%, pemët tjera 49.3%, arra 47.1%, pasuar nga boronica, pjeshka, kajsia, etj.

Sa i përket sasisë së prodhimit për vitin 2022, kulturat të cilat kanë shënuar sasi të prodhimit më të lartë e të cilat ishin të njëjta kultura edhe për vitin 2021 janë: molla (40,028 tonë), kumbulla (13,284 tonë), mjedra (6,740 tonë), dardha (5,649 tonë), arra (3,100 tonë), pasuar nga kultura tjera me sasi më të ulët prodhimi.

**Tabela 27: Sipërfaqja dhe prodhimi i pemëve, 2018 - 2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>					
<b>Pemët</b>	<b>7,922</b>	<b>9,479</b>	<b>10,265</b>	<b>10,382</b>	<b>10,619</b>	<b>2.3</b>
Molla	2,556	3,006	3,068	3,083	3,091	0.2
Dardha	479	610	614	618	629	1.8
Ftoni	64	90	91	93	95	2.1
Mushmolla	50	51	51	53	54	1.5
Kumbulla	1,821	2,096	2,201	2,210	2,214	0.2
Kajsia	14	22	22	24	24	4.1
Pjeshka	34	47	48	51	53	3.8
Qershia	82	107	108	110	112	1.7
Vishnja	167	232	233	240	242	0.7
Arra	608	886	1,295	1,352	1,540	13.9
Lajthia	119	252	390	391	393	0.4
Dredhëza	234	235	236	238	242	1.5
Mjedra	1,537	1,637	1,661	1,665	1,668	0.2
Manaferra	24	30	31	32	33	3.4
Boronica	37	57	86	93	98	4.9
Aronia	-	88	98	98	99	1.2
Pemë tjera	94	31	32	30	32	7.2
<b>Prodhimi</b>	<b>t</b>					
<b>Pemët</b>	<b>53,606</b>	<b>67,294</b>	<b>72,265</b>	<b>67,533</b>	<b>75,713</b>	<b>12.1</b>
Molla	26,093	33,835	38,049	37,381	40,028	7.1
Dardha	3,500	5,110	5,586	4,953	5,649	14.0
Ftoni	925	1,283	1,264	1,266	1,329	5.0
Mushmolla	179	222	219	213	243	14.2
Kumbulla	10,643	12,745	13,147	11,247	13,284	18.1
Kajsia	38	100	94	94	113	20.2
Pjeshka	199	330	288	262	320	22.2
Qershia	410	586	538	485	561	15.6
Vishnja	427	777	740	705	779	10.5
Arra	761	2,028	2,591	2,108	3,100	47.1
Lajthia	29	80	116	101	170	68.1
Dredhëza	1,316	1,677	1,487	1,439	1,686	17.1
Mjedra	8,267	7,206	6,659	5,840	6,740	15.4
Manaferra	246	239	233	223	251	12.7
Boronica	306	310	464	469	596	27.2
Aronia	-	666	692	656	728	11.0
Pemë tjera	265	101	97	90	135	49.3

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22)

Sa i përket rendimentit të pemëve për vitin 2022, të gjitha kulturat pemëtare shënuan rritje të rendimentit gjatë këtij viti, e kjo rritje shoqëruar me rritjen në sipërfaqe është reflektuar tek rritja e prodhimit tek të gjitha kulturat pemëtare. Rritje më të lartë të rendimentit kishin: lajthia, arra, boronica, kumbulla, pjeshka dhe kulturat e tjera pemëtare.

**Tabela 28: Rendimenti i pemëve, 2018 - 2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>					
Molla	10.21	11.25	12.40	12.12	12.95	6.8
Dardha	7.31	8.38	9.10	8.01	8.97	12.0
Ftoni	14.47	14.24	13.94	13.61	14.00	2.8
Mushmolla	3.60	4.36	4.27	4.00	4.50	12.5
Kumbulla	5.84	6.08	5.97	5.09	6.00	17.9
Kajsia	2.79	4.56	4.23	4.00	4.62	15.4
Pjeshka	5.78	6.95	6.00	5.17	6.09	17.7
Qershia	4.98	5.46	4.98	4.40	5.00	13.7
Vishnja	2.55	3.34	3.17	2.94	3.22	9.8
Arra	1.25	2.29	2.00	1.56	2.01	29.1
Lajthia	0.25	0.32	0.30	0.26	0.43	67.3
Dredhëza	5.62	7.14	6.30	6.04	6.97	15.5
Mjedëra	5.38	4.40	4.01	3.51	4.04	15.2
Manaferra	10.16	7.88	7.53	6.92	7.54	9.0
Boronica	8.20	5.48	5.40	5.03	6.10	21.2
Aronia	-	7.55	7.08	6.69	7.34	9.7
Pemë tjera	2.81	3.24	3.03	3.00	4.18	39.3

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22)

Nga sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me pemë 10,619 ha, kultura e mollës merr pjesë me 29.1%.

Sipërfaqja e mollës ka shënuar rritje jo shumë të madhe gjatë vitit 2022 për 0.2% krahasuar me vitin 2021, ndërsa prodhimi shënon rritje për 7.1% krahasuar me vitin 2021. Me këtë sasi prodhim arrihet të mbulohen 78.5% të nevojave për konsum dhe pjesa tjetër mbulohet nga importi.

Importi për kulturën e mollës shënon 11,457 tonë, ndërsa sasia e eksportit 481 dukshëm më e lartë se në vitin 2021. Vlera e prodhimit shënon 15.5 mil. € ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ me 3.5 mil. €.

Konsumi i përgjithshëm llogaritet 47,001 tonë, humbje llogariten 4,003 tonë, procesim 3,603 tonë ndërsa si konsum final 21,615 tonë.



**Tabela 29: Bilanci i furnizimit për mollën, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me pemë	ha	7,922	9,479	10,265	10,382	10,619
Sipërfaqja me mollë	ha	2,556	3,006	3,068	3,083	3,091
Pjesëmarrja	%	32.3	31.7	29.9	29.7	29.1
Rendimenti	t/ha	10.21	11.25	12.40	12.12	12.95
Prodhimi	t	26,093	33,835	38,049	37,381	40,028
Importi i mollës	t	8,544	8,882	11,162	10,938	11,457
Furnizimi	t	34,637	42,718	49,211	48,319	51,485
Eksporti i mollës	t	166	532	205	136	481
Përdorimi vendor	t	34,472	42,186	49,006	48,183	51,004
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	75.7	80.2	77.6	77.6	78.5
Humbjet	t	2,609	3,384	3,805	3,738	4,003
Procesimi	t	2,348	3,045	3,424	3,364	3,603
Vetë konsumi final	t	14,090	18,271	20,547	20,186	21,615
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	31,862	38,802	45,201	44,445	47,001
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.40	0.39	0.31	0.44	0.43
Vlera e prodhimit	mil. €	9.4	11.9	10.6	14.8	15.5
Bilanci tregtar i mollës	mil. €	-3.2	-3.1	-3.4	-3.2	-3.5

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21, '22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Sipërfaqet me kulturën e kumbullës shënojnë 2,214 ha, apo pjesëmarrje prej 20.8% në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me pemë prej 10,619 ha. Prodhimi i kumbullës për vitin 2022 shënon 13,284 tonë, apo 18.1% krahasuar me vitin 2021.

Përmbushja e nevojave për konsum me kumbull në vendin tonë shënon 97.8%. Pjesa tjetër mbulohet nga importi i cili shënon gjithsej 296 tonë, kurse eksporti për kulturën e kumbullës paraqitet me një sasi të ulët prej vetëm 4 tonë.

Përdorimi vendor shënon gjithsej 13,576 tonë, si humbje llogariten 930 tonë, kurse procesim janë gjithsej 2,471 tonë. Çmimi për kulturën e kumbullës gjatë viti 2022 shënoj 0.78 €/kg.

Vlera e prodhimit shënon 9.6 mil. €, ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ prej 0.1 mil. €.

**Tabela 30: Bilanci i furnizimit për kumbullën, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me pemë	ha	7,922	9,479	10,265	10,382	10,619
Sipërfaqja me kumbull	ha	1,821	2,096	2,201	2,210	2,214
Pjesëmarrja	%	23.0	22.1	21.4	21.3	20.8
Rendimenti	t/ha	4.85	4.85	4.85	4.85	4.85
Prodhimi	t	10,643	12,745	13,147	11,247	13,284
Importi i kumbullës	t	219	605	770	649	296
Furnizimi	t	10,863	13,350	13,918	11,895	13,580
Eksporti i kumbullës	t	179	1	86	0.20	4
Përdorimi vendor	t	10,684	13,348	13,832	11,895	13,576
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	99.6	95.5	95.1	94.5	97.8
Humbjet	t	745	892	920	787	930
Procesimi	t	1,980	2,371	2,445	2,092	2,471
Vetë konsumi final	t	6,434	7,704	7,947	6,799	8,030
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	9,939	12,456	12,911	11,108	12,646
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.73	0.51	0.71	0.81	0.78
Vlera e prodhimit	mil. €	7.2	6.0	8.7	8.5	9.6
Bilanci tregtar i kumbullës	mil. €	-0.1	-0.2	-0.2	-0.3	-0.1

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21, '22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Kultura e dredhëzës shënon gjithsej 242 ha, apo 2.3% në totalin e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me pemë prej 10,619 për vitin 2022.

Sipërfaqja dhe prodhimi i dredhëzës paraqitet me rritje krahasuar me vitin 2021, ku 1.5% shënon gjithsej sipërfaqja e rritur, ndërsa prodhimi 17.1%, bazuar në këto të dhëna kjo sasi prodhimi arrin të mbulojë 62.5% të nevojave të brendshme për konsum.

Importi i dredhëzës shënon 1,195 tonë, ndërsa eksporti 182 tonë. Bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 0.7 mil. €.

Çmimi për kulturën e dredhëzës gjatë vitit 2022 shënoi 1.19 €/kg dhe konsumi i përgjithshëm ishte 2,581 tonë. Si humbje llogariten 118 tonë, procesim 314 tonë ndërsa konsum final 1,019 tonë.

**Tabela 31: Bilanci i furnizimit për dredhëzën, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me pemë	ha	7,922	9,479	10,265	10,382	10,619
Sipërfaqja me dredhëz	ha	234	235	236	238	242
Pjesëmarrja	%	3.0	2.5	2.3	2.3	2.3
Rendimenti	t/ha	5.62	7.14	6.30	6.04	6.97
Prodhimi	t	1,316	1,677	1,487	1,439	1,686
Importi i dredhëzës	t	545	844	482	726	1,195
Furnizimi	t	1,861	2,521	1,969	2,165	2,881
Eksporti i dredhëzës	t	107	93	74	204	182
Përdorimi vendor	t	1,754	2,428	1,895	1,961	2,699
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	75.0	69.1	78.5	73.4	62.5
Humbjet	t	92	117	104	101	118
Procesimi	t	245	312	277	268	314
Vetë konsumi final	t	795	1,014	899	870	1,019
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	1,662	2,311	1,791	1,861	2,581
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	1.03	1.12	1.16	1.22	1.19
Vlera e prodhimit	mil. €	1.3	1.7	1.6	1.6	1.9
Bilanci tregtar i dredhëzës	mil. €	-0.2	-0.4	-0.2	-0.2	-0.7

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21, '22); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

## 2.2.4 Vreshtat dhe verërat

### Vreshtat

Gjatë vitit 2022, sipërfaqet e përgjithshme me vreshta shënojnë 3,472 ha, krahasuar me vitin paraprak vërehet rritje e ulët prej 0.03%. Sipërfaqet me rrush tryeze janë rritur për 1.39%, ndërsa ato me rrush për verë janë zvogëluar për 0.47%. Prodhimi shënon gjithsej 23,506 tonë dhe ka pësuar zvogëlim prej 11.4%, e kjo si rezultat se rendimenti është zvogëluar për 11.4%. Këto rezultate jo shumë të favorshme, sikurse edhe vitin 2021, kanë ardhur si pasojë e problemeve gjatë vjeljes dhe reshjeve të shiut gjë që kanë shkaktuar edhe dëmtimin e rrushit.


**Tabela 32: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i rrushit, 2018-2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>					
<b>Vreshta</b>	<b>3,272</b>	<b>3,367</b>	<b>3,437</b>	<b>3,471</b>	<b>3,472</b>	<b>0.03</b>
Rrush tryeze	816	878	911	938	951	1.39
Rrush për verë	2,455	2,489	2,526	2,533	2,521	-0.47
<b>Prodhimtaria</b>	<b>t</b>					
<b>Vreshta</b>	<b>27,322</b>	<b>19,318</b>	<b>26,330</b>	<b>26,527</b>	<b>23,506</b>	<b>-11.4</b>
Rrush tryeze	4,998	4,546	6,281	7,435	7,045	-5.2
Rrush për verë	22,324	14,772	20,049	19,091	16,461	-13.8
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>					
<b>Vreshta</b>	<b>8.4</b>	<b>5.7</b>	<b>7.7</b>	<b>7.6</b>	<b>6.8</b>	<b>-11.4</b>
Rrush tryeze	6.1	5.2	6.9	7.9	7.4	-6.5
Rrush për verë	9.1	5.9	7.9	7.5	6.5	-13.4

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sipërfaqet me vreshta nga viti 2018 deri në vitin 2022, janë paraqitur në figurën në vijim. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur rritje simbolike të sipërfaqeve të vreshtave.


**Figura 22: Sipërfaqja e vreshtave në ha, 2018-2022**



Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Prodhimi i rrushit për periudhën 2018-2022, është paraqitur në figurën në vijim, ku vërehet se ka pasur luhajtje të vazhdueshme ndër vite, në vitin 2019 theksohet rënie e dukshme, në vitet 2020 dhe 2021 u shënua rritje e prodhimit të rrushit, ndërsa në vitin 2022 u shënua prapë një rënie e ulët e prodhimit të rrushit. Viti i vjeljes 2022 është karakterizuar me probleme sepse muaji Shtator dhe muaji Tetor janë karakterizuar me reshje shiu, gjë që ka shkaktuar problem në procesin e vjeljes, si rezultat i kësaj ka pasur dëmtim të rrushit, pasuar edhe me probleme në shitje. Këtë vit sipas DVV, kanë raportuar 308 fermer që nuk kanë vjelë ose kanë vjelë pak rrush, ndërsa sipërfaqja e rrushit që ka mbetur pa u vjelë vlerësohet të jetë 172 ha.

**Figura 23: Prodhimi i rrushit në tonë, 2018-2022**



Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej sipërfaqet me vreshta prej 3,472 ha, rrushi i tryezës merr pjesë me 27%, ndërsa prodhimi llogaritet 7,045 tonë. Me këtë sasi të prodhimit vendor plotësohen 74% e nevojave për konsum të rrushit të tryezës dhe pjesa tjetër u mbulua nga importi me 2,633 tonë, i cili ishte rreth 11% më i ulët se në vitin 2021.

Eksporti i rrushit të tryezës në vitin 2022 ka pasur një rritje të konsiderueshme, ku nga 25 tonë sa ishte në vitin paraprak u rrit në 96 tonë në vitin 2022. Vlera e prodhimit në vitin 2022, llogaritet 4.9 mil. €, ndërsa çmimi i rrushit të tryezës shënoj 0.69 €/kg. Bilanci tregtar edhe për vitin 2022 vazhdon të jetë negativ me vlerë prej 1.3 mil €.

**Tabela 33: Bilanci i furnizimit për rrush tryeze, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqja me vreshta	ha	3,272	3,367	3,437	3,471	3,472
Sipërfaqja me rrush tryeze	ha	816	878	911	938	951
Pjesëmarrja	%	25	26	27	27	27
Rendimenti	t/ha	6.1	5.2	6.9	7.9	7.4
Prodhimi	t	4,998	4,546	6,281	7,435	7,045
Importi i rrushit të tryezës	t	2,554	3,538	2,644	2,970	2,633
Furnizimi me rrush tryeze	t	7,552	8,084	8,925	10,406	9,678
Eksporti i rrushit të tryezës	t	173	103	78	25	96
Përdorimi vendor	t	7,379	7,981	8,847	10,381	9,582
Shkalla e vetëmajftueshmërisë	%	68	57	71	72	74
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.78	0.68	0.63	0.53	0.69
Vlera e prodhimit	mil.€	3.9	3.1	4.0	3.9	4.9
Bilanci tregtar	mil.€	-1.2	-1.7	-1.2	-1.4	-1.3

Burimi: ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari; kalkulime nga DAESB-MBPZhR

Tabela në vijim përmban të dhënat për varietetet e rrushit të tryezës përfshirë sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e tyre.

Nga të dhënat e paraqitura vërehet se në vitin 2022, gjithsej sipërfaqja e kultivuar me rrush tryeze ishte 951 ha, apo 13 ha më shumë se në vitin 2021 që shënon një rritje të ulët prej 1.39%, ndërsa kushtet klimatike kanë ndikuar në uljen e prodhimit në vitin 2022, e cila ishte 7,046 tonë apo 5.2% më pak se sa në vitin 2021.

Referuar varieteteve të rrushit të tryezës, vërehet se sipërfaqja me varietetin Muskat Hamburg prinë me 279 ha, pasuar nga varieteti Muskat Italian me 199 ha, varietetin Afuz Ali me 121 ha, varietetin Kardinal me 97 ha dhe varietetin Viktoria me 96 ha. Varietetet tjera kultivohen në sipërfaqe më të vogël dhe përbëjnë 255 ha të gjithsej sipërfaqes së kultivuar me rrush tryeze për vitin 2022.

**Tabela 34: Varietetet e rrushit të tryezës, 2022**

Varietetet e rrushit të tryezës, 2022					
Nr.	Varietetet	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (t)	Rendimenti (t/ha)	Sipërfaqja në %
1	Muskat Hamburg	279	1,740	6.2	29.4
2	Muskat Italian	199	2,030	10.2	21.0
3	Afuz Ali	121	493	4.1	12.7
4	Kardinal	97	696	7.2	10.2
5	Viktoria	96	821	8.6	10.1
6	Moldavkë	43	434	10.2	4.5
7	Michele Palieri	30	286	9.4	3.2
8	Black Magic	15	105	7.1	1.5
9	Demir Kapi	11	86	7.6	1.2
10	Ribier	9	87	9.2	1.0
11	Antigona	8	58	6.9	0.9
12	Rrush tryezeksperimental	8	26	3.3	0.8
13	Crimson Seedless	7	44	6.5	0.7
14	Red Globe	5	60	10.9	0.6
15	Regina	5	10	2.2	0.5
16	Prima	4	17	3.8	0.5
17	E hershja e Rahovecit	2	1	0.4	0.3
18	Mbretëresha	2	5	2.7	0.2
19	Muskat Korrikut	1	6	5.5	0.1
20	Aromera	1	7	4.7	0.2
21	Katarina	1	4	4.0	0.1
22	Bardhosha	2	8	4.4	0.2
23	Platinia	1	5	5.6	0.1
24	Izabella	1	4	6.9	0.1
25	Strashenski	0	4	8.3	0.1
26	Angela	0	4	9.1	0.0
27	Esther	1	5	8.8	0.1
	<b>Gjithsej</b>	<b>951</b>	<b>7,045</b>	<b>7.4</b>	<b>100.00</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Gjatë vitit 2022, gjithsej 2,521 ha ishin sipërfaqet e kultivuara me varietete të rrushit të verës. Sipërfaqja e kultivuar me varietete të rrushit për prodhimin e verës së kuqe ishte 1,625 ha, ndërsa ajo e kultivuar me varietete për prodhimin e verës së bardhë ishte 897 ha. Nga sipërfaqja e kultivuar me varietete për prodhimin e verës së kuqe prinë varieteti Vranç me 503 ha, pasuar nga varieteti Prokupë me 340 ha, varieteti Game me 235 ha, Burgundez i Zi me 157 ha, si dhe varietete tjera me sipërfaqe prej 390 ha.

Sa i përket varieteteve të rrushit të verës së bardhë, pjesa më e madhe është e kultivuar me varietetin Smederevkë me sipërfaqe 376 ha, pasuar nga Rizlingu Italian me sipërfaqe 231 ha dhe varieteti Shardone me 114 ha, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes prej 176 ha është e kultivuar me varietete tjera.

**Tabela 35: Varietetet e rrushit të verës, 2022**

Nr.	Varietete për verë të kuqe 2022	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (t)	Rendimenti (t/ha)	Sipërfaqja në %
1	Vranç	503	3,536	7	31
2	Prokupë	340	1,148	3	21
3	Game	235	1,374	6	14
4	Burgundez i kuq (Pino Noir)	157	905	6	10
5	Zhametë	97	518	5	6
6	Kabernet Sauvignon	82	525	6	5
7	Merlot	55	285	5	3
8	Syrah	40	230	6	2
9	Frankovkë	25	97	4	2
10	Kabernet Frank	23	19	1	1
11	Game me ngjyrë	23	23	1	1
12	Pllovdin (Rrush i kuq)	16	39	2	1
13	Pinot Grigo (përhimët)	8	74	10	0
14	Petit Verdo	4	45	12	0
15	Carmenere	6	3	1	0
16	Cabernet Volos	3	18	6	0
17	Kalmet	7	5	1	0
18	Kartoshia	1	3	5	0
19	Malbec	0	2	4	0
20	Sheshi i zi	0	2	6	0
21	Sangjovezo	0	1	5	0
22	Marselane	1	3	4	0
<b>Gjithsej varietete për verë të kuqe</b>		<b>1,625</b>	<b>8,855</b>	<b>5</b>	<b>100</b>
Nr.	Varietete për verë të bardhë 2022	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (t)	Rendimenti (t/ha)	Sipërfaqja në %
1	Smederevkë	376	3,376	9	42
2	R. Italian	231	2,104	9	26
3	Shardone	114	892	8	13
4	R. Rajne	60	623	10	7
5	Prokup i bardhë (Zhuplanka)	28	136	5	3
6	Burgundez i Bardhë	23	215	9	3
7	Melnik	11	12	1	1
8	Rrakacitel	11	48	4	1
9	Traminer	8	43	5	1
10	Sovinjon	8	74	9	1
11	Zhillavka	4	19	5	0
12	Sorelis	2	18	9	0
13	Fleurtaï	2	9	5	0
14	Semillon	6	11	2	1
15	Nebibolo	1	1	1	0
16	Malvazia	0	4	15	0
17	Viogner	7	1	0	1
18	Solaris	2	18	9	0
19	Broner	0	1	3	0
20	Muskat i bardhë	3	3	1	0
<b>Gjithsej varietete për verë të bardhë</b>		<b>897</b>	<b>7,606</b>	<b>8</b>	<b>100</b>
<b>Gjithsej rrush i verës</b>		<b>2,521</b>	<b>16,461</b>	<b>6.5</b>	

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZhr

## Verërat

Prodhimi i verës në vitin 2022, duke përfshirë verën e bardhë, të kuqe dhe roze llogaritet gjithsej 7,862 mijë litra. Me sasi të prodhimit më të madhe, krahasuar me vitin 2021 prinë vera roze, prodhimi i saj është rritur për 99%, pasuar nga vera e kuqe që ka pasur rritje prej 5%, ndërsa vera e bardhë ka shënuar ulje për 2% në krahasim me vitin e kaluar.


**Tabela 36: Prodhimi i verës 2018-2022, '000 litra**

Prodhimi	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Verë e bardhë	6,234	3,380	5,100	4,744	4,643	-2
Verë e kuqe	5,441	2,325	4,295	3,001	3,140	5
Verë Roze	69	49	35	40	79	99
<b>Gjithsej verë</b>	<b>11,744</b>	<b>5,754</b>	<b>9,429</b>	<b>7,785</b>	<b>7,862</b>	<b>1</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Prodhimi i verës për periudhën '18-'22, është paraqitur në figurën në vijim e cila tregon gjithsej prodhimin e verës duke përfshirë prodhimin e verës së bardhë, të kuqe dhe roze. Gjatë kësaj periudhe kohore vërehen ndryshime të dukshme në sasinë e përgjithshme të verës së prodhuar, ku viti 2018 cilësohet si vit me prodhim më të lartë, pastaj pason një rënie e dukshme në vitin 2019, për të vazhduar me rritje në vitin 2020, kurse vitet 2021 dhe 2022, karakterizohet me rënie të ulët.

**Figura 24: Prodhimi i verës 2018-2022, '000 litra**



Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Nga të dhënat e paraqitura në vijim sipas kompanive për prodhimin e verës për vitin 2022, vërejmë se sikurse edhe në vitet paraprake ashtu edhe për vitin 2022 prinë me më së shumti prodhim të verës kompania "Stone Castle Vineyards & Winery", pasuar nga kompanitë "Sunny Hills", "Biopak", "Bodrumi i vjetër", "Illyrian Winery and Vineyards" dhe kompani të tjera me sasi prodhimi më të ulët.



**Tabela 37: Prodhimi i verës sipas kompanive, 2022**

Nr.	Kompanitë prodhuese të licencuara	Verë e bardhë/hl	Verë e kuqe/hl	Verë Rose/hl	Gjithsej verë/hl	Rrush për destilim/hl
1	"Stone Castle Vineyards&Winery" Shpk	18,966	15,812	771	35,548	4,972
2	"Besa Winery" Sh.p.k	1,690	-		1,690	-
3	"Bodrumi i vjeter" Sh.p.k	5,225	4,693		9,918	-
4	"Sunny Hills" Sh.p.k	5,790	5,383	-	11,173	-
5	NTP "Muja"	547	579	-	1,126	21
6	"Biopak" Shpk	8,491	1,476	-	9,967	518
7	"Kosova Wine" Sh.p.k	266	485	22	773	29
8	"Suhareka Verari" Sh.p.k	1,096	1,110	-	2,206	-
9	NTP "Daka"	98	191	-	289	22
10	NTP "Sefa"	99	135	-	234	68
11	NTP "Bahha"	63	161	-	224	19
12	NTP "Tradita"	25	45	-	70	3
13	NTP "Rahvera AB"	-	-	-	-	11
14	NTP "Agro-alf"	45	188	-	232	4
15	Shpk"Rahoveci"	12	106	-	118	5
16	P.T.P "Hoçanska Vina"	-	5	-	5	3
17	V.V Çabrati sh.p.k.	20	49	-	69	2
18	N.P.SH. "Albatros"	-	53	-	53	-
19	Dardania Wine Sh.p.k.	-	24	-	24	-
20	N.P.T " Raho Wine"	-	31	-	31	1
21	N.P.T " Astra - Vera"	-	22	-	22	-
22	Cana Wine" Sh.p.k	11	11	-	22	4
23	N.P.T "Rezidenca"	-	-	-	-	19
24	Noster Fructus" D.O.O.	157	49	-	206	5
25	Albana Vucitrna BI	10	-	-	10	4
26	Agro Vita sh.p.k.	20	85	-	105	-
27	Ilirian Winery and Vineyards L.L.C	3,700	-	-	3,700	192
28	Wine&Art sh.p.k	-	20	-	20	-
29	Risons L/L/C.	50	60		110	20
30	Zana Wine sh.p.k.	-	70	-	70	31
31	Samiri-H&A shpk.	49	265	-	314	23
32	Dardan Hajdaraj B.I.	-	50	-	50	15
33	Dualos sh.p.k.	-	209	-	209	13
34	JV Destilery sh.p.k.	-	20	-	20	6
35	Dvor.d.o.o.	-	15	-	15	7
	<b>Gjithsej</b>	<b>46,429</b>	<b>31,400</b>	<b>793</b>	<b>78,622</b>	<b>6,015</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

## Analizat fiziko - kimike të verës

Gjatë vitit 2022 në laboratorin e enologjisë, janë realizuar gjithsej 600 analiza fiziko - kimike. Prej tyre, 139 ishin mostra për treg të brendshëm, 246 ishin mostra për eksport, 47 mostra për import, 42 për pije të forta alkoolike dhe 126 mostra janë kryer gjatë përpunimit. Për nevoja të kompanive dhe nga inspektorët nuk është kërkuar ndonjë analizë për tu kryer.

**Tabela 38: Analizat fiziko - kimike të verës për periudhën 2018 - 2022**

Mostra për/nga	2018	2019	2020	2021	2022
Mostra treg i brendshëm	116	128	115	131	139
Mostra eksport	294	357	273	268	246
Mostra import	-	12	4	5	47
Pije të forta alkoolike	14	6	14	51	42
Nevoja të kompanive	43	18	35	99	-
Inspektorët	5	-	-	-	-
Gjatë përpunimit	-	-	-	-	126
<b>Gjithsej</b>	<b>472</b>	<b>521</b>	<b>441</b>	<b>554</b>	<b>600</b>

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

## 2.2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra

Në vitin 2022 sipërfaqja totale e mbjellur me kultura foragjere dhe drithëra të kositura të gjelbëra ishte 108,551 ha, që kishte pësuar ulje për 9 ha në krahasim me vitin paraprak. Kulturat që kanë pësuar ulje më të theksuar në sipërfaqe janë: misri i gjelbër me 4.9% dhe foragjeret e tjera të gjelbra me 3.0%, ndërsa kulturat e tjera kanë pasur rritje të vogël të sipërfaqes. Prodhimi tek të gjitha kulturat është rritur, me përjashtim të misrit të gjelbër dhe foragjereve tjera të gjelbëra që ka pësuar rënie, e kjo për shkak të rënies në sipërfaqe sepse rendimenti ka shënuar rritje tek të gjitha kulturat.

**Tabela 39: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra, 2018-2022**

Kultura	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>					
<b>Foragjere dhe drithëra të kositura të gjelbëra</b>	<b>107,099</b>	<b>108,480</b>	<b>108,436</b>	<b>108,560</b>	<b>108,551</b>	<b>0.0</b>
Misër i gjelbër	7,085	7,082	7,037	7,061	7,080	0.3
Misër i gjelbër (kulturë e dytë)	212	304	205	210	200	-4.9
Sanë (livadhe)	70,679	70,679	70,717	70,723	70,736	0.0
Bari	9,200	9,253	9,261	9,293	9,316	0.2
Jonxhë	17,182	18,293	18,329	18,360	18,359	0.0
Tërfil	854	901	904	931	938	0.8
Foragjeret e tjera të gjelbëra	1,887	1,967	1,984	1,982	1,922	-3.0
<b>Prodhimi</b>	<b>t</b>					
<b>Foragjere dhe drithëra të kositura të gjelbëra</b>	<b>480,966</b>	<b>504,406</b>	<b>503,758</b>	<b>481,952</b>	<b>493,955</b>	<b>2.5</b>
Misër i gjelbër	109,532	118,504	120,653	118,937	120,088	1.0
Misër i gjelbër (kulturë e dytë)	2,260	4,322	2,851	2,875	2,807	-2.4
Sanë (livadhe)	249,559	249,683	247,921	233,323	240,783	3.2
Bari	30,786	31,689	30,584	28,819	29,542	2.5
Jonxhë	73,754	84,257	85,503	82,330	85,044	3.3
Tërfil	3,065	3,446	3,652	3,551	3,703	4.3
Foragjeret e tjera të gjelbëra	12,010	12,506	12,595	12,117	11,986	-1.1
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>					
Misër i gjelbër	15.46	16.73	17.15	16.84	16.96	0.7
Misër i gjelbër (kulturë e dytë)	10.68	14.21	13.90	13.67	14.04	2.7
Sanë (livadhe)	3.53	3.53	3.51	3.30	3.40	3.2
Bari	3.35	3.42	3.30	3.10	3.17	2.3
Jonxhë	4.29	4.61	4.66	4.48	4.63	3.3
Tërfil	3.59	3.83	4.04	3.82	3.95	3.5
Foragjeret e tjera të gjelbëra	6.36	6.36	6.35	6.11	6.24	2.0

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

\*Në foragjere të tjera të gjelbëra përfshihen: Urovi, Gruri i gjelbër, Tërshëra e gjelbër, Elbi i gjelbër, Thekra e gjelbër si dhe foragjere tjera të gjelbëra (grashina)

## 2.2.6 Kulturat industriale

Në vitin 2022 sipërfaqja totale e mbjellur me kultura industriale ishte 887 ha, është rritur për 2 ha më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa prodhimi në vitin 2022 është rritur për 15% në krahasim me vitin e kaluar.

**Tabela 40: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave industriale, 2018-2022**

	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Sipërfaqja në ha	329	402	1,065	885	887	0.2
Prodhimi në tonë	392	576	1,347	1,022	1,180	15.4

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

\*ASK nuk publikon të dhënat në nivel të kulturave industriale për shkak të numrit të vogël të vrojtimeve dhe në anketë në kuadër të kulturave industriale përfshihen: luledielli, duhani, soja dhe bimët mjekësore aromatike.

## 2.3 Ujitja e tokës bujqësore

Përmes formave të ujitjes formale dhe jo formale në vendin tonë, gjatë vitit 2022 janë ujitur gjithsej 18,885 ha, krahasuar me vitin 2021 ku janë raportuar të ujitura gjithsej 19,958 ha, niveli i sipërfaqeve të ujitura ka rënë për 5%.

Të dhënat për ujitje në gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë të raportuara nga Drejtoritë Komunale të Bujqësisë, raportimi është bërë për gjithsej 28 komuna, ndërsa nuk është raportuar nga 10 komuna tjera si: Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Novobërdë, Shtërpca, Vitia, Zveçani, Malisheva, Zubin Potoku, Kllokoti dhe Ranilluka, për arsye se në komunat e tyre nuk posedojnë sisteme të ujitjes dhe ka qenë e pamundur të sigurohen të dhënat e sakta nga fermerët individualisht.

Komunat me sipërfaqet më të mëdha nën ujitje janë Peja, Rahoveci, Prizreni, Klina dhe Gjakova, pasuar nga komunat tjera me sipërfaqe nën ujitje nën 1,000 ha.

**Tabela 41: Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2022**

Komuna	Burimi i ujitjes	Kulturat e ujitura	Sip. ujitur / ha
Deçani	Drini i Bardhë	Ara, pemishte, livadhe, etj	220
Gjakova	Radoniqi & Dukagjin, lumenj	Perime, misër, jonxhë, grurë, livadhe, etj	1,425
Drenas	Ibër-Lepenci	Perime, premë, misër, jonxhë, parqe, etj	460
Gjilan	Puset, vetanak	Drithëra, pemë, perime	455
Dragash	Ujësjellësi, puse	Pemë të imëta	6
Istog	Drini i Bardhë	Misër, livadhe, patate, pemë, perime	576
Kaçanik	Lumenj, puse	Misër, pemë, perime, livadhe, etj.	383
Klina	Drini i Bardhë	Misër, perime, pemë, livadhe	1,550
F.Kosova	L.Drenica, Sitnica, puse	Misër, jonxhë, perime, pemë, qepë, patate	145
Kamenica	Lumenj, puse	Drithëra, pemë, perime, drunjë dekorativ	89
Mitrovica	Ibër-Lepenc	Perime, pemë, fasule, misër	291
Lipjan	Lumenj, puse	Pemë, perime, drithëra, etj.	52
Obiliq	Ibër-Lepenc, lumenj dhe puse	Misër, pemë, perime	644
Rahovec	Radoniqi & Dukagjin	Perime, misër, shalqi, etj.	2,597
Peja	Drini i bardhë, lumenj	Drithëra, pemë, perime	2,764
Podujevë	L.Llap, puset	Drithëra, pemë, perime	1,020
Prishtinë	Ibër-Lepenc, L.Llap, puse	Drithëra, pemë, perime, etj.	253
Prizren	Radoniqi & Dukagjin	Misër, perime, shalqi, etj.	2,416
Skenderaj	Lumenj, puse	Pemë, perime, serra	170
Shtime	Lumenj, puse	Perime, misër	87
Suhareka	Lumenj, puse	Pemë, perime, misër	980
Ferizaj	Lumenj, puse	Pemë, perime, misër, fasule	402
Vushtrri	Ibër-Lepenc	Patate, lakër, misër	643
H.Elezit	Lumenj, puse	Drithëra, pemë, perime, livadhe	32
Mamusha	Lumenj, puse	Perime, misër, jonxhë	455
Junik	Drini i Bardhë	Drithëra, pemë, perime, livadhe	215
Graçanica	Lumenj, puse	Drithëra, pemë, perime	471
Parteshi	Puse	Perime, perime, livadhe	85

Burimi: DPBT - MBPZhR

Përmes ujitjes formale të organizuar përmes ndërmarrjeve publike të ujitjes në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2022, janë ujitur gjithsej 8,422 ha, ndërsa përmes ujitjes jo formale, ujitjes së pa organizuar dhe ujitjes individuale e cila bëhet nga burime të ndryshme ujore si lumenj, puse, etj., janë ujitur 10,462 ha.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme mbi format dhe sasinë e përgjithshme të ujit të shpenzuar në sipërfaqet e tokave bujqësore gjatë vitit 2022, vërehet se sasia e përgjithshme e ujit të shpenzuar ishte 93,349,600 m<sup>3</sup>, nga ku 44,040,026 m<sup>3</sup> ishin realizuar nga ndërmarrjet e ujitjes përmes ujitjes formale, ndërsa 49,309,574 m<sup>3</sup> ishin realizuar përmes ujitjes joformale.

Vlen të ceket se ndërmarrjet publike të ujitjes në Kosovë nuk kanë ndonjë matës të ujërave të shpenzuara gjatë ujitjes, por shpenzimet e sasisë së ujit llogariten bazuar në dizajnin kryesor të sistemeve të ujitjes nga secila ndërmarrje e veçantë. Duke u bazuar në dizajne, në vendin tonë funksionojnë tri lloje të ndryshme të sistemeve të ujitjes me dizajne: i hapur, i kombinuar dhe i mbyllur, këto ndryshojnë nga njëra tjetra për nga kapaciteti i ujit të shpenzuar. Andaj, të dhënat e sasisë së ujit të shpenzuar të paraqitura në këtë raport janë llogaritje të përafërta të cilat janë bazuar në dizajnin e sistemeve dhe shpenzimit të ujit nga secila ndërmarrje.

**Tabela 42: Format e ujitjes dhe sasia e përgjithshme e ujit të shpenzuar në sip. e tokave bujqësore në Kosovë, 2022**

Ujitje formale	Sip. ujitur / ha	Sasia e ujit të shpenzuar (m <sup>3</sup> /ha <sup>-1</sup> )	Sasia e përgjithshme ujit të shpenzuar (m <sup>3</sup> )
Ibër Lepenci	1,881	3,250	6,113,380
Radoniqi	4,598	6,524	29,994,416
Dukagjini	502	5,492	2,758,687
Drini i Bardhë	1,442	3,589	5,173,544
<b>Ujitje joformale</b>	<b>10,462</b>	<b>4,713</b>	<b>49,309,574</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>18,885</b>	<b>23,568</b>	<b>93,349,600</b>

Burimi: DPBT – MBPZhr

## 2.4 Blegtoria

### 2.4.1 Gjedhet

Në vitin 2022 fondi i gjedheve ishte 250,899 krerë, që përbënë 47.2% të gjithsej numrit të kafshëve, në krahasim me vitin paraprak ky numër ka pësuar ulje për 3.7% ose 9,629 krerë më pak. Nga totali i fondit të gjedheve rreth 31% apo 78,041 krerë i përkasin kategorisë nën moshën 1 vjeç (42% janë femra dhe 58% meshkuj), 10% apo 25,146 krerë i përkasin kategorisë prej 1-2 vjeç (45% janë femra dhe 55% meshkuj), pjesëmarrja më e lartë edhe në vitin 2022 i takon kategorisë mbi moshën 2 vjeç me 59% ose 147,712 krerë ku pjesa më e madhe prej 88% janë lopë qumështore.

Në vitin 2022 të gjitha kategoritë kanë pësuar ulje, kjo ulje ishte më e theksuar tek këto kategori: dema mbi 2 vjeç (11.2%) dhe mëshqerrat mbi 1-2 vjeç (9.1%).

Nga gjithsej numri i lopëve qumështore prej 130,493 krerë, në vitin 2022 përmes programit të pagesave direkte janë subvencionuar 40% apo 52,527 krerë.

**Tabela 43: Fondi dhe struktura e gjedheve, 2018-2022**

Numri i kafshëve	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Fondi i gjedheve</b>	<b>258,662</b>	<b>257,733</b>	<b>261,389</b>	<b>260,528</b>	<b>250,899</b>	<b>-3.7</b>
Viça meshkuj nën 1 vjeç	41,911	43,863	45,492	48,047	44,934	-6.5
Viça femra nën 1 vjeç	41,263	39,263	38,653	35,191	33,107	-5.9
Mëzet 1-2 vjeç	14,627	14,852	14,080	14,513	13,950	-3.9
Mëshqerra 1-2 vjeç	12,335	11,297	11,478	12,323	11,196	-9.1
Dema mbi 2 vjeç	5,519	6,303	7,113	7,451	6,619	-11.2
Mëshqerra mbi 2 vjeç	9,635	8,128	8,920	8,890	8,575	-3.5
Lopë qumështore	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493	-1.2
Lopë të tjera	898	2,088	1,737	2,037	2,025	-0.6

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

Numri i përgjithshëm i gjedheve në vitin 2022 ishte 250,899 krerë e që krahasuar me vitin 2021 kishte rënie për 3.7%. Sa i përket therjes, 115,214 krerë janë therur në vitin 2022 që d.m.th më pak se në vitin 2021 për rreth 1%. Vlera e prodhimit të përgjithshëm të mishit të gjedheve ishte 57.5 mil. €, ndërsa vlera e importit 115.2 mil. €. Me këtë sasi të prodhimit shkalla e vetë-mjaftueshmërisë është 40.1% dhe konsumi për kokë banori është 27.7 kg/vit.

**Tabela 44: Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Fondi i gjedheve	krerë	258,662	257,733	261,389	260,528	250,899
Lopë qumështore	krerë	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493
Totali i therjeve	krerë	114,149	114,318	116,048	116,204	115,214
Totali i prodh. vendor në p.th.	mil. kg p.th.	19.5	19.5	19.7	19.8	19.7
Totali i importeve	mil. kg p.th.	15.2	16.6	18.1	25.4	31.4
Furnizimi në p.th.	mil. kg p.th.	34.7	36.1	37.9	45.2	51.1
Totali i eksporteve	mil. kg p.th.	0.00	0.02	0.05	0.10	1.99
Konsumi	mil. kg p.th.	34.7	36.1	37.8	45.1	49.1
Vlera e prodhimit në p.th.	mil. EUR	42.5	45.6	44.3	47.1	57.5
Totali i importeve	mil. EUR	40.0	43.9	49.9	75.5	115.2
Bilanci tregtar	mil. EUR	-40.0	-43.8	-49.7	-75.1	-106.7
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	56.1	54.0	52.2	43.9	40.1
Konsumi për kokë banori	kg p.th.	19.3	20.1	21.0	25.5	27.7

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZhr; p.th - peshë e therur

Në vitin 2022, lopët qumështore përfaqësojnë 52% të numrit të përgjithshëm të gjedheve. Nga gjithsej përdorimi, 81% ishte prodhim vendor dhe pjesa tjetër është mbuluar nga importet. Prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vitin 2022 ishte 276 mijë tonë, e që është rreth 1% më i ulët sesa në vitin 2021 sepse edhe numri i lopëve qumështore ishte më i vogël. Bilanci tregtar mbetet negativ me 36.7 mil. €. Konsumi për kokë banori ishte 165 kg në vit që do të thotë se një person konsumon rreth 0.45 kg në ditë, duke përfshirë qumështin dhe produktet e tij.

**Tabela 45: Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2018-2022**

	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Lopë qumështore	krerë	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493
Prodhimi i qumështit	t	277,599	277,138	281,960	278,746	276,058
Importi	t (p.e.)	70,596	76,139	71,129	72,642	64,666
Furnizimi	t (p.e.)	348,195	353,277	353,089	351,389	340,724
Eksporti	t (p.e.)	572	866	984	1,018	1,195
Përdorimi vendor	t (p.e.)	347,624	352,411	352,105	350,371	339,529
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	79.9	78.6	80.1	79.6	81.3
Humbjet	t (p.e.)	5,552	5,543	5,639	5,575	5,521
Konsumi për ushqim të viçave në fermë	t (p.e.)	40,807	40,739	41,448	40,976	40,581
Procesimi	t (p.e.)	26,848	27,340	27,172	27,090	26,083
Konsumi njerëzor	t (p.e.)	274,416	278,789	277,846	276,730	267,345
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.31	0.32	0.33	0.31	0.34
Vlera e prodhimit	mil EUR	71.7	73.9	77.5	72.0	78.2
Bilanci tregtar	mil EUR	-30.0	-29.9	-29.4	-31.7	-36.7
Konsumi për kokë banori	kg (p.e)	168	172	170	171	165

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZhr; p.e. - ekuivalentët e produktit



## 2.4.2 Dhentë dhe dhitë

Në vitin 2022 fondi i dhenve dhe dhive ishte 233,488 krerë, që e përbën 43.9% të gjithsej numrit të kafshëve dhe ky numër ka shënuar rënie për 3.3% apo 7,905 krerë më pak se sa në vitin paraprak. Nga totali i fondit të dhenve dhe dhive pjesa dërmuese prej 87.4% apo 204,110 i takojnë grupit të dhenve, ndërsa pjesa tjerë prej 12.6% apo 29,378 krerë i takojnë grupit të dhive. Në kuadër të dhenve, 74.0% janë dele për mbarështim, ndërsa në kuadër të dhive 73.7% janë dhi për mbarështim.

Në vitin 2022, nga gjithsej numri i dhenëve dhe dhive, 60.7% apo 141,792 krerë janë subvencionuar përmes programit të pagesave direkte.

**Tabela 46: Numri i dhenve dhe dhive, 2018-2022**

Numri i kafshëve	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
<b>Dhen dhe dhi</b>	<b>209,808</b>	<b>216,299</b>	<b>241,688</b>	<b>241,393</b>	<b>233,488</b>	<b>-3.3</b>
<b>Dhentë</b>	<b>181,105</b>	<b>189,102</b>	<b>212,131</b>	<b>211,354</b>	<b>204,110</b>	<b>-3.4</b>
Dele për mbarështim	139,312	145,248	159,067	156,666	151,011	-3.6
Krerë të tjerë (qengja, desh, etj)	41,793	43,854	53,064	54,688	53,099	-2.9
<b>Dhitë</b>	<b>28,703</b>	<b>27,197</b>	<b>29,557</b>	<b>30,039</b>	<b>29,378</b>	<b>-2.2</b>
Dhi për mbarështim	22,401	20,602	21,907	22,234	21,663	-2.6
Krerë të tjerë (keca, cjep, etj)	6,302	6,595	7,650	7,805	7,715	-1.2

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

## 2.4.3 Derrat dhe kafshët tjera të fermës

Nga fondi total i kafshëve, fondi i derrave (45,420 krerë), ka pjesëmarrje prej 8.5%. Fondi i derrave ka pësuar rënie për 4.1% apo 1,964 krerë më pak se sa në vitin e kaluar.

Nga totali i fondit të derrave, 27.9% janë derra për majmëri (27.0% janë me peshë 51-79 kg, 33.6% me peshë 80-109 kg dhe pjesa tjetër prej 39.4% i takojnë grupit me peshë mbi 110 kg).

Dosat kanë pjesëmarrje 28.7% në gjithsej numrin e derrave, ku prej tyre 57.0% janë dosat që kanë pjellë, 20.5% dosat të mbarësuara për herë të parë, 12.6% dosat të tjera dhe 9.9% dosat të pambarësuara.

Përveç derrave për majmëri dhe dosave pjesa tjetër prej 23.0% janë gica nën 20 kg, 15.6% derra me peshë 20-50 kg dhe 4.8% harça për riprodhim.

Numri i kuajve, gomarëve dhe mushkave në vitin 2022 është 1,469 krerë që ka pësuar ulje për 21.2% apo 395 krerë më pak se sa në vitin 2021.

**Tabela 47: Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2018-2022**

Numri i kafshëve	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Derra	40,164	40,533	45,394	47,384	45,420	-4.1
Kuaj, gomarë dhe mushka	1,944	2,037	1,804	1,864	1,469	-21.2

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18, '19, '20, '21, '22)

## 2.4.4 Shpezëtaria

Numri i përgjithshëm i shpezëve në vitin 2022 ka pësuar ulje për 6.2%, apo 174 mijë shpezë më pak se në vitin e kaluar. Numri i pulave për vezë ka pësuar ulje për 5.5% në krahasim me vitin e kaluar. Pulat vojse edhe në vitin 2022 vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej numrin e shpezëve me 72.2%, pasuar nga brojlerët me 12.3% dhe kategoria zogj, gjela dhe pula të tjera me 10.4%. Bibat përbëjnë 3.3%, ndërsa shpezët e tjera si rosa dhe pata kanë një pjesëmarrje prej 1.8%.

Nga gjithsej numri i pulave për vezë (1,886 mijë), 46% (872 mijë pula) janë subvencionuar në vitin 2022 përmes programit të pagesave direkte.

**Tabela 48: Numri i shpezëve dhe vezëve 2018-2022, në '000**

Numri i shpezëve (1000)	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Shpezë	2,538	2,665	2,782	2,788	2,614	-6.2
Pula	2,393	2,558	2,637	2,643	2,482	-6.1
Brojler	407	321	384	346	323	-6.7
Pula për vezë	1,728	1,947	1,939	1,996	1,886	-5.5
Zogj, gjela dhe pula të tjera	259	289	315	301	273	-9.4
Biba	88	61	75	94	86	-8.2
Shpezë të tjera (Rosa, Pata etj.)	56	47	70	52	46	-11.1
Vezë*	315,097	366,447	365,554	423,640	363,031	-14.3

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22); \*DAESB - MBPZhR ('18-'22)

Në vitin 2022, gjithsej prodhimi i vezëve vlerësohet të jetë 363 mil. vezë. Në vitin 2022 janë importuar 3.1 mil. vezë në vlerë prej 448 mijë €. Sasia e importuar e vezëve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 ka pësuar ulje për 30%. Nga gjithsej importi i vezëve, 96.4% është importuar nga shtetet në vijim: 68.1% nga Maqedonia e Veriut, 16.0% nga Shqipëria dhe 12.3% nga Bullgaria dhe pjesa tjetër prej 3.6% nga shtetet e tjera. Sasia e eksportuar është shumë më e vogël sesa sasia e importuar dhe e tëra është eksportuar në Shqipëri. Në vitin 2022, konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë rreth 206 vezë/vit dhe mund të themi se Kosova plotëson rreth 99% të nevojave për konsum të vezëve.

Në vitin 2022, prodhimi i mishit të pulës vlerësohet të jetë rreth 3,029 tonë. Në këtë vit importi i mishit të pulës ishte 37,580 tonë me vlerë prej 71.6 mil. €. Nga sasia e përgjithshme e importuar, 34.4% është importuar nga Brazili, 13.3% nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 10.6% nga Polonia, 9.8% nga Mbretëria e Bashkuar, 5.6% nga Turqia, 4.6% nga Gjermania dhe 21.7% nga vendet e tjera. Eksport të mishit të pulës ka pasur vetëm në Maqedoni ku është eksportuar një sasi prej rreth 10 tonë. Konsumi mesatar për kokë banori në Kosovë vlerësohet rreth 22.9 kg/vit dhe me prodhimtarinë aktuale, Kosova arrin të mbuloj vetëm 7.5% të nevojave për konsum.

## 2.4.5 Bletaria

Në vitin 2021 numri i koshereve u zvogëlua për 43,464 koshere, për faktin se kolonitë e bletëve u shembën pasi dimri ishte jashtëzakonisht i ftohtë dhe i gjatë. Kjo përbën edhe kërcënimin kryesor për familjet e bletëve pasi që lidhet me praktikën intensive të bujqësisë dhe ushqimin e dobët për bletët. Përveç kësaj, ato sulmohen nga viruset, patogjenët dhe speciet pushtuese.

Zvogëlimi i numrit të koshereve të bletëve vazhdoi edhe në vitin 2022 ku në raport me vitin 2021 janë 22,955 koshere më pak apo 10.5% pasi që edhe dimri mes vitit 2021 dhe 2022 ishte dimër mjaft i ftohtë dhe i gjatë.

Nga gjithsej numri i koshereve në Kosovë, në vitin 2022, 97.2% apo 190,579 koshere janë subvencionuar në kuadër të mbështetjes përmes programit të pagesave direkte.

**Tabela 49: Numri i koshereve të bletëve, 2018-2022**

Numri i koshereve	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021 në %
Koshere bletësh	182,476	219,831	262,541	219,077	196,122	-10.5


Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('18,'19,'20,'21,'22)

Në vitin 2022, prodhimi i mjaltit në Kosovë ishte rreth 9 kg për koshere, që rezulton me një prodhimtari totale të mjaltit prej 1,765 tonë, prej të cilës sasi 17.8% është përdorur për konsum vetanak dhe 82.2% e kësaj sasive është shitur. Importi i mjaltit në vitin 2022 ishte 250 tonë, ndërsa eksporti nuk kishte fare. Konsumi vendor rezulton të jetë rreth 1.1 kg për kokë banori dhe prodhimi vendor plotëson 88% të nevojave për konsum, ndërsa pjesa tjetër plotësohet nga importi. Nga gjithsej sasia e importuar e mjaltit, 32.3% është importuar nga Maqedonia e Veriut, 28.2% nga Turqia, 15.4% nga Sllovenia, 11.3% nga Kroacia dhe pjesa tjetër prej 12.8% nga vendet e tjera.

### 3 Pylltaria

Kosova karakterizohet me një sipërfaqe të qëndrueshme pyjore me rreth 481,000 ha. Kosova ka të mbuluar me pyje 45% të sipërfaqes, e që konsiderohet një potencial i qëndrueshëm për zhvillim të vendit, nga të cilat rreth 62% janë pyje publike ndërsa rreth 38% konsiderohen si pyje private. Bazuar në inventarin e pyjeve, zonat e mbrojtura apo pyjet shtrihen në rreth 12% të sipërfaqes të përgjithshme të tyre dhe në vete ngërthejnë rreth 36% të volumit të përgjithshëm. Ndikimi apo impakti për qasje ekonomike është i madh, bazuar në të dhënat e mësipërme, por edhe në faktin se pyjet me vlera më të mëdha ekonomike (pyjet e larta-trungishtet) gjenden brenda dy parqeve kombëtare: “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”. Figura e mëposhtme ilustron shpërndarjen e sipërfaqeve, ku shihet se përqindja më e madhe i takon pyjeve, pastaj tokës bujqësore, livadheve/kullosave dhe të tjerave.

Figura 25: Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës)



Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve, INP

Pyjet e Kosovës janë të dominuara nga pyjet fletore, duke mbuluar 93% (449,400 ha) të sipërfaqeve pyjore, ku më shumë se gjysma janë një-moshare, ndërsa 5% (23,800 ha) e sipërfaqeve pyjore mbulohet nga pyjet halore të cilat janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në mes të klasave të ndryshme të strukturës. Plantacionet e pishave kontribuojnë në sipërfaqet një-moshare. Në total, 50% e sipërfaqes pyjore është konsideruar një-moshare.

Tabela 50: Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit (ha)

Përbërja pyjeve	Rigjenerimi	Një-moshar	Dy-katësh	Shumë-moshar	Totali
Halorë	2,200	6,600	6,200	8,800	23,800
Përzier	0	400	3,200	4,200	7,800
Fletorë	45,400	236,000	123,600	44,400	449,400
<b>Totali</b>	<b>47,600</b>	<b>243,000</b>	<b>133,000</b>	<b>57,400</b>	<b>481,000</b>

Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve, INP

## **Aktivitetet në politikat pyjore**

Departamenti i Pylltarisë funksionon në kuadër të MBPZhR-së, me mandatin e rregullatorit për krijimin e politikave, strategjive, programeve dhe legjislacionit për pyjet dhe gjuetinë. Përveç këtyre detyrave, ky Departament angazhohet në zhvillimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve dhe këshillimeve për avancimin e sektorit në përgjithësi. Bashkëpunimi ndër institucional, koordinimi i projekteve të ndryshme të donatorëve në kuadër të harmonizimit të legjislacionit dhe standardizimit të tij, përbëjnë aktivitetet kryesore në përmbushje të detyrave. Gjatë zhvillimit të veprimtarisë në përmbushjen e standardeve të ndryshme në fushën e pylltarisë si ekonomi, përmes licencimit ndihmohet në profesionalizmin dhe specializimin e ndërmarrjeve të ndryshme që ushtrojnë veprimtari ekonomike në pyje, toka pyjore, përpunim të prodhimeve pyjore, në fushën e projekteve, hulumtimeve etj.

## **Legjislacioni**

Misioni i Departamentit të Pylltarisë bazohet në mbështetje të kornizës ligjore ekzistuese që ka të bëjë me: Ligjin për Pyjet Nr. 2003/3, Ligji Nr. 2004/29 për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet Nr. 2003/3 dhe Ligjin Nr. 03/L - 153 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pyjet Nr. 2003/3 si dhe Ligjin për Gjuetinë Nr. 02/L-53. Në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe zhvillimit janë realizuar aktivitete të ndryshme që ndërlidhen me zbatimin e Ligjit për Tokën Bujqësore, Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri, Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjit mbi Mjedisin, si dhe disa ligje që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, për Mbrojtjen e Natyrës, Parqet Kombëtare, Ujërat etj. Theksojmë se në kuadër të këtij bashkëpunimi janë zhvilluar një mori takimesh përmes pjesëmarrjes në grupe të ndryshme punuese për të rishikuar politikat mbi legjislacionin mbi pyjet dhe tokat pyjore, mjedisin, ujërat, ndryshimet klimatike, gjuetinë, zonat e mbrojtura etj.

Një prej aktiviteteve të Departamentit të Pylltarisë në aspektin e plotësimit ligjor është hartimi i akteve nënligjore, të cilat përmbushin hapësirën në zbatimin e dy ligjeve që kanë të bëjnë me pyjet dhe gjuetinë. Aktualisht në fuqi janë 39 udhëzime administrative. Për periudhën që raportohet është punuar në hartimin e tre udhëzimeve administrative mbi pyjet dhe tokat pyjore.

Aktivitetet e shënuara lidhur me hartimin e legjislacionit:

- Harmonizimi me KASH dhe miratimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë;
- Hartimi dhe miratimi nga QRK i Ligjit për pyjet;
- Diskutimi me Komisionin parlamentar Ligjit për pyjet, plotësimi;
- Hartimi dhe plotësimi në vazhdim i tre udhëzimeve administrative;
- Diskutimi i kërkesave të komunave për themelimin, dhënien në menaxhim dhe miratimin;
- Është përgatitur dhe nxjerrë Vendimi për hapjen e sezonit të gjuetisë.

## Strategjia

Dokumentet zyrtare në të cilat është mbështetur zbatimi dhe zhvillimi i programeve të ndryshme janë: Strategjia për zhvillimin e sektorit të pylltarisë 2022-2030, Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, Inventarizimi kombëtar i pyjeve 2012/2013, Inventarizimi i prodhimeve pyjore jo drunore dhe përcaktimi i kuotave të vjeljes, Programi kombëtar i pyllëzimit dhe ri pyllëzimit 2018-2027, Programi kombëtar i shëndetit pyjor 2018-2027 etj.

Departamenti i Pylltarisë është përqendruar kryesisht në përmbushjen e objektivave që rrjedhin me rastin e zbatimit të dokumenteve të theksuara më lartë. Në kuadër të zbatimit të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë vlen të theksojmë bashkëpunimin me organizatat donatore që mbështesin sektorin e pylltarisë si: Komisioni Evropian, Sida, FAO, JICA, CNVP dhe organizata tjera, të cilat kanë qenë të interesuara në zbatimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuar me strategji.

Në përmbushje të objektivave të SZHP dhe Planit të Veprimit mund të veçojmë aktivitete si më poshtë sipas objektivave:

1. Përmirësimi i gjendjes të resurseve pyjore, bazohet në përmirësimin e legjislacionit, inventarin e pyjeve dhe sistemi i planifikimit me aktivitete në:
  - Miratimi i Ligjit për pyjet;
  - Hartimi i tre UA (shfrytëzim të pyjeve, planifikimin e menaxhimit e pyjeve dhe përdorimin e PPJDe);
  - Vlerësimi i gjendjes aktuale “Përmirësimi i profilit pyjor në Kosovë-Vlerësimi i rolit dhe kontributit aktual në ekonomi”;
  - Hartimi i planeve menaxhuese dhe ngritja e pyjeve të reja përmes pyllëzimit.
2. Mbrojtja e resurseve pyjore kryesisht përqendrohet në aktivitetet që ndërlidhen me sfidat kryesore të menaxhimit të pyjeve dhe atë; Krijimi i Taskë Forcës për ligjshmërinë e shfrytëzimit të drurit përmes aktiviteteve në:
  - Vendosja e bazës për ligjshmërinë e shfrytëzimit të drurit;
  - Krijimi i instrumentit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V);
  - Vendosja e 70 indikatorëve të matjes të performancës të M&V;
  - Trajnimi i 120 personave për potencialet e PPJDe;
  - Zhvillimin e zingjirit të zgjeruar të vlerave në 4 zona pilot të zgjedhura.
3. Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve i cili objektiv përqendrohet në prodhime me vlerë dhe shërbime, drurit për industrinë, biomasë, PPJD, çështjet e mjedisit, biodiversiteti, rekreacioni, zbutja NDK, thjeshtimin e procedurave administrative dhe teknike në prerje, transport dhe tregtim të asortimenteve drunore duke përfshirë aktivitete në:

- Përkufizimin e kriterëve dhe treguesve kombëtar të MQP;
  - Metodologjia për hartimin e kriterëve dhe treguesve të MQP;
  - Organizimin e dy trajnimeve për përdorimin e kriterëve dhe indikatorëve të MQP.
4. Ngritja e kapaciteteve që si objektive përqendrohet në shkollimin formal dhe aftësimin profesional, objektivi i vazhdueshëm në periudhë të gjatë për përmirësimin e gjendjes me të arritura duke shënuar aktivitete në:
- Vlerësimin e nevojave për riorganizim për përcaktimin e strukturës së re;
  - Hartimi i “Analizës të organizimit institucional të sektorit pyjor”;
  - Propozimi për rishikimin e strukturës organizative;
  - Përgatitja e udhërrëfyesit për reformën institucionale dhe ristrukturimin e institucioneve;
  - Zhvillimi i hapave për nxjerrje të kurikulës për shkollim në pylltari.

Digjitalizimi i të dhënave, përmirësimi i komunikimit që përqendrohet në bashkëpunimin dhe komunikimin, ndërgjegjësimin dhe zhvillimin e SIPK dhe atë:

- Funksionalizimi dhe mirëmbajtja e SIPK;
- Plotësimi me module të reja që është në fazë testimi;
- Organizimi i fushatës të ndërgjegjësimit “Duaj, ruaj pyjet - Për një Kosovë të gjelbër”;
- Fushata ndërgjegjësimi me organizatat e mediave elektronike dhe të shkruara për rolin dhe rëndësinë e pyjeve.

## Licencimi

Licencimi i ndërmarrjeve (subjekteve juridike) është një nga aktivitetet tjera të Departamentit të Pylltarisë, për të cilin mund të veçojmë aktivitetet si: vizitat në terren, diskutimi i kërkesave nga komisioni përkatës, vazhdimi i licencave ekzistuese dhe lëshimi i licencave.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar gjithsej 30 licenca për zhvillimin e aktiviteteve në kryerje të punëve në pyje, toka pyjore, përpunim të drurit dhe grumbullim të prodhimeve jo drunore (bimëve aromatike). Për aktivitetet në projekte dhe hulumtime të ndryshme në sektorin pyjor, kërkesat kanë qenë minimale.

Mbështetur në kërkesat e ndërmarrjeve, mund të veçojmë licencat e lëshuar sipas veprimtarive të ndryshme:

**Tabela 51: Tabela mbi licencat**

Nr.	Emërtimi	Numri i licencave të lëshuara
1	Për shfrytëzim të qëndrueshëm të pyjeve	6
2	Për grumbullim të prodhimeve jo drunore (fruta malore)	9
3	Për përpunim të drurit	14
4	Pyllëzime	0
5	Për projekte në fushën e pylltarisë	1
<b>Gjithsej</b>		<b>30</b>

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

## Gjuetia

Në kuadër të zbatimit të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L - 53, janë realizuar një mori takimesh të Komisionit për gjueti për shqyrtimin e kërkesave në themelimin e vendgjuetive të përbashkëta/VGjP dhe, diskutimin e problemeve lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Me rastin e zbatimit të legjislacionit për gjueti, janë zhvilluar një mori aktivitete nga Komisioni për gjueti, sidomos në procesin e themelimit, dhënies në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta, duke bërë shqyrtimin e kërkesave të komunave. Njëherit në kuadër të zbatimit të legjislacionit për gjueti, është realizuar gjithashtu dhënia e pëlqimeve për miratimin e Planeve menaxhuese afatgjata dhe vjetore të vendgjuetive të përbashkëta. Prandaj, në pasqyrën e mëposhtme janë paraqitur kërkesat e shqyrtuara për periudhën e vitit 2022.

**Tabela 52: Pëlqimet për themelim, dhënia në menaxhim dhe PM**

Nr	Emërtimi i vend gjuetisë	Numri i pëlqimeve
1	Themelim të vendgjuetive të përbashkëta/VGjP	2
2	Dhënie në menaxhim të VGjP	4
3	Planeve Menaxhuese Afatgjata të VGjP miratuara	6
4	Plane vjetore të menaxhimit me VGjP të miratuara	8
5	Kërkesa të refuzuara	4
<b>Gjithsej</b>		<b>24</b>

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Me këtë proces janë shqyrtuar kërkesat e komunave: Pejë, Dragash, Gjilan, Viti, Drenas, Klinë dhe Mamushë, të cilat ndërlidhen me themelimin, dhënien në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta, miratimin e planeve afatgjata dhe vjetore për menaxhimin e tyre si dhe kafshëve të egra.

### **Njësit Menaxhuese të cilat janë mbuluar me Plane Menaxhuese në vitin 2022**

Bazuar në të dhënat e marra nga Agjencia Pyjore e Kosovës për vitin 2022, kjo Agjenci, ka përmblytur me sukses krijimin e 8 Planeve Menaxhuese për Njësi menaxhuese pyjore, të cilat përfshinë një sipërfaqe rreth 36,841 ha. Aktualisht themelimi i këtyre Planeve është një nga prioritetet kryesore të Agjencisë Pyjore, e cila është e përkushtuar në mbulimin e të gjithë sipërfaqes së pyjeve me plane të reja, me qëllim që qeverisja, administrimi dhe rregullimi i pyjeve të realizohet në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të qëndrueshëm pyjor.



**Tabela 53: Hartimi i Planeve Menaxhuese në vitin 2022**

Njësia Menaxhuese	Regjioni	Sipërfaqet në ha
Koritniku I	Prizren	4,554
Pashtriku I	Prizren	7,708
Maja e Gjelbër	Gjilan	5,402
Nerodime-Jezerc	Ferizaj	6,656
Mokna	Pejë	2,625
Prishtina 1	Prishtinë	4,243
Duboçak	Mitrovicë	2,573
Sllakovc	Mitrovicë	3,080
<b>Gjithsej</b>		<b>36,841</b>

Burimi: Agjencia e Pyjeve të Kosovës, APK

### Menaxhimi vjetor i pyjeve – Aktivitete

Menaxhimi vjetor i pyjeve ka për qëllim avancimin në përmirësimin, zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve, duke ndikuar në mirëmbajtjen e grumbujve pyjor, rritjen e cilësisë së drurit, vjeljen e materialit drusor për nevoja të prodhimit të energjisë, ndërtimit, mobilerisë, përmes të cilave realizohet zbatimi i punëve apo aktiviteteve të parapara me Planin Menaxhues. Tabelat e mëposhtme ilustron planin e shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore dhe realizimin e shfrytëzimit të pyjeve në pronën shtetërore në vitin 2022. Vërehet një dallim i lartë vëllimor i sipërfaqeve pyjore në mes të planit të shfrytëzimit dhe realizimit të shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore.

**Tabela 54: Planifikimi vjetor në pyjet shtetërore, m<sup>3</sup>**

Asortimentet	Vëllimi m <sup>3</sup>
Dru teknik	8,132
Dru zjarri	50,780
<b>Vëllimi neto</b>	<b>58,913</b>
Mbetje pyjore	3,522
<b>Vëllimi bruto</b>	<b>62,435</b>

Burimi: APK

Sipërfaqja pyjore shtetërore e planifikuar për shfrytëzim në vitin 2022 ishte 62,435 m<sup>3</sup>, ndërsa sasia e shfrytëzuar ishte vetëm 22,193 m<sup>3</sup> (35% e planit).

**Tabela 55: Realizimi i planit në shfrytëzim në pyjet shtetërore, m<sup>3</sup>**

Asortimentet	Plani m <sup>3</sup>	Realizimi m <sup>3</sup>	Realizimi i planit %
Dru teknik	8,132	2,690	33
Dru zjarri	50,780	19,472	38
Mbetje pyjore	3,522	31	1
<b>Gjithsej</b>	<b>62,435</b>	<b>22,193</b>	<b>35</b>

Burimi: APK

Bazuar në të dhënat e mësipërme, mund të arrijmë në përfundim se çështja e realizimit të planit vjetor, zbatimi i mirëfilltë i aktiviteteve të planifikuara me Planin e Menaxhimit, përmbushja e rekomandimeve të dala nga Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve, ka ngecje përbrenda institucionit menaxhues. Prandaj, nisur nga këto konstatime, mund të vlerësojmë se me apo pa dashje, prerjet e pa rregullta vazhdojnë të jenë kërcënuese në lidhje me ruajtjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e grumbujve pyjor.

**Tabela 56: Planifikimi dhe realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore 2022 sipas DKR**

DKR - APK	Dru teknik (neto m <sup>3</sup> )	Dru zjarri (neto m <sup>3</sup> )	Gjithsej (neto m <sup>3</sup> )	Mbetjet pyjore	Plani m <sup>3</sup>	Realizimi m <sup>3</sup>	Realizimi %
DKR Prishtinë	308	4,132	4,440	190	4,630	1,329	29
DKR Mitrovicë	284	7,466	7,750	815	8,565	63	1
DKR Pejë	132	10,177	10,309	786	11,095	3,860	34
DKR Prizren	198	3,779	3,977	195	4,173	3,483	83
DKR Ferizaj	4,780	11,069	15,849	732	16,581	7,230	44
DKR Gjiilan	2,339	11,431	13,770	650	14,420	4,193	29
DMKEGjKE	92	2,725	2,818	153	2,971	2,035	69
<b>PVMP 2022</b>	<b>8,132</b>	<b>50,780</b>	<b>58,913</b>	<b>3,522</b>	<b>62,435</b>	<b>22,193</b>	<b>35</b>

Burimi: APK

Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore në vitin 2022, sipas Drejtorive Koordinuese ka qenë gjithsej 22,193 m<sup>3</sup>. Nga këto dru teknik ishin 2,690 m<sup>3</sup>, dru zjarri 19,472 m<sup>3</sup> dhe mbeturina 31.11 m<sup>3</sup>.

### Pyjet private

Agjencia Pyjore së bashku me autoritetet pyjore komunale ka realizuar një mori aktivitësh që ndërlidhen me rregullimin e pyjeve dhe kryerjen e shërbimeve të ndryshme në sektorin e pyjeve private. Këtu mund të përmendim: pranimit dhe shqyrtimi i kërkesave për trajtim të pyjeve private, damkosje në pyje, lëshimi i fletëdamkosjeve, lejeve për prerje, fletëpërcjellësve etj.

**Tabela 57: Plani i shfrytëzimit të pyjeve në pronën private në m<sup>3</sup>, 2022**

Plani në kultivimi dhe shfrytëzimin e pyjeve private	Njësia	Gjithsej
Ngritja e pyjeve të reja - pyllëzime	ha	57
Përtërirja e pyjeve - meliorim	ha	142
Kultivim i pyjeve	ha	2,395
Shfrytëzim i pyjeve	ha	3,407
<b>Punët tekniko-profesionale</b>		
Kërkesa të parapara-parashtruara (vendime)	copë	4,125
Planifikimi i prerjeve në pyjet private	m <sup>3</sup>	178,000
Dru Zjarri	m <sup>3</sup>	166,090
Dru Teknik	m <sup>3</sup>	11,910

Burimi: APK

Tek kultivimi dhe shfrytëzimi i pyjeve përfshihen ngritja e pyjeve të reja – pyllëzime me 57 ha, përtrirja e pyjeve – melorim me 142 ha, kultivim i pyjeve me 2,395 ha dhe shfrytëzim i pyjeve me 3,407 ha, ndërsa tek punët tekniko-profesionale përfshihen kërkesat e parapara dhe parashtruara (vendimet), planifikimet e prerjeve në pyjet private, drunjte e zjarrit dhe drunjte teknik.

**Tabela 58: Realizimi i aktiviteteve në pyjet private, 2022**

Pyjet private	Njësia	Gjithsej
Kërkesat e shqyrtuara	copë	2,669
Damkosja e trungjeve	m <sup>3</sup>	149,121
Damkosja për transport	m <sup>3</sup>	
Masa drunore e përcjellë	m <sup>3</sup>	116,854
Numri i fletë-dërgesave të dhëna	copë	25,620
Kontrolla-vështrime profesionale	raste	2,401
Drurët jashtë pyllit	m <sup>3</sup>	9,104
Pyllëzimet në prona private	ha	0

Burimi: APK

Gjatë vitit 2022 kërkesat e shqyrtuara në pyjet private kanë qenë 2,669 copë gjithsej. Damkosja e trungjeve ishte në vëllim prej 149,121 m<sup>3</sup>. Numri i fletëdërgesave të dhëna ishte 25,620 copë, ndërsa kontrolla-vështrime profesionale ishin 2,401 raste. Përderisa shfrytëzimi i drunjëve jashtë pyjeve siç janë: masat drunore buzë lumenjëve, prrockave, mexhave dhe sipërfaqeve të vogla të tjera ishte 9,104 ha.

### **Mbrojtja e pyjeve - Aktivitetet**

Çështja e mbrojtjes së pyjeve nga autoritetet komunale, është një nga sfidat me të cilat po përballemi vazhdimisht dhe e cila është një nga çështjet më të trajtuara nga MBPZhrR-ja dhe APK-ja. Deri më tani të gjitha format nuk kanë dhënë rezultate të mira në ndalimin apo zvogëlimin e dukurisë së prerjeve të pa rregullta. Është e ditur se kjo çështje është shumë e ndërlikuar me gjendjen ekonomike sociale të zonave malore dhe të thella rurale, në të cilat pyjet konsiderohen si burim i mbijetesës. Lidhur me këtë ekziston një bashkëpunim i ndërsjellë në mes autoriteteve lokale dhe atyre qendrore në marrjen e masave, por deri më tani nuk ka rezultate shumë të kënaqshme.

### **Kallëzimet në gjykatë**

Për vitin 2022 nga autoritetet komunale janë ngritur rreth 2,323 fletëparaqitje për kundërvajtje, dhe rreth 574 fletëparaqitje penale. Ndërsa, për të njëjtën periudhë është raportuar se është konfiskuar një sasi deri në 2,101 m<sup>3</sup> dru teknik dhe zjarri.

**Tabela 59: Kallëzimet apo fletëparaqitjet e ngritura për Janar - Dhjetor 2022**

Dëmi Pyjor	Copë	m <sup>3</sup>	Gjithsej (€)
Fletëparaqitje kundërvajtje	2,323	7,884	471,112
Fletëparaqitje penale	574	2,887	325,489
<b>Gjithsej fletëparaqitje</b>	<b>2,897</b>	<b>10,771</b>	<b>796,601</b>

Burimi: APK

Në vitin 2022, Autoritetet Komunale për Pylltari kanë ngritur 2,897 kallëzime penale dhe kanë iniciuar procedura për kundërvajtje, vlera e dëmit të së cilave llogaritet në vëllim prej 10,771 m<sup>3</sup> dhe në vlerë monetare prej 796,601 €. Nga totali i fletëparaqitjeve, 2,323 prej tyre ishin kundërvajtje në vëllim prej 7,884 m<sup>3</sup> në vlerë monetare prej 471,112 €, ndërsa 574 ishin kallëzime penale me vëllim prej 2,887 m<sup>3</sup> dhe vlerë monetare prej 325,489 €.

Aktivitetet e paligjshme në sipërfaqet pyjore vazhdojnë të jenë një dukuri për të cilat institucionet përkatëse ndërmarrin masa për parandalimin e tyre. Tabela më poshtë ilustron mbrojtjen e pyjeve dhe konfiskimin e masës drunore nga prerësit e paligjshëm.

**Tabela 60: Paraqitja e materialit drunorë të konfiskuar nga prerësit e paligjshëm**

Mbrojtja e Pyjeve, Konfiskimi i masës drunore në m <sup>3</sup> 2022	
Masa Drunore e bartur	2,284
Masa Drunore e konfiskuar	1,790
Sasia e shitur	1,382
Sasia e dhënë në bazë të memorandumit	-
<b>Gjendja momentale e stoqeve</b>	<b>2,692</b>

Burimi: APK

Masa drunore e bartur në këtë vit ka qenë 2,284 m<sup>3</sup>. Në këtë periudhë nuk ka pasur sasi të dhënë në bazë të memorandumit. Po ashtu ka pasur edhe konfiskime nga ana e autoriteteve komunale ku janë konfiskuar 1,790 m<sup>3</sup>, sasi të shitur 1,382 m<sup>3</sup> dhe gjendja momentale të stoqeve 2,692 m<sup>3</sup>.

## Zjarret pyjore

Duke u mbështetur në planin vjetor të menaxhimit, Agjencia Pyjore ndërmori një mori aktivitete në veçanti për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret pyjore. Gjatë vitit 2022, numri i rasteve dhe përfshirja e sipërfaqeve nga zjarret në pyje ka shënuar rritje të vazhdueshme duke u dyfishuar. Shkaktarë të saj ishin rritja e temperaturave gjatë këtij viti, por edhe pakujdesia e njerëzve. Sipas analizave dhe studimeve rreth 99% e zjarreve në pyje shkaktohen nga faktori njeri, vetëm 1% e tyre mund të shkaktohen nga faktorët abiotik. Në vendin tonë zakonisht zjarret shkaktohen në periudhën e thatësirës gjatë muajve të verës (Qershor, Korrik, Gusht). Por, përjashtohen zjarret në pranverën e hershme apo vjeshtë kur bujqit fillojnë të merren me punimin e tokave bujqësore, livadheve, kullosave, etj. Megjithatë, sipas raportit të Agjencisë Pyjore gjatë vitit 2022 janë evidentuar gjithsej 476 raste të zjarreve, të cilat kanë përfshirë pyjet private dhe ato publike në një sipërfaqe deri 1,597 ha.

**Tabela 61: Paraqitja e rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqet pyjore të përfshira në vitin 2022**

Rajonet	Nr. Rasteve	Sip. në ha publike	Sip. në ha private	Gjithsej (ha)
Prishtinë	38	72	81	153
Mitrovicë	8	46	55	101
Pejë	3	3.1	9	12
Prizren	32	105	55	160
Ferizaj	384	87	125	212
Gjilan	11	663	296	959
<b>Gjithsej</b>	<b>476</b>	<b>976</b>	<b>621</b>	<b>1,597</b>

Burimi: APK

Në vitin 2022 në komunat e Kosovës ka pasur zjarre pyjore sipërfaqja e të cilave ka përfshirë rreth 1,597 ha, por zjarret kanë qenë sipërfaqësore dhe nuk kanë shkaktuar dëme të mëdha në masën drunore. Komuna e Prishtinës kishte 38 raste të zjarreve, prej të cilave 72 ha ishin pyje publike dhe 80.6 ha private, gjithsej 152.6 ha. Komuna e Prizrenit ka pasur 32 raste të cilat rezultuan në gjithsej 160.3 ha, prej të cilave 105 ha ishin pyje publike dhe 55.3 ha private. Ndonëse në Komunën e Ferizajit numri i rasteve ishte 384, prej të cilave 87 ha ishin pyje publike dhe 125 ha private. Gjilani, kishte 11 raste por sipërfaqja e përfshirë ishte më e madhja ndër Komunat e tjera me gjithsej 959.2 ha, prej të cilave 662.8 ha ishin pyje publike dhe 296.4 ha pyje private, në Komunën e Pejës dhe Mitrovicës, kishte 11 raste me gjithsej 221.1 ha.

**Tabela 62: Prodhimtaria e fidanëve, 2022**

Lloji i Fidanëve	Mënyra e kultivimit	Copë
Halor	Klasik	450,000
Halor	Industrial	-
Fletor	Klasik	407,500
Fletor	Industrial	-
<b>Gjithsej</b>		<b>857,500</b>

Burimi: APK

Gjatë vitit 2022 në fidanishten e Institutit të Pejës janë kultivuar gjithsej 857,500 fidanë pyjor, nga këto 450,000 copë janë Halor klasik dhe 407,500 janë Fletor klasik.

## 4 Tregtia dhe trendet e konsumit

### 4.1 Trendet e konsumit

Vitet e fundit trendet e konsumit kanë lëvizur jo vetëm në Kosovë po edhe në nivel global, marrë parasysh faktin se jemi përball dhe po vazhdojmë të përballemi me faktorë të ndryshëm si pandemia COVID 19 dhe lufta në Ukrainë të cilat kanë ndikuar në çdo aspekt të mirëqenies duke përfshirë edhe kushtet e jetesës.

Sa i përket të dhënave mbi informacionet kryesore për treguesit që kanë të bëjnë me kushtet e jetesës si dhe karakteristikat me bazë demografike, ekonomike dhe sociale të ekonomive familjare në Kosovë, për një periudhë 4 vjeçare nuk ka pas të dhëna zyrtare. Ndërsa, së fundmi janë publikuar të dhënat për vitin 2022, lidhur me buxhetin e ekonomive familjare, ku nga këto të dhëna për vitin 2022 vërehet se totali i shpenzimeve për konsum në Kosovë në vitin 2022 ishte 2,527 mil. €, shpenzimet në konsum për një ekonomi familjare ishin 8,106 €, ndërsa shpenzimet për kokë banori ishin 1,903 €.

**Tabela 63: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë, 2022**

Gjithsej në mil. (€)	Konsumi për ekonomi familjare (€)	Konsumi për kokë banori (€)
2,527	8,106	1,903

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, 2022

Duke ju referuar shpërndarjes së konsumit, sipas grupeve të konsumit vërehet se pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2022 është shpenzuar në ushqim dhe banim me pjesëmarrje rreth 55% për ushqim dhe 14% për banim. Pasojnë shpenzimet për transport 7%, për veshmbathje 6%, për alkool dhe duhan, shëndetësia si dhe mobilitet me nga 3%, komunikimi dhe rekreacioni me nga 2% dhe nga 1% paraqiten shpenzimet për edukim dhe shpenzimet në hotele dhe restorante.

**Tabela 64: Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit, 2022**

Konsumi	Vlera €	%
Ushqim dhe pijet joalkoolike	1,398,178,236	55
Alkool dhe duhan	86,838,554	3
Veshmbathja	148,324,310	6
Banim	354,545,574	14
Mobilie	73,120,442	3
Shëndetësi	66,875,241	3
Transport	184,167,496	7
Komunikim	53,779,944	2
Rekreacion	56,354,650	2
Edukim	14,356,657	1
Hotele dhe restorante	35,430,852	1
Të tjera	55,111,325	2
<b>Gjithsej</b>	<b>2,527,083,280</b>	<b>100</b>

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, 2022

Sa i përket shpërndarjes së konsumit të ushqimit në Kosovë, sipas të dhënave vërehet se konsumi dominohet nga buka dhe drithërat prej 19%, pasuar nga mishi me 18%, qumështi, djathi dhe vezët me 12%, perimet dhe pijet jo alkoolike me nga 12% secila, frutat dhe produktet tjera ushqimore me nga 7% secila, sheqeri dhe ëmbëlsirat 6%, vajrat dhe yndyrat 5%, si dhe peshku 2%.

**Tabela 65: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë, 2022 (%)**

Konsumi	%
Buka dhe drithërat	19
Mishi	18
Peshku	2
Qumështi, Djathi, Vezët	12
Vajrat dhe yndyrat	5
Frutat	7
Perimet	12
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	6
Produkte tjera ushqimore	7
Pijet jo alkoolike	12
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, 2022

Referuar burimit kryesor të të hyrave për ekonomitë familjare gjatë vitit 2022, vërehet se burimi kryesor i të hyrave ishin pagat nga sektori publik dhe privat specifikisht me 19% dhe 39%.

Burime të tjera të rëndësishme të të hyrave të ekonomive familjare ishin pensionet me 15%, pasuar nga paratë e dërguara nga jashtë (remitencat) 7%, bizneset e tjera të ekonomive familjare 6%, ndërsa burime tjera, të ardhurat nga mëditjet, ndihma sociale kategoria I, marrin pjesë me nga 3%, me nga 2% llogariten të hyrat nga bujqësia dhe pensionet e familjarëve të dëshmorëve, si dhe të ardhurat nga prona me 1%.

**Tabela 66: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, 2022 (%)**

Burimi i të hyrave	%
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	19
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	39
Bujqësi	2
Të ardhurat nga mëditjet <sup>1</sup>	3
Biznese të tjera të ekonomive familjare	6
Pensionet	15
Të hollat e dërguara nga jashtë	7
Të hollat e dërguara nga Kosova	0
Ndihma sociale - Kategori I	3
Ndihma sociale - Kategori II	0
Të ardhurat nga prona	1
Pensionet e familjeve të dëshmorëve	2
Të tjera <sup>2</sup>	3
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>

Burimi: Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, 2022; <sup>1</sup>Të hyrat nga aktivitetet e përkohshme;

<sup>2</sup>Burimi i të hyrave jo të përcaktuara në kategoritë më lartë.

## 4.2 Tregtia e përgjithshme

Shkëmbimi tregtar i Kosovës për periudhën 2018-2022 ka shënuar rritje. Në vitin 2022, eksporti i përgjithshëm (kapitujt 01-98), ka vlerë prej 920.4 mil. €, që kishte rritje 22.8% krahasuar me vitin 2021. Vlera e importit në periudhën 2018-2020 ishte mbi 3 mld. €, në vitin 2021 ishte rritur në mbi 4.5 mld. €, ndërsa në vitin 2022 ka pasur rritje të importit në mbi 5.5 mld. €, që paraqet rritje për 21.3% në krahasim me vitin 2021. Mbulueshmëria e Importit me Eksport në vitin 2022 ishte 16.3%.

**Tabela 67: Eksporti-Importi i përgjithshëm, në '000 €**

Viti	Eksporti (1-98)	Importi (1-98)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2018	367,500	3,347,007	-2,979,507	11.0
2019	383,491	3,496,431	-3,112,940	11.0
2020	474,960	3,296,324	-2,821,364	14.4
2021	749,720	4,653,050	-3,903,330	16.1
2022	920,405	5,643,604	-4,723,200	16.3

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

## 4.3 Tregtia e produkteve bujqësore

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore gjatë periudhës (2018-2022) ka shënuar rritje çdo vit, në vitin 2022 vlera e eksportit të produkteve bujqësore ishte 118.9 mil. €, që paraqet rritje prej 28.4% në krahasim me vitin paraprak. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ pasi që vlera e importit në vitin 2022 ishte rreth 1.2 mld. €, me rritje prej 24.0% në krahasim me vitin 2021.

**Tabela 68: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, në '000 €**


Viti	Eksporti (1-24)	Importi (1-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2018	63,950	712,314	-648,364	9.0
2019	65,510	759,359	-693,849	8.6
2020	78,076	765,357	-687,281	10.2
2021	92,642	965,569	-872,927	9.6
2022	118,949	1,197,126	-1,078,177	9.9

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Edhe në vitin 2022 bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, vlera e bilancit tregtar në vitin 2022 ishte rreth 1.1 mld. €, ndërsa sa i përket shkallës së mbulueshmërisë së importit me eksport, në vitin 2022 ishte në shkallë prej 9.9%.



**Figura 26: Eksporti, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në '000 €**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në dy vitet e fundit pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm ka pësuar rënie në krahasim me periudhën (2018-2020). Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore (01-24) në eksportin e përgjithshëm (01-98) në vitin 2022 ishte 13%, që ka pasur rritje prej 1 pikë % në krahasim me vitin 2021.

Pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore (01-24) në importin e përgjithshëm (01-98) në vitin 2022 ishte 21% që paraqet nivel të njëjtë të pjesëmarrjes si vitin e kaluar, ndërsa viti 2020 ishte viti me pjesëmarrjen më të lartë të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm me 23%.

**Figura 27: Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm (djathtas)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

### 4.3.1 Tregtia sipas grupeve të shteteve

Gjithsej eksporti i produkteve bujqësore gjatë vitit 2022 kishte vlerë 118.9 mil. €, ku 65.5 mil. € ishin nga vendet e CEFTA-s, 42.0 mil. € nga vendet e BE-së dhe pjesa tjetër prej 11.4 mil. € nga vendet e tjera. Vlera e importit (rreth 1.2 mld. €) në vitin 2022 ishte dukshëm më e lartë se sa vlera e eksportit, ku 314.2 mil. € ishin nga vendet e CEFTA-s, 313.8 mil. € nga vendet e tjera dhe vlera më e lartë prej 569.1 mil. € nga vendet e BE-së.


**Tabela 69: Eksporti, Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2022 në '000 €**

	CEFTA	Vendet e BE-së	Vendet tjera	Gjithsej
Eksporti (1-24)	65,546	41,999	11,404	118,949
Importi (1-24)	314,208	569,137	313,780	1,197,126
Bilanci tregtar	-248,662	-527,139	-302,376	-1,078,177
Eksporti/Pjesëmarrja në %	55.1	35.3	9.6	100.0
Importi/Pjesëmarrja në %	26.2	47.5	26.2	100.0
Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)	20.9	7.4	3.6	9.9

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

Vlera më e lartë e eksportit sipas grupeve të shteteve për vitin 2022 ishte në vendet e CEFTA-s me 55%, pasuar nga vendet e BE-së me 35% dhe vendet e tjera me 10%. Ndërsa vlera më e lartë e importit ishte nga grupi vendet e BE-së me 48% pasuar nga vendet e CEFTA-s dhe vendet tjera me nga 26% secili.

**Figura 28: Eksporti sipas grupeve të shteteve (majtas), Importi sipas grupeve të shteteve (djathtas), 2022 në %**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

### Tregtia me vendet e CEFTA-s

Në periudhën (2020-2022), eksporti në vendet e CEFTA-s ka qenë më i lartë krahasuar me periudhën (2018-2019). Eksporti në vitin 2022 ka pasur vlerën 65.5 mil. €, 27% më i lartë se sa

në vitin paraprak. Importi nga vendet e CEFTA-s në vitin 2022 ishte 314.2 mil. €, 18% më i lartë se sa në vitin 2021.

**Tabela 70: Eksporti- Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në '000 €**


Vitet	Eksporti (1-24)	Importi (1-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2018	38,762	239,244	-200,482	16.2
2019	38,386	113,072	-74,686	33.9
2020	41,135	183,381	-142,246	22.4
2021	51,594	266,571	-214,977	19.4
2022	65,546	314,208	-248,662	20.9

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja e eksportit në vendet e CEFTA-s për periudhën (2018-2020) ka pasur ulje graduale prej 61% sa ishte në vitin 2018 në 53% në vitin 2020, e që pastaj ka shënuar ngritje në 55% në vitin 2022.

Pjesëmarrja më e madhe e importit nga vendet e CEFTA-s ishte në vitin 2018 me 34% përcjellë nga një rënie në vitin 2019 në 15%, për tu pasuar nga një pjesëmarrje mesatare prej 26% për periudhën 2020-2022.

**Figura 29: Pjesëmarrja e CEFTA-s në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e CEFTA-s në importin bujqësor (djathtas)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2022 ka pasur rritje të vlerës së eksportit të produkteve bujqësore në shtetet e CEFTA-s për 27%, krahasuar me vitin paraprak, rritje më të lartë ka pasur në këto shtete: vlara e eksportit në Malin e Zi është trefishuar, Maqedoni është rritur për 35.1% dhe Shqipëri 19.1%.

Vlera e importit në vitin 2022 nga vendet e CEFTA-s është rritur për 18% krahasuar me vitin 2021.

Rritje më të theksuar ka pasur importi nga Moldavia me 30% edhe pse vlera e tij në raport me importin nga shtetet e tjera është e ulët, B. Hercegovina me 28%, Serbia me 23%, vijuar nga Shqipëria me 19%, ndërsa importi nga Mali i Zi ka shënuar ulje për 2%.


**Tabela 71: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, në '000 €**

Vendet	Eksport			Import		
	2021	2022	Ndryshimi '22/'21, (%)	2021	2022	Ndryshimi '22/'21, (%)
B. Hercegovina	1,593	1,616	1.4	17,325	22,185	28.0
Mali i Zi	2,140	6,687	212.4	5,657	5,569	-1.6
Maqedonia e Veriut	12,452	16,821	35.1	58,715	60,839	3.6
Moldavia	3	0	-100.0	143	186	30.3
Serbia	9,117	9,114	0.0	151,668	186,001	22.6
Shqipëria	26,289	31,308	19.1	33,062	39,428	19.3
<b>Gjithsej</b>	<b>51,594</b>	<b>65,546</b>	<b>27.0</b>	<b>266,571</b>	<b>314,208</b>	<b>17.9</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vlerën totale të eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, pjesëmarrjen më të madhe e kishte Shqipëria me 48% pasuar nga Maqedonia e Veriut me 26%, Serbia me 14%, Mali i Zi me 10% dhe B. Hercegovina me 2%. Pjesëmarrjen më të madhe në vlerën e importit e kishte Serbia me 59% vijuar nga Maqedonia e Veriut me 19% pastaj Shqipëria me 13%, B. Hercegovina me 7% dhe Mali i Zi me 2%.

**Figura 30: Eksporti sipas vendeve të CEFTA-s (majtas), Importi sipas vendeve të CEFTA-s (djathtas), 2022**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## Tregtia me vendet e BE-së

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore me vendet e BE-së gjatë periudhës (2018-2022) ka pasur rritje të vazhdueshme, në vitin 2022 vlera e eksportit ishte rreth 42.0 mil. €, 32.4% më e lartë se sa në vitin 2021.

Vlera e importit nga vendet e BE-së në vitin 2022 ka qenë 569.0 mil. € që është rritur për 21.9% në krahasim me vitin paraprak.

**Tabela 72: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së, në '000 €**

Viti	Eksporti (1-24)	Importi (1-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2018	19,987	294,748	-274,761	6.8
2019	20,377	441,580	-421,203	4.6
2020	29,360	404,641	-375,282	7.3
2021	31,711	466,997	-435,286	6.8
2022	41,999	569,137	-527,139	7.4


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

\*Të dhënat e shkëmbimit tregtar për periudhën 2018-2022 janë për 27 shtete dhe dallojnë nga vitet tjera pasi që janë të prezantuara pa Britaninë e Madhe pas Brex-it nga BE në vitin 2020

Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e BE-së në eksportin e përgjithshëm për vitin 2022, ishte 35% që ishte ngritur për 1 pikë % në krahasim me vitin 2021.

Pjesëmarrja më e lartë e importit nga vendet e BE-së për periudhën (2018-2022) ishte në vitin 2019 me 58% dhe gjatë viteve tjera ka filluar të ulët, ku në vitin 2022 ishte 48% që paraqet pjesëmarrje të njëjtë si në vitin 2021.

**Figura 31: Pjesëmarrja e BE-së në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e BE-së në importin bujqësor (djathtas)**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


\*Të dhënat e shkëmbimit tregtar për periudhën 2018-2022 janë për 27 shtete dhe dallojnë nga vitet tjera pasi që janë të prezantuara pa Britaninë e Madhe pas Brex-it nga BE në vitin 2020

Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e BE-së është rritur për 32.4% në krahasim me vitin paraprak. Rritje më të madhe të eksportit ka pasur në Holandë me 138.8%, pasur nga Italia me 78.0%, Rumania me 69.7% dhe vendet e tjera që kishin rritje më të ulët se 50%.

Shtetet të cilat janë paraqitur më poshtë paraqesin 92.4% të vlerës së eksportit të produkteve, ndërsa pjesën tjetër prej 7.6% është eksport i produkteve bujqësore në shtete të tjera të BE-së.

**Tabela 73: Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 € (majtas) dhe Eksporti sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)**

	2021	2022	Ndryshimi '22/'21, (%)	Pjesëmarrj a 2022 në %
Gjermani	11,910	12,008	0.8	28.6
Holandë	3,248	7,754	138.8	18.5
Itali	2,772	4,932	78.0	11.7
Bulgari	2,923	3,269	11.8	7.8
Austri	1,992	2,920	46.6	7.0
Kroaci	2,510	2,799	11.5	6.7
Suedi	1,803	2,509	39.2	6.0
Rumani	952	1,616	69.7	3.8
Francë	741	994	34.2	2.4
Të tjera	2,860	3,197	11.8	7.6
<b>Gjithsej BE 27</b>	<b>31,711</b>	<b>41,999</b>	<b>32.4</b>	<b>100.0</b>




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së është rritur për 21.9% në krahasim me vitin paraprak, ku vendet në të cilat rritja ka qenë më e theksuar ishin: Franca me 177.1% vijuar nga Bullgaria me 36.4%, Hungaria me 32.8%, Sllovenia me 27.0%, Austria me 24.4% dhe vendet tjera të paraqitura në tabelë më përqindje më të ulët.

**Tabela 74: Importi sipas vendeve të BE-së, në '000€ (majtas) dhe Importi sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)**

	2021	2022	Ndryshimi '22/'21, (%)	Pjesëmarrja 2022 në %
Gjermani	73,460	86,213	17.4	15.1
Itali	58,679	69,030	17.6	12.1
Poloni	66,288	67,274	1.5	11.8
Kroaci	57,522	64,724	12.5	11.4
Sloveni	38,207	48,523	27.0	8.5
Hungari	33,415	44,360	32.8	7.8
Bulgari	23,805	32,480	36.4	5.7
Austri	24,766	30,816	24.4	5.4
Hollandë	23,770	24,668	3.8	4.3
Francë	8,745	24,232	177.1	4.3
Të tjera	58,342	76,817	31.7	13.5
<b>Gjithsej BE 27</b>	<b>466,997</b>	<b>569,137</b>	<b>21.9</b>	<b>100.0</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR



Shtetet të cilat janë paraqitur më lartë paraqesin 86.5% të vlerës së importit të produkteve bujqësore nga vendet e BE-së (pjesëmarrje më të madhe kanë Gjermania, Italia, Polonia dhe Kroacia), ndërsa pjesa tjetër prej 13.5% e vlerës së importit është nga vendet e tjera të BE-së.

### Tregtia me vendet e treta

Shkëmbimi tregtar i Kosovës gjatë periudhës (2018-2022) me vendet e treta ka shkuar duke u rritur, eksporti i produkteve bujqësore në vendet e treta në vitin 2022 ishte në vlerë prej 11.4 mil. €, 22.1% më i lartë se sa në vitin 2021. Importi i produkteve bujqësore nga vendet e treta në vitin 2022 ishte në vlerë prej 313.8 mil. €, 35.2% më i lartë se sa në vitin 2021. Bilanci tregtar me vendet e treta edhe në vitin 2022 vazhdon të jetë negativ.

**Tabela 75: Eksporti dhe Importi nga Vendet e Treta, në '000 €**

Viti	Eksport (01-24)	Import (01-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e importit me eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2018	5,202	178,322	-173,121	2.9
2019	6,747	204,707	-197,960	3.3
2020	7,581	177,334	-169,753	4.3
2021	9,337	232,001	-222,663	4.0
2022	11,404	313,780	-302,376	3.6


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

\*Të dhënat e shkëmbimit tregtar me vendet e treta për periudhën 2018-2022 dallojnë nga vitet e tjera pasi që janë të prezantuara me Britaninë e Madhe pas Brex-it nga BE në vitin 2020

Shtetet me pjesëmarrjen më të madhe në eksport nga grupi i vendeve të treta ishin: Zvicra me 30%, Mbretëria e Bashkuar me 24%, SHBA me 15%, Turqia me 8% dhe vendet tjera me 23%.

Shtetet me pjesëmarrjen më të madhe në import nga grupi i vendeve të treta ishin: Turqia me 30%, Brazili me 29%, Zvicra me 5%, SHBA me 3% dhe vendet tjera me 33%.

**Figura 32: Eksporti në Vendet e Treta, (majtas) dhe Importi nga Vendet e Treta (djathtas), në %**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR



## 4.3.2 Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

### Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti total i produkteve bujqësore në vitin 2022 ishte 118.9 mil. €, që paraqet rritje prej 28% në krahasim me vitin 2021. Rritje më të theksuar ka pasur në kapitujt 01, 02, 03, 15 dhe 24. Kapitujt të cilët kanë shënuar rënie në vitin 2022 në krahasim me vitin e kaluar janë: 08, 10, 11, 12. Kapitujt e tjerë kanë pasur rritje nën 100%.

**Tabela 76: Eksporti i produkteve bujqësore 2018-2022, në '000 €**

Kod i	Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	2022
01	Kafshët e gjalla	17	0	0	0	856
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	127	333	337	654	7,828
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	110	106	111	216	530
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore,	471	758	841	1,211	2,118
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	0	134	4	118	228
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	226	1,170	1,641	1,468	2,143
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	5,636	5,307	8,869	6,415	9,817
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	8,781	7,675	9,681	11,391	9,132
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	3,971	4,319	5,890	6,147	7,063
10	Drithërat	386	118	513	505	300
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	2,411	913	1,133	1,872	1,305
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	2,414	3,481	4,064	3,648	3,536
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	0	0	0	0	1
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	1	5	0	8	10
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	343	1,363	1,433	1,695	4,525
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	776	872	1,817	4,037	7,795
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	712	696	846	990	1,262
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	1,763	1,821	1,449	1,987	2,917
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pasticerisë	1,893	1,785	1,667	2,130	3,447
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve	4,507	4,556	6,378	8,798	11,152
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	612	601	638	1,229	1,542
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	27,565	28,666	29,667	36,638	39,040
23	Mbetjet nga industrinë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	1,228	709	1,093	1,452	2,189
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	0	122	5	32	215
<b>Gjithsej (01-24)</b>		<b>63,950</b>	<b>65,510</b>	<b>78,076</b>	<b>92,642</b>	<b>118,949</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)

Importi total i produkteve bujqësore në vitin 2022 ishte rreth 1.2 mld. €, që paraqet rritje prej 24% në krahasim me vitin 2021. Kapitujt të cilët kanë shënuar rënie në vitin 2022 në krahasim me vitin e kaluar janë: 05, 12 dhe 14. Kapitujt e tjerë kanë shënuar rritje të vlerës së importit.

**Tabela 77: Importi i produkteve bujqësore 2018-2022, në '0000 €**

Kodi	Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	2022
01	Kafshët e gjalla	15,502	19,673	30,236	49,285	69,972
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	64,878	74,391	60,824	82,618	125,315
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	2,999	3,603	4,236	5,227	6,353
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	47,672	49,793	50,800	58,504	77,136
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	986	1,313	1,098	1,745	1,467
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	4,566	4,813	5,926	6,757	7,828
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	24,742	28,171	24,957	31,150	33,906
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	34,415	36,464	39,185	43,365	44,889
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	31,163	30,051	27,839	32,053	38,207
10	Drithërat	36,434	39,275	41,893	38,645	54,548
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	9,187	10,559	13,689	10,588	12,044
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	10,703	10,434	9,852	11,195	10,614
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	534	447	386	405	411
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	10	8	14	31	15
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	27,930	30,054	32,135	41,398	61,128
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	26,677	29,853	31,754	36,631	43,316
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	28,296	30,377	30,795	38,063	51,090
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	23,888	24,648	25,509	30,221	32,504
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pasticerisë apo prej brumërave	64,618	66,239	69,975	88,803	105,421
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve	27,321	28,847	28,130	36,892	40,093
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	68,105	74,635	75,852	90,955	106,476
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	77,152	80,667	76,266	115,123	135,837
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	19,688	16,251	20,903	29,391	33,540
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	64,848	68,793	63,101	86,522	105,019
<b>Gjithsej (1-24)</b>		<b>712,314</b>	<b>759,359</b>	<b>765,357</b>	<b>965,569</b>	<b>1,197,126</b>

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## 5 Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit

MBPZHR përmes Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), i cili është autoriteti më i lartë për Ushqim dhe Veterinari në vend dhe ka për mandat të mbrojë jetën dhe shëndetin e njerëzve, bën sigurimin e nivelit të lartë të sigurisë së ushqimit, përfshirë edhe ushqimin e kafshëve, shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve, përkujdesjen ndaj kafshëve si edhe cilësinë e ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore.

Bazuar në mandatin e AUV, në vijim do të paraqiten të dhënat e raportuara nga drejtoritë përkatëse mbi aktivitetet e tyre përmes të cilave mbrohet jeta dhe shëndeti i njerëzve dhe kafshëve si dhe sigurohet cilësia e ushqimit në përgjithësi.

Sa i përket sëmundjeve infektive si avian influenca, brucela, TBC, pesta amerikane, të cilat ishin prezente gjatë vitit 2022, në shumicën e rasteve varësisht llojit të sëmundjes është arritur që të mbrohen fermat përmes testimeve dhe asgjësimeve të shpejta, duke i përcjellë gjithnjë protokollet për luftimin e sëmundjes.

Gjithashtu ka vazhduar edhe për vitin 2022 vaksinimi i kafshëve kundër sëmundjes së tërbimit, ku dhe shpërndarja e vaksinave është bërë sipas protokolleve.

Tabelat në vijim ofrojnë detajet dhe të dhënat mbi vaksinimin, analizat laboratorike, sëmundjet infektive, lëshimin e lejeve të importit dhe licencimin e subjekteve afariste si pjesë e shëndetit publik dhe mirëqenies së kafshëve.

**Tabela 78: Shpërndarja e vaksinave sipas sëmundjeve të kafshëve**

Emërtimi	Lloji i vaksinës
Lloji i vaksinimit	Tërbim
Emri i vaksinës	Biocan/Bioveta
Emri i tabletave	Biheldon
Sasia e vaksinës së shpërndarë	11,498 doza
Lloji i kafshëve të vaksinuara	Qen

Burimi: AUV

**Tabela 79: Marrja e mostrave të gjakut për analiza laboratorike**

Emërtimi i analizave laboratorike	Nr. i mostrave të marra
Analizat patologjike	157
Analizat serologjike, dyshimi për sëmundjen e kafshëve në terren	874
Karantina	305
Testimi për sëmundjen AI	119
Analizat bakteriologjike	21

Burimi: AUV

**Tabela 80: Asgjësimi i kafshëve sipas sëmundjeve infektive**

Emërtimi i sëmundjes	Lloji i kafshës	Nr. i shpërthimeve	Të asgjësuarat/krerë
Brucela abortus	Gjedhe	30	151
Brucela melitensis	Dele	3	66
Brucela melitensis	Dhi	1	3
TBC	Gjedhe	5	20
Pesta Amerikane	Bletë	44	146
Avian Influenza	Shpezë	23	91

Burimi: AUV

Sa i përket lëshimit të lejeve të importit gjatë vitit 2022, numri i lejeve të lëshuara ishte gjithsej 604. Të ndara në leje për import të kafshëve të gjalla për therje (288), import të ushqimit për kafshë (245), import të zogjëve një ditë (40), import të gjedheve për reproduksion (18), me nga 5 leje për import për material gjenetik dhe viçave për majmëri si dhe 3 leje për import të kuajve për rekreacion.

**Tabela 81: Lëshimi i lejeve të importit**

Lloji i lejeve të importit	Numri i lejeve
Importi i kafshëve të gjalla për therje	288
Importi i ushqimit për kafshë	245
Import i materialit gjenetik	5
Import i gjedheve për reproduksion	18
Import i zogjëve një ditë	40
Import i kuajve për rekreacion	3
Importi viçave për majmëri	5
<b>Gjithsej</b>	<b>604</b>

Burimi: AUV

Lidhur me licencimin e subjekteve afariste, janë licencuar gjithsej 41 subjekte. Licencimi dhe vazhdimi i licencave për ambulanta veterinarë është bërë për 40 subjekte, ndërsa për ushqim për kafshë është licencuar vetëm 1 subjekt.

**Tabela 82: Licencimi i subjekteve afariste**

Nr.	Lloji i licencave	Gjithsej
1	Licencimi i ambulantave veterinarë, vazhdimi i licencave	40
2	Licencimi i OB për ushqim për kafshë	1

Burimi: AUV

Në mënyrë të përmbledhur gjatë vitit 2022 të gjithë sektorët përkatës të Drejtorisë së Inspektoratit kanë kryer gjithsej 68,063 inspektime, ku prej tyre 41,896 janë inspektime nga sektori fitosanitar i kufirit, 12,280 nga sektori veterinar i kufirit, 6,338 nga sektori veterinar, 5,298 nga sektori sanitar dhe 2,251 nga sektori fitosanitar. Inspektime në bazë të ankesave janë gjithsej 462 inspektime, mostra për inspektim janë marrë gjithsej 3,940. Certifikata për eksport sa i përket sektorit veterinar janë gjithsej 1,306, ndërsa nga sektori sanitar 8,304 certifikata.

Aktivitetet tjera si asgjësimet sipas kategorive të bazuara në sektorë janë të listuara në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 83: Aktivitetet e inspektoriatit gjatë vitit 2022**

Sektorët	Inspektime	Certifikata eksportuese	Inspektim në bazë të ankesave	Mostra	Fletëparaqitje	Asgjësimet (kg/L)	Asgjësim i kafshëve	Asgjësim i shpezëve	Asgjësim i bletëve (shoqëri)
Sanitar	5,298	-	379	142	92	1,217,440.70	-	-	-
Veterinar	6,338	1,306	83	874	86	428,825.17	183	102,880	147
Fitosanitar	2,251	8,304	-	1,019	16	249,038.00	-	-	-
Veterin. i kufirit	12,280	-	-	365	-	-	-	-	-
Fitosanitar i kufirit	41,896	-	-	1,540	-	-	-	-	-

Burimi: AUV

Aktivitetet e sektorit fitosanitar kufitar gjatë periudhës raportuese për vitin 2022, janë si në vijim.

**Tabela 84: Aktivitetet e sektorit fitosanitar kufitar**

Nr. i lëndëve-Importe	Leje importi për cigare edhe duhan	Europaleta copë	Importi			Analiza			Refuzuar				
			T/L	Masa drunore / m <sup>3</sup>	Bimë / copë	Nr. i lëndëve në analizë	Rez. negative	Rez. pozitive	Nr. i lëndëve të refuzuara	T/L	Masa drunore / m <sup>3</sup>	Bimë / copë	
45,209	36	20,004	1,163	210,897	6,615,784	1,580	-	-	17	-	-	-	2,905

Burimi: AUV

Aktivitetet e realizuara nga sektori i mikrobiologjisë së ushqimit janë gjithsej 413 mostra të pranuar, të gjitha mostrat janë futur për testim dhe janë testuar, kurse 33 mostra ishin jashtë kriterit të pranueshmërisë.

**Tabela 85: Aktivitetet e kryera nga sektori i mikrobiologjisë së ushqimit**

Mostrat	Gjithsej
Të pranuar	413
Të futura për testim	413
Të testuara	413
Jashtë kriterit të pranueshmërisë	33

Burimi: AUV

Mostrat e testuara në sektorin e kimisë ushqimore, janë gjithsej 1,009 mostra të ndara sipas llojit të matriksit për testim të cilat janë listuar në tabelën në vijim.

**Tabela 86: Mostrat e testuara në sektorin e kimisë ushqimore**

Lloji i mostrës sipas matriksit për testim	Nr. i mostrave të testuara
Drithëra, kikirik, ushqim për kafshë	314
Qumësht dhe produkte të qumështit	372
Muskul	23
Vezë	135
Mish gjedhi	65
Peshk	40
Kafe	6
Mish pule dhe produkte	7
Mjaltë	37
Vaj	1
Urinë	8
Patatina	1
<b>Gjithsej</b>	<b>1,009</b>

Burimi: AUV

Parametrat e testuar për vitin 2022 sipas aparaturave janë gjithsej 37,056, ku sipas raportit bactosan janë kryer gjithsej 18,400 testime, ndërsa milkosan 18,656 testime.

**Tabela 87: Parametrat e testuar sipas aparaturave**

Viti 2022	Raporti - sipas aparaturave			
	Bactoskan	Milkoskan	Fosomatik	Gjithsej
<b>Gjithsej</b>	18,400	18,656	-	37,056

Burimi: AUV

Sa i përket sektorit të patologjisë, mostrat e testuara janë gjithsej 170, të ndara sipas kategorive të paraqitura në tabelën në vijim.

**Tabela 88: Lloji dhe numri i analizave të sektorit të patologjisë**

Ekzaminimet në laboratorin e patologjisë	Nr. i mostrave të testuara
Ekzaminimi Anatomopatologjik Pula/Zogj pule	139
Ekzaminimi Anatomopatologjik Dhi/Keca	2
Ekzaminimi Anatomopatologjik Dele/Qengja	16
Ekzaminimi Anatomopatologjik Viq	2
Ekzaminimi Anatomopatologjik Pule deti (qura)	2
Ekzaminimi Anatomopatologjik Qen	1
Ekzaminimi Anatomopatologjik Gusa	6
Ekzaminimi Anatomopatologjik Derra të egër	2
<b>Gjithsej</b>	<b>170</b>

Burimi: AUV

Nga sektori i serologjisë dhe diagnozës molekulare gjatë vitit 2022, janë kryer mostrat si në vijim. Nga gjithsej 2,044 mostra të testuara shpërndarja ka qenë: 1,554 mostra nga tereni, 204 nga karantina, 165 nekropsi, 104 PT dhe 17 mostra nga autenticiteti.

**Tabela 89: Numri i mostrave të testuara, 2022**

<b>Ardhja e mostrave</b>	<b>Gjithsej</b>
Tereni	1,554
Karantina	204
Autenticitet	17
Nekropsi	165
PT	104
<b>Gjithsej</b>	<b>2,044</b>

Burimi: AUV

## 5.1 Emetimi i gazrave serrë

Aktivitetet njerëzore, kryesisht nëpërmjet emetimeve të gazeve serrë, kanë shkaktuar pa mëdyshje ngrohjen globale, gjë që ka nxitur ngritjen e temperaturës së sipërfaqes globale në 1.1°C periudhën 2011-2020 krahasuar me periudhën 1850-1900<sup>2</sup>. Emetimet globale të gazeve serrë kanë vazhduar të rriten në mënyrë të vazhdueshme edhe gjatë periudhës 2010–2019, dhe janë shkaktuar nga përdorimi i paqëndrueshëm i energjisë, përdorimi i tokës dhe ndryshimi i përdorimit të tokës, mënyra e jetesës, modelet e konsumit dhe prodhimit, si dhe ndryshimet që po shkaktojnë shumë ekstreme të motit dhe klimës anembanë globit. Kjo ka çuar në ndikime negative të përhapura në sigurinë e ushqimit dhe ujit, shëndetin e njeriut, në ekonomi dhe shoqëri.

Hulumtimet tregojnë se bota duhet të përgjysmojë emetimet e saj deri në vitin 2030 dhe të arrijë zero neto deri në mesin e shekullit për të parandaluar efektet më të këqija të ndryshimit të klimës. BE-ja ka reduktuar emetimet neto të gazeve serrë duke përfshirë aviacionin ndërkombëtar<sup>3</sup>, me 31% krahasuar me nivelet e vitit 1990. Në sfondin e rritjes së çmimeve të gazit natyror, viti 2022 dëshmoi një ulje prej 2% të emetimeve të gazeve serrë, e nxitur nga ulje e konsiderueshme në sektorët e ndërtesave dhe industrisë, ndërsa emetimet nga furnizimi me energji dhe transporti shënuan një rritje.

Për të arritur objektivin e reduktimit të emetimeve në vitin 2030, ritmi i reduktimeve vjetore në Evropë duhet të dyfishohet në krahasim me progresin vjetor të parë që nga viti 2005. Reduktime më të shpejta nevojiten veçanërisht për emetimet nga transporti rrugor, ndërtesat, bujqësia, mbetjet dhe industrinë e vogla. Reduktimet në konsumin e energjisë dhe rritja e energjisë së rinovueshme duhet të përshpejtohen për të arritur objektivat e vitit 2030.

<sup>2</sup> IPCC, 2023: Sections. In: Climate Change 2023: Synthesis Report. Contribution of Working Groups I, II and III to the Sixth Assessment Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change [Core Writing Team, H. Lee and J. Romero (eds.)]. IPCC, Geneva, Switzerland, pp. 35-115, doi: 10.59327/IPCC/AR6-9789291691647

<sup>3</sup> <https://www.eea.europa.eu/en>

Emetimet e gazeve serrë jo-CO<sub>2</sub> nga sektori i bujqësisë së BE-së mbulohen nga Rregullorja për ndarjen e përpjekjeve (Effort Sharing Regulation - ESR<sup>4</sup> e cila parashikon objektivat vjetore kombëtare të emetimeve që i referohen emetimeve nga të gjithë sektorët. Midis viteve 2005 dhe 2021, emetimet bujqësore pësuan një rënie të lehtë. Vlerësimet për vitin 2022 tregojnë se ky trend do të vazhdojë. Bazuar në parashikimet kombëtare, pritet një rënie modeste e nivelit të BE-së prej 4% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 2005. Nëse zbatohen masat shtesë të planifikuara aktualisht, pritet një reduktim prej 8%, duke nënvizuar nevojën për veprime të mëtejshme për të reduktuar emetimet jo-CO<sub>2</sub> në sektorin e bujqësisë.

Ligji Evropian i Klimës përcakton angazhimin e BE-së për të kaluar në një ekonomi neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050, me objektivin e ndërmjetëm për të reduktuar emetimet e gazit serrë (GHG) me të paktën 55% deri në vitin 2030. Emetimet e GS-ve bujqësore mbulohen nga Rregullorja e BE-së për Ndarjen e Përpjekjeve (ESR), e cila përcakton objektivat vjetore për çdo shtet anëtar për periudhën 2021-2030. Emetimet nga transporti, ndërtesat dhe mbetjet mbulohen gjithashtu nga objektivat kombëtare të ESR, të cilat synojnë kolektivisht të reduktojnë emetimet totale të BE-së nga sektorët e mbuluar me 30% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 2005. Emetimet e CH<sub>4</sub> nga fermentimi enterik dhe emetimet e N<sub>2</sub>O nga toka janë përgjegjëse përkatësisht për 48% dhe 31% të emetimeve totale të GS-ve bujqësore. CH<sub>4</sub> nga menaxhimi i plehut organik është burimi i tretë më i rëndësishëm i emetimeve, duke zënë rreth 17%. Burimet e mbetura japin kontribute relativisht të vogla, duke përbërë më pak se 5% të emetimeve të GS-ve bujqësore në total.

Midis 2005 dhe 2021, emetimet e GS-ve bujqësore të BE-së kanë një tendencë të përgjithshme në rënie të lehtë prej 3%, me një reduktim të mëtejshëm të vlerësuar prej 2% në 2022. Projektionet e shteteve anëtare tregojnë se emetimet e GS-ve do të mbeten rreth këtij niveli deri në vitin 2030. Bazuar në këto reduktime të parashikuara në emetimet bujqësore, Shtetet anëtare do të duhet të arrijnë reduktime shumë më të mëdha në sektorë të tjerë të ESR për të përmbushur objektivat kombëtare. Një vlerësim i ndikimit të Komisionit Evropian nënvizon sfidat në reduktimin e mëtejshëm të emetimeve të GHG jo-CO<sub>2</sub> nga bujqësia.

---

<sup>4</sup> <https://www.eea.europa.eu/en/analysis/indicators/greenhouse-gas-emissions-from-agriculture>



**Tabela 90: Emetimet bujqësore dhe emetimet e parashikuara në disa vende të BE-së**

Vendi	Ndryshimi në përqindje 2005-2021	Ndryshimi i parashikuar në përqindje 2005-2030 me masat ekzistuese	Ndryshimi i parashikuar në përqindje 2005-2030 me masa shtesë
Kroacia	-19.66	-20.82	-26.37
Greqia	-13.83	0	0
Slllovakia	-10.67	-0.7	-10.4
Franca	-9.73	-6.04	-6.04
Rumania	-9.2	4.16	1.88
Italia	-5.52	-8.84	-8.84
Gjermania	-5.52	-12.17	-18.86
Belgjika	-4.7	-8.14	-24.49

Burimi: <https://www.eea.europa.eu/en/analysis/indicators/greenhouse-gas-emissions-from-agriculture>

Sistemi i menaxhimit të gazrave serrë (GHG) menaxhohet nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në baza vjetore, ku bëhet vlerësimi i emisioneve në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse. Inventari i emisioneve<sup>5</sup>, ofron një vlerësim të sasisë së ndotësve që lirohen në ajër nga burime të ndryshme. Inventari është një nga mjetet kryesore të përdorura në menaxhimin e cilësisë së ajrit, meqë ofron informata përmes të cilave kuptojmë se cilët janë kontribuesit relativ sipas aktiviteteve dhe burimeve, duke mundësuar kështu ndërmarrjen e veprimeve efektive për të zvogëluar emetimet, si dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit në ambient.

Burimi kryesor<sup>6</sup> i emetimeve në Kosovë për ndotësit NO<sub>2</sub> dhe SO<sub>2</sub> është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM<sub>2.5</sub>, PM<sub>10</sub>, pluhurit total dhe monoksidit të karbonit (CO), burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet rezidenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO<sub>2</sub> pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla. Krahasuar me emetimet e vitit 2019, gjatë vitit 2020 është shënuar një ulje e lehtë e emetimeve për të gjithë ndotësit dhe të gjitha burimet.

Në përmbledhjen e të dhënave secila kategori thekson emetimet specifike nga praktikrat bujqësore, duke theksuar rëndësinë e metodave të qëndrueshme të bujqësisë për të reduktuar kontributet e gazrave serrë. Vlera totale e emetimeve pasqyron ndikimin kumulativ të këtyre praktikave në gjurmën e përgjithshme të karbonit në bujqësi. Në vijim, paraqitet kontributi i rëndësishëm i fermentimit enterik në menaxhimin e bagëtive dhe plehurat organik në emetimet e gazeve serrë në bujqësi në Kosovë.

<sup>5</sup> Inventari i gazrave serrë (GHG) është një listë e burimeve të emetimeve dhe emetimeve shoqëruese të përcaktuara në sasi, duke përdorur metoda të standardizuara. Organizatat e ndryshme zhvillojnë inventar të GS për një sërë arsyesh, duke përfshirë: Menaxhimin e rreziqeve të GS dhe identifikimin e mundësive të reduktimit.

<sup>6</sup> Raport vjetor për gjendjen e mjedisit 2021, botuar në Gusht 2022.

**Tabela 91: Emetimet GHG nga sektori i bujqësisë në Kosovë, 2021**

Sektori	Emetimet Gg CO <sub>2</sub> eq.
Fermentimi enterik (bagëtia)	386
Menaxhimi i plehut të shtallave	143
Përdorimi i plehut të shtallave për plehërimin e tokave	45
Përdorimi i fertilizerëve kimik për plehërimin e tokave	172
Emetimet totale nga bujqësia	746

Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Përpjekjet për të zbutur këto emetime, të tilla si përmirësimi i menaxhimit të plehut organik dhe eksplorimi i praktikave alternative të ushqimit të bagëtive, janë thelbësore për bujqësinë e qëndrueshme dhe adresimin e ndryshimeve klimatike. Për më tepër, përdorimi i plehut organik të qëndrueshëm dhe plehrave kimike duhet të menaxhohet me kujdes për të minimizuar ndikimin e tyre mjedisor.

Të dhënat e paraqitura më lartë përfaqësojnë emetimet e gazeve serrë nga praktika të ndryshme bujqësore. Këto emetime zakonisht maten në terma të ekuivalentëve të CO<sub>2</sub> (CO<sub>2</sub>e) për t'i standardizuar ato për krahasim.

**Fermentimi Enterik (bagëtia)** - Emetimet në Gg CO<sub>2</sub> eq. 386, që përfaqëson emetimet, kryesisht metanin (CH<sub>4</sub>), të krijuara gjatë proceseve të tretjes së gjedheve. Metani lirohet gjatë fermentimit enterik në stomakun e kafshëve ripërtpëse si lopët. Është një kontribues i rëndësishëm në emetimet e gazeve serrë në bujqësi, pasi metani është një gaz i fuqishëm serrë.

**Menaxhimi i plehut organik të shtallave** - Emetimet në Gg CO<sub>2</sub> eq. 143, ky numër përfaqëson emetimet, kryesisht metanin (CH<sub>4</sub>), që rrjedhin nga menaxhimi i plehut organik në shtalla. Ruajtja dhe trajtimi i plehut organik mund të çojë në emetimet e metanit, veçanërisht nëse nuk menaxhohet në mënyrë efektive.

**Përdorimi i plehut të shtallave për plehërimin e tokave** - Emetimet në Gg CO<sub>2</sub> eq. 45, kjo vlerë tregon emetimet, metanin (CH<sub>4</sub>) dhe oksidin e azotit (N<sub>2</sub>O), të lidhura me përdorimin e plehut organik si pleh tokësor. Ndërsa plehu është një burim i vlefshëm i lëndëve ushqyese për të korrat, ai mund të lëshojë gazra serrë ndërsa dekompozohet në tokë.

**Përdorimi i fertilizerëve kimik për plehërimin e tokave:** Emetimet në Gg CO<sub>2</sub> eq. 172, kjo kategori tregon emetimet e matura me njësi ekuivalente të CO<sub>2</sub> (CO<sub>2</sub>e) lidhur me përdorimin e plehrave kimike në plehërimin e tokës. Gazet specifike nuk përmenden, por emetimet e zakonshme nga përdorimi i plehrave përfshijnë oksidin e azotit (N<sub>2</sub>O). Oksidi i azotit është një gaz i fuqishëm serrë dhe çlirimin e tij nga plehurat me bazë azoti kontribuon në ndikimin mjedisor të praktikave. Strategjitë për të optimizuar përdorimin e plehrave mund të ndihmojnë në zbutjen e këtyre emetimeve

**Gjithsej emetimet nga bujqësia** - 746 njësi CO<sub>2</sub>e: paraqesin shumën e shkarkimeve nga praktikat bujqësore të listuara.

Në përmbledhje, të dhënat nxjerrin në pah kontributin e rëndësishëm të fermentimit enterik në menaxhimin e bagëtive dhe plehut organik në emetimet e gazeve serrë në bujqësi. Përpjekjet për të zbutur këto emetime, të tilla si përmirësimi i menaxhimit të plehut organik dhe eksplorimi i praktikave alternative të ushqimit të bagëtive, janë thelbësore për bujqësinë e qëndrueshme dhe adresimin e ndryshimeve klimatike. Për më tepër, përdorimi i plehut organik të qëndrueshëm dhe plehrave kimike duhet të menaxhohet me kujdes për të minimizuar ndikimin e tyre mjedisor.

Të dhënat e ofruara përfaqësojnë emetimet e vlerësuara të gazeve serrë (të matura në ekuivalent të CO<sub>2</sub> ose CO<sub>2</sub>e), që rezultojnë nga praktikat specifike bujqësore. Këto emetime kontribuojnë në ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike.

## **6 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural**

### **6.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2022 ka vazhduar të mbështes sektorin e bujqësisë bazuar në dy programet e hartuara: Programin e Pagesave Direkte dhe Programin e Zhvillimit Rural.

Përmes Programit të Pagesave Direkte janë realizuar mbështetje mbi bazën e njësisive varësisht sektorëve:

- Mbështetja për kultura bujqësore është realizuar në bazë të hektarëve të kultivuar, përveç mjedrës e cila është subvencionuar në bazë të sasisë dhe grurit i cili ka pasur subvencionim të dyfishtë edhe në bazë të sasisë edhe në bazë të hektarëve të kultivuar. Gjithashtu prodhimi i verës është subvencionuar për litër;
- Mbështetja për krerë blegtoral (mbështetja bëhet për krerë/copë ndërsa tek qumështi për litër në bazë të kategorisë së cilësisë, si dhe mbështetja për akuakulturë që është realizuar për kg);
- Mbështetja për inpute ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022 ku janë mbështetur fidanet për pemët drufrutore dhe fidanet për hardhi të rrushit. Gjithashtu për herë të parë në vitin 2022 është bërë subvencionimi i pjesshëm i çmimit të naftës për kulturat bujqësore (150 litra për ha me çmim 0.36 €/litër) si dhe subvencionimi i plehut artificial të përdorur për grurë (150 €/ha) dhe misër, patate dhe fasule monokulturë (100 €/ha);
- Mbështetja për sigurim bujqësor për mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec, arrë, fasule, misër, qershi, vishnje dhe dardhë.

Përmes granteve janë mbështetur investimet në sektorin primar, por edhe në industrinë përpunuese si dhe diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit. Gjithashtu është mbështetur edhe përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasje Leader.

Në vitin 2022 pjesë e programit të pagesave direkte kanë qenë sektorët e paraqitur në tabelën e mëposhtme së bashku me detajet e pagesave për njësi të subvencionuar.

**Tabela 92: Pagesat direkte për njësi, PPD 2022**


	Subvencionimi për njësi	Subvencionimi për naftë
Grurë	150 €/ha	0.36 €/litër
	0.03 €/kg	
	150 €/ha pleh	
Farë gruri	250 €/ha	
Elb	150 €/ha	
Thekër	150 €/ha	
Tërshërë	150 €/ha	
Misër	175 €/ha	
	100 €/ha pleh	
Luledielli	170 €/ha	
Vreshta ekzistuese	1,000 €/ha	
Pemishte ekzistuese	450 €/ha	
Mjedër	0.15 €/kg	
Perime	500 €/ha-fushë të hapur	
	850 €/ha- serra	
	150 €/ha kungull dhe kungull misiri	
	100 €/ha pleh (patate dhe fasule monokulturë)	
Bimë mjekësore dhe aromatike	450 €/ha	
Bujqësi organike	+50 €/ha	
Fidanë	0.25 €/copë (pemë drufrutore)	
	0.20 €/copë (pemë drufrutore)	
	0.15 €/copë (hardhi rrushi)	
Verë	0.04 €/litër	
Lopë dhe buallica qumështore	90 €/krerë	
Dele	25 €/krerë	
Dhi	25 €/krerë	
Bletë	20 € - (25 € organike)/koshere	
Qumësht	0.07 €/litër- Klasa ekstra	
	0.04 €/litër- Klasa I	
	0.02 €/litër- Klasa II	
Pula vojse	0.50 €/pulë vojse	
	0.40 €/pulë vojse	
Dosa	25 €/krerë	
Therje të raportuara të gjedhit	50 €/krerë	
Akuakulturë	0.20 €/kg	
Primi i sigurimit bujqësor	75% e primit të sigurimit	
Viça për majmëri	25 €/krerë	

Burimi: Programi për Pagesa Direkte 2022

## 6.2 Pagesat Direkte/Subvencionet

Në vitin 2022 për mbështetje përmes Programit të Pagesave Direkte aplikuan gjithsej 28,981 fermerë. Nga gjithsej numri i aplikuesve, përfitues nga ky program u shpallën 28,344 fermerë (98%), ndërsa u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë dokumentacioni 637 fermerë (2%). Në raport me vitin 2021 numri i të refuzuarve është për 1 pikë % më i ulët.


Figura 33: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2022



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2022, gjithsej 57.5 mil. € ishte buxheti total i shpenzuar për Programin e Pagesave Direkte, që në raport me vitin 2021 mbështetja pothuajse është dyfishuar.

Figura 34: Pagesat direkte 2018-2022, në 1000 €




Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Viti 2022, ishte vit në të cilin Pagesat Direkte për njësi u rritën në krahasim me periudhën paraprake e gjithashtu u subvencionua edhe nafta dhe plehu. Rritje kishte në pjesën më të madhe të sektorëve më përjashtim të kungullit dhe kungullit të misirit ku pagesa për hektar u zvogëluar. Pagesat direkte për njësi nuk pësuan ndryshime në këto raste: akuakulturë, pula vojse, primi i sigurimit, vera, bujqësi organike dhe therjet e raportuara, ndërsa tek vreshta në vitin 2022 nuk kishte përshkallëzim të pagesave.

Rritja e pagesave për njësi ndryshoi, ku rritje më e madhe ishte për grurin për ha me 372% rritje, pasuar nga viçat me 150%, misri me 119% dhe për kulturat apo sektorët e tjerë ku rritja varioi nga 6% deri në 81%. Ndryshimi në pagesat për njësi prezantohet në figurat në vijim:

Figura 35: Rritja e pagesave direkte për njësi në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

**Tabela 93: Pagesat direkte 2018-2022, në €**


	2018	2019	2020*	2021	2022
Grurë	6,550,929	5,292,996	14,079,396	3,287,048	19,586,752
Farë gruri	114,204	140,395	434,540	131,913	48,895
Misër	3,227,784	4,122,464	8,547,885	2,840,082	11,803,368
Elb	77,688	73,194	132,645	308,040	153,708
Thekër	29,343	29,423	58,623	79,845	84,152
Tërshërë	-	139,161	396,261	249,689	345,727
Luledielli	749	14,621	12,036	2,946	10,192
Vreshta ekzistuese	2,580,250	2,988,810	6,160,400	2,520,246	2,870,896
Perime	2,693,021	2,488,506	5,525,712	2,764,378	3,620,710
Pemishte ekzistuese	1,905,548	1,656,812	3,805,736	1,814,448	2,526,360
Mjedra	-	71,883	168,854	103,766	172,987
Verë	190,774	389,375	228,452	731,900	308,089
Bimë mjekësore dhe aromatike	-	-	111,479	26,933	19,601
Bujqësi organike	277,578	524,900	1,672,210	81,150	89,469
Lopë qumështore	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535	4,727,430
Buallica	-	17,920	48,580	2,635	2,340
Dele dhe dhi	2,298,615	2,411,520	5,129,550	2,995,680	3,544,800
Bletë	2,471,085	3,070,950	6,996,810	2,888,265	3,811,735
Pula Vojse	484,343	537,497	1,165,861	500,676	399,161
Thëllëza	18,280	14,044	23,678	8,123	-
Dosa	27,320	28,100	75,080	20,840	22,375
Qumësht	1,736,944	2,041,145	4,906,204	2,358,351	2,840,801
Therje të raportuara të gjedhit	48,900	48,550	70,600	35,050	56,100
Akuakulturë	86,068	89,598	154,010	110,314	152,602
Viça	-	-	-	79,380	193,300
Fidanë	82,046	69,600	155,495	92,477	133,464
Primi i sigurimit bujqësor	-	-	1,769	170	1,775
<b>Gjithsej</b>	<b>29,648,239</b>	<b>30,634,922</b>	<b>69,483,164</b>	<b>28,927,879</b>	<b>57,526,788</b>

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; \*Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Sektorët për të cilët është shpenzuar pjesa më e madhe e buxhetit në vitin 2022 (75.5% e buxhetit total) janë: gruri, misri, lopët qumështore, bletët dhe perimet ndërsa pjesa tjetër prej 25% është shpenzuar në sektorët e tjerë të paraqitur në figurën e mëposhtme.




**Figura 36: Pagesat direkte sipas sektorëve 2022, në mil. €**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej numri i aplikuesve prej 28,981 fermerë, në vitin 2022, 95% (27,646) ishin aplikues meshkuj dhe 5% (1,335) aplikues femra.


**Figura 37: Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej numri i aplikuesve femra, 97% përfituan nga PPD 2022 dhe vetëm 3% u refuzuan. Situatë e ngjashme ishte edhe me aplikuesit meshkuj me ndryshim të vogël prej 1 pikë % në krahasim me femrat, pra 98% përfituan dhe 2% u refuzuan.

**Figura 38: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas gjinisë në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sikurse përqindja e pjesëmarrjes, ashtu edhe përqindja e shumës së pagesave të realizuara në vitin 2022 për femra ishte 5% (2.9 mil. €) dhe për meshkuj 95% (54.6 mil. €) nga gjithsej buxheti i shpenzuar prej 57.5 mil. €. Përqindja ishte e ndryshme varësisht nga sektori dhe detajet mund të shihen në tabelën e mëposhtme.


**Tabela 94: Pagesat direkte sipas gjinisë në vitin 2022, në €**

	Femër	Mashkull	% e pjesëmarrjes së femrave	% e pjesëmarrjes së meshkujve
Grurë	587,232	18,999,521	3	97
Farë gruri	-	48,895	-	100
Misër	427,825	11,375,543	4	96
Elb	3,417	150,291	2	98
Thekër	2,038	82,114	2	98
Tërshëre	11,138	334,589	3	97
Luledielli	-	10,192	-	100
Vreshta ekzistuese	40,705	2,830,190	1	99
Perime	141,578	3,479,132	4	96
Pemishte ekzistuese	272,664	2,253,696	11	89
Mjedra	11,704	161,282	7	93
Verë	81,473	226,616	26	74
Bimë mjekësore dhe aromatike	3,730	15,871	19	81
Bujqësi organike	11,725	77,744	13	87
Lopë qumështore	287,910	4,439,520	6	94
Buallica	-	2,340	-	100
Dele dhe dhi	202,875	3,341,925	6	94
Bletë	431,575	3,380,160	11	89
Pula Vojse	35,070	364,091	9	91
Dosa	-	22,375	-	100
Qumësht	313,344	2,527,457	11	89
Therje të raportuara të gjedhit	1,050	55,050	2	98
Akuakulturë	5,545	147,057	4	96
Viça	14,975	178,325	8	92
Fidane	10,862	122,602	8	92
Primi i sigurimit bujqësor	-	1,775	-	100
<b>Gjithsej</b>	<b>2,898,434</b>	<b>54,628,354</b>	<b>5</b>	<b>95</b>

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Përqindja e pjesëmarrjes së personave fizik në gjithsej numrin e aplikuesve në vitin 2022, ishte 98% dhe vetëm 2% aplikuan si persona juridik. Përqindja e atyre që përfituan tek personat fizik është 98%, ndërsa tek personat juridik 96%, pra përqindja e të refuzuarve tek personat juridik është për 2 pikë % me e lartë sesa tek personat fizik.

**Figura 39: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas tipit të fermerit në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


Nga gjithsej 57.53 mil. € sa është buxheti total i shpenzuar për Pagesa Direkte në vitin 2022, 90% (51.86 mil. €) janë bërë pagesa tek personat fizik dhe vetëm 10% (5.67 mil. €) tek personat juridik.

**Tabela 95: Pagesat direkte sipas tipit të fermerit në vitin 2022, në €**

	Fizik	Juridik	% e pjesëmarrjes fizik	% e pjesëmarrjes juridik
Grurë	18,696,975	889,777	95	5
Farë gruri	3,192	45,703	7	93
Misër	11,144,766	658,602	94	6
Elb	147,798	5,910	96	4
Thekër	70,137	14,015	83	17
Tërshëre	328,538	17,189	95	5
Luledielli	2,128	8,064	21	79
Vreshta ekzistuese	2,021,540	849,355	70	30
Perime	3,468,401	152,309	96	4
Pemishte ekzistuese	2,114,315	412,045	84	16
Mjedra	165,374	7,612	96	4
Verë	-	308,089	-	100
Bimë mjekësore dhe aromatike	17,227	2,374	88	12
Bujqësi organike	50,083	39,387	56	44
Lopë qumështore	4,379,490	347,940	93	7
Buallica	2,340	-	100	-
Dele dhe dhi	3,465,175	79,625	98	2
Bletë	3,507,455	304,280	92	8
Pula Vojse	3,950	395,211	1	99
Dosa	22,375	-	100	-
Qumësht	2,062,828	777,973	73	27
Therje të raportuara të gjedhit	8,500	47,600	15	85
Akuakulturë	-	152,602	-	100
Viça	169,450	23,850	88	12
Fidane	1,550	131,914	1	99
Primi i sigurimit bujqësor	1,775	-	100	-
<b>Gjithsej</b>	<b>51,855,363</b>	<b>5,671,425</b>	<b>90</b>	<b>10</b>

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në skemën e mëposhtme është i paraqitur numri i njësive të subvencionuara përmes pagesave direkte në vitin 2022.



### 6.2.1 Pagesat Direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor

Në vitin 2022, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore ishte 41.6 mil. €, ku pjesëmarrje më të madhe në gjithsej pagesat direkte për kultura bujqësore kishin: gruri (47%), misri (28%), perimet (9%), vreshtat (7%) dhe pemishtet ekzistuese (6%), ndërsa kategoritë e tjera marrin pjesë me 3% në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore.

Gruri edhe në vitin 2022 ka vazhduar të subvencionohet edhe për sipërfaqe (ha) edhe për sasi (kg). Numri i aplikuesve për sasi të grurit ka vazhduar të jetë dukshëm më i vogël sesa për sipërfaqe të grurit. Nga gjithsej shuma e pagesave direkte të paguara për grurë (19.6 mil. €), 17.7 mil. € janë paguar për sipërfaqe duke përfshirë pagesat për pleh (7.5 mil. €) dhe pagesat për naftë (2.7 mil. €) dhe vetëm 1.9 mil. € për sasi të grurit.

Nga gjithsej mbështetja për perime prej 3.6 mil. €, 181 mijë € apo 5% janë për perime në serra, ndërsa pjesa tjetër për perime në fushë të hapur. Sa i përket kulturave perimore në fushë të hapur, ato që përbëjnë 95% të gjithsej shumës së pagesave direkte për perime janë: patatja (31%), speci (21%), lakra (9%), shalqiri (8%), fasulja monokulturë (7%), qepë dhe kunguj (6% secila), pjepër dhe kungull misiri (4% secila), ndërsa të gjitha perimet e tjera në fushë të hapur kanë pjesëmarrje prej 4%.

Tek mbështetja e vreshtave pas një përshkallëzimi të pagesës të bërë në vitin 2021 varësisht numrit të hektarëve për të cilët aplikohet, në vitin 2022 ishte pagesa fikse për ha në vlerë prej 1,000 €.

Nga gjithsej shuma prej 2.5 mil. € që u pagua për pemishte, kulturat pemëtare që kanë pjesëmarrje më të madhe në këtë total janë: arra (31%), molla (30%), kumbulla (17%), lajthia

(7%), dardha (4%) dhe vishnja (3%). Të gjitha këto kultura të cekura përbëjnë 92% të gjithsej mbështetjes për pemishte, ndërsa pjesa tjetër prej 8% është e shpërndarë tek kulturat tjera pemëtare.

Në kuadër të bujqësisë organike nga gjithsej shuma e paguar prej 89.5 mijë €, 77% ka qenë për bimë mjekësore aromatike organike, 22% për elb, thekër, tërshërë, misër dhe luledielli dhe 1% për perime në fushë të hapur. Tek kulturat e tjera për të cilat me program është planifikuar mbështetje nëse kultivohen si organike si për: grurë, pemishte dhe perime në serra nuk ka pasur asnjë përfitues.

**Tabela 96: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2018-2022**


		2018	2019	2020*	2021	2022
<b>Grurë (ha)</b>	Numri i aplikuesve	10,683	8,872	11,044	6,862	11,331
	Numri i përfituesve	10,311	8,698	10,729	6,553	11,130
	Numri i ha të paguar	43,673	35,287	46,931	27,860	49,893
	Pagesa për ha	150	150	300	75	354
	Shuma totale e paguar	6,550,929	5,292,996	14,079,396	2,089,499	17,661,357
<b>Grurë (kg)</b>	Numri i aplikuesve	-	-	-	3,801	3,555
	Numri i përfituesve	-	-	-	3,550	3,555
	Numri i kg të paguar	-	-	-	63,028,896	64,179,802
	Pagesa për kg	-	-	-	0.019	0.03
	Shuma totale e paguar	-	-	-	1,197,549	1,925,395
<b>Farë gruri</b>	Numri i aplikuesve	11	15	25	16	3
	Numri i përfituesve	11	15	24	14	3
	Numri i ha të paguar	458	562	869	528	161
	Pagesa për ha	250	250	500	250	304
	Shuma totale e paguar	114,204	140,395	434,540	131,913	48,895
<b>Misër</b>	Numri i aplikuesve	8,432	9,526	10,020	7,510	11,331
	Numri i përfituesve	8,165	9,370	9,808	7,224	11,651
	Numri i ha të paguar	21,519	27,483	28,493	18,934	35,876
	Pagesa për ha	150	150	300	150	329
	Shuma totale e paguar	3,227,784	4,122,464	8,547,885	2,840,082	11,803,368
<b>Elb</b>	Numri i aplikuesve	316	273	242	856	455
	Numri i përfituesve	306	267	233	820	437
	Numri i ha të paguar	518	488	442	2,054	753
	Pagesa për ha	150	150	300	150	204
	Shuma totale e paguar	77,688	73,194	132,645	308,040	153,708
<b>Thekër</b>	Numri i aplikuesve	83	70	59	182	131
	Numri i përfituesve	72	67	56	173	124
	Numri i ha të paguar	196	196	195	532	413
	Pagesa për ha	150	150	300	150	204
	Shuma totale e paguar	29,343	29,423	58,623	79,845	84,152
<b>Tërshërë</b>	Numri i aplikuesve	-	505	569	746	876
	Numri i përfituesve	-	485	538	706	829
	Numri i ha të paguar	-	928	1,321	1,665	1,695
	Pagesa për ha	-	150	300	150	204
	Shuma totale e paguar	-	139,161	396,261	249,689	345,727

<b>Vreshta</b>	Numri i aplikuesve	3,012	2,939	2,919	2,848	2,722
	Numri i përfituesve	2,949	2,900	2,880	2,826	2,694
	Numri i ha të paguar	2,580	2,989	3,080	3,039	2,724
	Pagesa për ha	1,000	1,000	2,000	1,000/700 500/400	1,054
	Shuma totale e paguar	2,580,250	2,988,810	6,160,400	2,520,246	2,870,896
<b>Luledielli</b>	Numri i aplikuesve	5	11	5	6	7
	Numri i përfituesve	4	11	3	6	4
	Numri i ha të paguar	5	97	40	20	46
	Pagesa për ha	150	150	300	150	224
	Shuma totale e paguar	749	14,621	12,036	2,946	10,192
<b>Perime</b>	Numri i aplikuesve	6,664	7,270	4,676	3,917	4,333
	Numri i përfituesve	6,435	7,099	4,481	3,802	4,155
	Numri i ha të paguar	8,977	8,295	9,210	6,870	7,014
	Pagesa për ha	300	300	600	400/500	204/554/ 654/904
	Shuma totale e paguar	2,693,021	2,488,506	5,525,712	2,764,378	3,620,710
<b>Pemishte ekzistuese</b>	Numri i aplikuesve	5,278	3,557	3,166	2,929	3,396
	Numri i përfituesve	5,097	3,488	3,034	2,774	3,251
	Numri i ha të paguar	4,764	4,142	4,757	4,536	5,013
	Pagesa për ha	400	400	800	400	504
	Shuma totale e paguar	1,905,548	1,656,812	3,805,736	1,814,448	2,526,360
<b>Bujqësi organike</b>	Numri i aplikuesve	37	27	48	35	20
	Numri i përfituesve	24	26	38	11	9
	Numri i ha të paguar	443	1,050	1,672	197	198
	Pagesa për ha	+500	500	1,000	125/200 450/500	+50***
	Shuma totale e paguar	277,578	524,900	1,672,210	81,150	89,469
<b>Bimë mjekësore dhe aromatike</b>	Numri i aplikuesve	-	-	84	62	78
	Numri i përfituesve	-	-	70	56	54
	Numri i ha të paguar	-	-	248	60	39
	Pagesa për ha	-	-	450	450	504
	Shuma totale e paguar	-	-	111,479	26,933	19,601
<b>Verë**</b>	Numri i aplikuesve	16	15	18	17	18
	Numri i përfituesve	14	15	17	17	17
	Numri i litrave të paguara	4,769,358	9,734,385	5,711,290	9,148,751	7,702,215
	Pagesa për litër	0.04	0.04	0.04	0.08	0.04
	Shuma totale e paguar	190,774	389,375	228,452	731,900	308,089
<b>Mjedër</b>	Numri i aplikuesve	-	967	525	376	557
	Numri i përfituesve	-	594	386	320	365
	Numri i kg të paguara	-	898,547	1,055,337	864,717	1,153,245
	Pagesa për kg	-	0.08	0.16	0.12	0.15
	Shuma totale e paguar	-	71,883	168,854	103,766	172,987

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; \*Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; \*\*Pagesa për njësi për verë në vitin 2021 ka qenë e planifikuar 0.04 €/litër ndërsa pagesa është realizuar 0.08 €/litër sepse dyfishimi i pagesës për njësi në kuadër të PRE-së nuk është aplikuar për verë në vitin 2020; \*\*\*Subvencionimi për bujqësi organike është bërë me 50 € shtesë mbi pagesën bazë për njësi të kulturave jo organike.

Me shumën mesatare më të lartë të subvencionit për përfitues kanë qenë përfituesit për verë me një mesatare rreth 18 mijë €, pasuar nga përfituesit për farë gruri me rreth 16 mijë €, për bujqësi organike me rreth 10 mijë €, pasuar nga luledielli, gruri, vreshtat dhe misri që kishin mesatare nën 3 mijë €, dhe kulturat e tjera të paraqitura në figurën e mëposhtme ku mesatarja për përfitues ishte nën 1 mijë €.


**Figura 40: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në shumicën e rasteve ishte nën 5 ha, më përjashtim të lulediellit, farës së grurit dhe bujqësisë organike, ku sipërfaqja mesatare e subvencionuar ishte e lartë sepse numri i përfituesve ishte i vogël.

**Figura 41: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## Primi i sigurimit bujqësor

Në vitin 2022 MBPZhR vazhdoi subvencionimin e primit duke mbuluar 75% të pagesës së polisës së sigurimit (primit). Përveç kulturave, primi i të cilave u subvencionua në vitin 2021 lista e kulturave të sigurimit indeks u zgjerua për të përfshirë të gjitha kulturat në vijim: mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec, arrë, fasule, misër, qershi, vishnje dhe dardhë. Ndërsa tek sigurimi tradicional ishin të përfshira: molla, speci dhe rrushi i verës.

Për të përfituar subvencionim të primit, fermerët fillimisht duhet të blejnë polisën e sigurimit dhe të paguajnë çmimin e plotë të polisës e pastaj të aplikojnë për kompensim të kostos së polisën në vlerë 75% të primit që kanë paguar.

Në kuadër të kësaj mase në vitin 2022 kanë përfituar 9 fermerë. Shuma totale e pagesave direkte për primin e sigurimit ishte 1,775 € apo një mesatare prej 197 €. Shuma minimale e paguar në kuadër të pagesave direkte për subvencionim të primit ishte 58 € dhe maksimalja 509 €. Përkundër përqindjes së lartë të subvencionimit të primit, numri i aplikuesve dhe përfituesve vazhdon të mbetet i ulët sepse ende fermerët nuk janë mjaftueshëm të vetëdijësuar se sigurimi bujqësor është një metodë shumë e mirë për sigurimin e vazhdimësisë së biznesit dhe zbutjen e humbjeve nga dëmet e shkaktuara.

### 6.2.2 Pagesat Direkte për blegtori dhe qumësht

Shuma e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë në vitin 2022 ishte 15.8 mil. €, 13.4% më e lartë sesa në vitin 2021. Nga gjithsej pagesat direkte për blegtori, 30% ishin për lopë qumështore, 24% për bletari, 23% për delet dhe dhitë, 18% për qumësht sipas cilësisë dhe 5% për kategoritë tjera të subvencionimit. Në vitin 2022, pjesëmarrja e pagesave direkte për blegtori në totalin e pagesave direkte është 27%.

**Tabela 97: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2018-2022**

		2018	2019	2020	2021	2022
<b>Lopë qumështore</b>	Numri i aplikuesve	7,595	6,775	7,027	6,210	5,773
	Numri i përfituesve	7,395	6,606	6,905	6,105	5,589
	Numri i krerëve të paguar	67,811	62,478	67,295	57,571	52,527
	Pagesa për krerë	70	70	140	85	90
	Shuma totale e paguar	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535	4,727,430
<b>Buallica</b>	Numri i aplikuesve	-	6	5	5	4
	Numri i përfituesve	-	6	4	4	4
	Numri i krerëve të paguar	-	256	347	31	26
	Pagesa për krerë	-	70	140	85	90
	Shuma totale e paguar	-	17,920	48,580	2,635	2,340
<b>Dele dhe dhi</b>	Numri i aplikuesve	1,436	1,380	1,515	1,379	1,334
	Numri i përfituesve	1,378	1,355	1,469	1,329	1,296
	Numri i krerëve të paguar	153,241	160,768	170,985	149,784	141,792
	Pagesa për krerë	15	15	30	20	25
	Shuma totale e paguar	2,298,615	2,411,520	5,129,550	2,995,680	3,544,800




<b>Dosa</b>	Numri i aplikuesve	210	216	251	158	140
	Numri i përfituesve	202	211	235	133	116
	Numri i krerëve të paguar	1,366	1,405	1,877	1,042	895
	Pagesa për krerë	20	20	40	20	25
	Shuma totale e paguar	27,320	28,100	75,080	20,840	22,375
<b>Bletë</b>	Numri i aplikuesve	3,007	3,411	3,941	3,373	3,098
	Numri i përfituesve	2,764	3,238	3,634	3,133	3,016
	Numri i koshereve të paguara	164,739	204,730	233,227	192,551	190,579
	Pagesa për koshere	15	15	30	15	20/25
	Shuma totale e paguar	2,471,085	3,070,950	6,996,810	2,888,265	3,811,735
<b>Pula vojse</b>	Numri i aplikuesve	88	85	84	94	80
	Numri i përfituesve	81	82	84	77	73
	Numri i pulave vojse të paguara	1,023,671	1,181,829	1,310,235	1,120,349	871,909
	Pagesa për pulë vojse	0.50/0.40	0.50/0.40	1.00/ 0.80	0.50/ 0.40	0.50/ 0.40
	Shuma totale e paguar	484,343	537,497	1,165,861	500,676	399,161
<b>Thëllëza</b>	Numri i aplikuesve	13	13	11	12	-
	Numri i përfituesve	13	9	10	11	-
	Numri i thëllëzave të paguara	36,560	28,088	23,678	16,245	-
	Pagesa për thëllëzë	0.50	0.50	1.00	0.50	-
	Shuma totale e paguar	18,280	14,044	23,678	8,123	-
<b>Qumësht</b>	Numri i aplikuesve	3,116	1,836	1,282	1,197	1,314
	Numri i përfituesve	3,055	1,798	1,245	1,149	1,286
	Numri i litrave të paguara	34,522,414	38,664,480	47,515,642	44,835,136	46,183,417
	Pagesa për litër	0.06/0.04/ 0.02	0.06/0.04/ 0.02	0.12/ 0.08/ 0.04	0.06/ 0.04/ 0.02	0.07/0.04/ 0.02
	Shuma totale e paguar	1,736,944	2,041,145	4,906,204	2,358,351	2,840,801
<b>Therje të raportuar të gjedhit</b>	Numri i aplikuesve	28	14	12	8	11
	Numri i përfituesve	24	13	9	7	11
	Numri i krerëve të paguar	978	971	706	701	1,122
	Pagesa për krerë	50	50	100	50	50
	Shuma totale e paguar	48,900	48,550	70,600	35,050	56,100
<b>Akuakulturë</b>	Numri i aplikuesve	8	8	4	4	5
	Numri i përfituesve	5	8	4	4	5
	Numri i kg të paguar	430,341	447,990	385,024	551,571	763,008
	Pagesa për kg	0.20	0.20	0.40	0.20	0.25
	Shuma totale e paguar	86,068	89,598	154,010	110,314	152,602
<b>Viça për majmëri</b>	Numri i aplikuesve	-	-	-	744	460
	Numri i përfituesve	-	-	-	462	395
	Numri i krerëve të paguar	-	-	-	7,938	7,732
	Pagesa për krerë	-	-	-	10	25
	Shuma totale e paguar	-	-	-	79,380	193,300

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; \*Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Të dhënat e paraqitura për vitin 2020 për Qumësht, Therje të raportuara të gjedhit dhe Akuakulturë ndryshojnë nga RGJ 2021 sepse janë përfshirë edhe pagesat e realizuara për gjashtë mujorin e dytë 2020.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur shuma mesatare e subvencioneve për një përfitues, ku shihet se mesatare më të lartë kishin përfituesit për akuakulturë me 30.5 mijë €, pasuar nga përfituesit për pula vojse me 5.5 mijë €, për therje të raportuara të gjedhit 5.1 mijë €, ndërsa mesatare më të ulët për përfitues, përkatësisht nën 5,000 € kishin përfituesit e deleve dhe dhive, qumështit, bletëve, lopëve qumështore, buallicave, viçave për majmëri dhe dosave.


**Figura 42: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues është e paraqitur në figurën e mëposhtme ku shihet se sa i përket krerëve mesatare më e lartë është në rastin e deleve dhe dhive, pasuar nga therjet e raportuara të gjedhit, bletët, viçat për majmëri, lopët qumështore, dosat dhe buallicat.

**Figura 43: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2022**



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## 6.2.3 Mbështetja e inpueteve në bujqësi

### Mbështetja e fidanëve

Gjithsej shuma e pagesave direkte për fidanë në vitin 2022 ishte rreth 133 mijë €, krahasuar me vitin 2021 është rritur për 44%, kjo për shkak të rritjes së pagesës për njësi. Numri më i madh i fidanëve të subvencionuar është në regjionet: Ferizaj (34%), Gjakovë (25%), Pejë (22%) dhe Gjilani (19%), ndërsa në regjionet e tjera nuk ka pasur fare aplikues.

Janë subvencionuar prodhuesit e fidaneve të pemëve drufrutore me nga 0.25 €/fidan për 40,000 fidanët e parë (duke filluar nga minimum prej 5,000 copë), me nga 0.20 €/fidan për çdo fidan mbi këtë numër si dhe prodhuesit e fidanëve të hardhisë së rrushit me nga 0.15 €/fidan për çdo fidanë mbi 5,000 copë.

Mesatarja e fidanëve për të cilat një fermer ka përfituar ishte rreth 33 mijë fidanë, më e ulëta ishte në regjionin e Gjilanit (22 mijë fidanë), ndërsa më e larta në regjion të Gjakovës (48 mijë fidanë).

**Tabela 98: Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2022**

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr. i fidaneve të subvencionuara	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	-	-	-	-
2	Prizren	-	-	-	-
3	Pejë	3	3	133,449	32,102
4	Mitrovicë	-	-	-	-
5	Gjakovë	4	3	145,500	24,355
6	Ferizaj	7	7	203,253	50,813
7	Gjilan	5	5	110,246	26,193
	<b>Gjithsej</b>	<b>19</b>	<b>18</b>	<b>592,448</b>	<b>133,464</b>

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

### Mbështetja për naftë

Në vitin 2022 përmes Programit të Pagesave Direkte çdo aplikues i cili përfitoi subvencion për sipërfaqe të tokës së mbjellur/kultivuar me kultura bujqësore u subvencionua edhe për naftë me nga 0.36 €/litër për sasinë maksimale prej 150 litrave për hektar. Në total në vitin 2022 u paguan 5.6 mil. € për subvencionim të naftës.

### Mbështetja për pleh

Subvencionim për pleh të përdorur gjatë kultivimit të kulturave bujqësore përfituan të gjithë fermerët të cilët përfituan subvencione për sipërfaqe të mbjellura/kultivuara me grurë, misër, patate dhe fasule monokulturë. Vlera e subvencioneve për pleh ishte 150 €/ha për grurë dhe 100 €/ha për misër, patate dhe fasule monokulturë.

## 6.3 Agro Kreditë dhe fondi garantues

### 6.3.1 Agro Kreditë

Kreditimi në bujqësi është nevojë për ta lehtësuar më tej financimin për fermerët dhe përpunuesit tanë. Përmes kredive bujqësore financohen aktivitetet e bujqve. Zhvillimi i sektorit bujqësor në Kosovë ka nevojë për financim alternativ edhe pse mbështetet vazhdimisht nga ana e ministrisë me grante dhe subvencione. Ka numër të vogël të fermerëve që kanë burime të kursyera për të investuar dhe zgjidhja është kreditimi.

Qasja e ulët në financimin e përgjithshëm Bankar në bujqësi me vetëm 2.5% për vitin 2022 (apo 0.4 pikë përqindje më i lartë se viti paraprak), sektor që më së paku është kredituar nga institucionet financiare në Kosovë, ndërsa te Institucionet Mikrofinanciare (IMF) gjendja është më e volitshme, pjesëmarrja e agrokredive është 19.3% për vitin 2022.

Agro kreditë njihen si kredi joperformuese me ç'rast kreditimi ka një kosto të lartë për bankat dhe institucionet mikrofinanciare. Niveli i ulët i kreditimit tregon qasjen konservatore të sistemit bankar kundrejt sektorit të bujqësisë. Në mungesë të një sistemi adekuat sigurimi në bujqësi, vështirësohet qasja e fermerëve për kredi, respektivisht në kredi të volitshme. Mbështetje të rëndësishme financiare për garanci kreditore në bujqësi kanë dhënë USAID-MBPZHR dhe FKGK. Fondi i Garancisë synon që fermerët, nëpërmjet kredive të ofruara me kriterë më favorizuese, të mbulojnë një pjesë të riskut të mbetur të financimit (rreth 50%), që nuk mbulohet me grantet e përfituara. Pra, me më pak kolateral dhe normë interesi më të ulët për sektorin bujqësor, blegtoral, agrobiznesin dhe agropërpunimin.

Me qëllim të shtimit të efektivitetit në fermë, fermerët kanë nevojë të zgjerojnë më shumë nivelin e financimit të investimeve të tyre në: rritjen e fondit të bagëtitve, stalla e ferma blegtorale me standarde evropiane, shtim sipërfaqesh të mbjella, investime në mekanizëm bujqësor, në serra, në energji të rinovueshme, blerje të inventarit, blerje të inpueteve, krijimi i pikave grumbulluese, depo-frigo ruajtëse, fabrika përpunimi agro ushqimore, investime në kantina dhe vreshta, subjekte agroturistike, etj. Investimet e tilla në fermë, u mundësojnë fermerëve rritjen e produktivitetit dhe njëkohësisht përgatitjen për sezonin e ri bujqësor. Po ashtu, mundësohet përmirësimi i mirëqenies në zonat rurale, shtimi i prodhimit vendor që ndikon në zëvendësimin e produkteve të importit, krijimin e mundësive për eksport si dhe në krijimin dhe mbajtjen e fuqisë së re punëtore.

Bankat që mbështesin financiarisht me kredi sektorin e bujqësisë në Kosovë janë: Banka për Biznes, Banka Ekonomike, Raiffeisen Bank (RBKO), Procredit Bank (PCB), TEB Bank, NLB Prishtina dhe Banka Kombëtare Tregtare (BKT), ndërsa Institucionet Mikrofinanciare janë: Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), Finca, Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK), KEP Trust, KGMAMF, KosInvest World Vision (WVI), Qelim dhe Start Finance.

Lider në shumën e Agrokredive të disbursuara është TEB, BKT, PCB dhe BPB, pasuar nga IMF-të: KRK, Finca, AFK dhe KEP. Në tabelë shihet se më së shumti kredi janë disbursuar në vitin

2019 me shumë totale mbi 115 mil. €. Numri i kredive të dhëna që nga viti 2018 deri në vitin 2022 është mbi 109 mijë kredi me një shumë totale prej 496.8 mil. €. Pra, për këto 5 vite, i bie që çdo muaj janë disbursuar mesatarisht rreth 1,824 kredi, me shumë mesatare mujore prej 8.3 mil. €.


**Tabela 99: Agro kreditë 2018 - 2022**

Agro Kredi 2018 - 2022	Numri i kredive të disbursuara	Shuma totale e kredive të disbursuara (mn €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në krahasim me kreditë tjera (%)
2018	26,403	91.3	12 - 39	6.0 - 28.5	1.3 - 64.5
2019	21,622	115.1	18 - 42	6.4 - 28.4	0.7 - 43.5
2020	22,958	83.2	18 - 40	5.3 - 28.6	0.5 - 36.7
2021	18,477	98.9	18 - 41.5	5.2 - 24	0.4 - 33
2022	19,962	108.3	18 - 41.9	5.2 - 28.6	0.4 - 38
Gjithsej	109,422	496.8			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga të dhënat në tabelë dhe figurë, shihet qartë që viti 2021 dhe 2022, dallojnë për një rritje të ulët të kredive (rritje për 9.5%). Nëse krahasohet viti 2022 me vitin 2018, vërehet një rritje e konsideruar për 18.6%.

**Figura 44: Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000)**



Burimi: Bankat komerciale & IMF në Kosovë, BQK

Afati i dhënies së kredive bujqësore ndryshon nga 18 deri 41.9 muaj, varësisht prej destinimit të kredisë. Normat e interesit ndryshojnë nga 5.6% deri në 28.6%, bazuar në shumën e kredisë dhe afatin e kthimit. Prodhuesit bujqësor vazhdojnë të kenë pakënaqësi për normat e interesit, të cilat nuk ndikojnë në stimulimin e zhvillimit të këtij sektori.

Kolaterali zakonisht nuk kërkohet për shuma të vogla të kredisë. Për shuma mesatare dhe të mëdha, nga bankat dhe IMF-të kërkohet kolateral prej 100% deri në 388% të shumës së kredisë, ndërsa në vitet e fundit ka pasur normalizim të dukshëm. Në përgjithësi si standard për kolateral kërkohet prej huadhënësit nga 100% deri 150% e vlerës së kredisë.


Grejs periudha apo periudha e shtyrjes së pagesës, varion nga 3 deri në 12 muaj, megjithëse në disa publikime figuron 18 muaj, varësisht nga rastet ku grejs periudha është fleksibile. Vlen të theksohet se shlyerja e përqindjes më të madhe të kredive bëhet pas sezonit të korrjes. Ndër vite, vërehet që grejs periudha ishte më e ulët kurse në vitet e fundit ka ngritje të saj.

Pjesëmarrja e kredive në bujqësi në krahasim me kredi të tjera, nëpër Banka dhe IMF dallon. Te Bankat, deklarimi i pjesëmarrjes është nga 0.4% deri në 11.5%, që është shembull i mirë. Te IMF-të, deklarimi i pjesëmarrjes varion nga 16.5% në 38% që si mesatare është mbi 23%.

Huamarrja në banka dhe IMF me norma të interesit ndryshon varësisht nga shuma e kredisë dhe maturiteti i saj. Sa më e madhe është shuma dhe sa më e shkurtër është kohëzgjatja e kredisë, aq më e ulët është norma (kamata) e interesit si dhe e kundërta.

Nga figurat e mëposhtme shihen dallimet në shifra mes Bankave komerciale dhe IMF-ve.


**Figura 45: Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €**



Burimi: Banka & IMF, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Bankat karakterizohen me numër më të vogël të kredive por me shuma më të mëdha, që i bie se mesatarja për kredi për vitin 2022 ishte 22,100 €. Te IMF-të, mesatarja për kredi është 3,200 €, rrjedhimisht numër të madh të kredive por me shuma më të vogla, gjë që arrihet baraspesha e interesave gati për çdo fermer.


**Figura 46: Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €**



Burimi: Banka & IMF, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Kamatat në kredi-dhënie për sektorin bujqësor janë të larta në krahasim me kreditë e sektorëve tjerë dhe me vendet e regjionit, megjithëse viti 2022 te bankat u karakterizua me ngritje shumë të lehtë të normës së interesit për 0.1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021, ndërsa te MFI-të rënie prej 1 pikë përqindje e kjo rënie e normës së interesit nuk ndikon si stimulim për fermerët kur dihet që dallimi me kredi biznesi ende është i lartë, për 2 pikë përqindje.

**Figura 47: Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %**



Burimi: BQK

Sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së kredive të këqija tek agrokreditë, mund të themi se janë në nivelin e pranueshëm brenda limiteve të përcaktuara nga shumica e bankave dhe institucioneve financiare. Krahasuar me vendet e rajonit, jemi në një nivel shumë të kënaqshëm.

Ndër vite te Bankat, maksimumi i kredive të këqija ishte rreth 5%, ndërsa te IMF-të është dukshëm më i lartë.

### 6.3.2 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKGK

FKGK vazhdon ta konsiderojë financimin dhe garantimin e agro sektorit si një mundësi e mirë e krijimit të vendeve të reja të punës, zhvillimit ekonomik dhe zëvendësimit të produkteve ushqimore të importuara.

Deri në fund të vitit 2022, FKGK ka nënshkruar marrëveshje për Dritaren Agro me 11 Institucione të Regjistruara Financiare (IRF), respektivisht me 7 banka dhe 4 Institucione Mikrofinanciare (IMF) që janë aktive në agro kredi dhënje.

Në muajin Gusht të vitit të kaluar janë miratuar disa ndryshime të propozuara në Ligjin mbi Themelimin e FKGK-së të cilat ndryshime kanë mundësuar, ndër të tjera, edhe garantimin e vazhdueshëm të fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF).

Si rrjedhojë e ndryshimeve në këtë ligj, fermerëve dhe agrobizneseve vendore do t'ju mundësohet garantimi deri në 60% të kredisë së tyre bujqësore.

Gjatë vitit 2022 janë miratuar gjithsejt 8.8 mil. € kredi të reja nga bankat dhe IMF që janë aktive në sektorin e bujqësisë, të cilat janë vënë nën garancionin e FKGK-së dhe janë gjithsejt 212 kredi të garantuara në Dritaren Agro. Shuma mesatare e kredive të garantuara në sektorin e bujqësisë gjatë 2022 ishte rreth 41.5 mil. € me maturitet mesatar mbi 38 muaj.

Sipas deklarimit nga ana e bankave, gjatë vitit 2022 janë garantuar nga ana e FKGK-së rreth 29.6% e volumit dhe 31.1% e numrit të agro kredive që janë dhënë tek bizneset e regjistruara në ARBK dhe që janë financuar nga ana e tyre.

Deri në fund të vitit 2022, vetëm në Dritaren Agro, në total janë garantuar rreth 34.1 mil. € dhe 954 agro kredi, përderisa nëse shtohet garantimi i agro sektorit edhe gjatë Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, ky volum shkon në mbi 41.1 mil. € tek 1,104 kredi në total.

Shpërndarja rajonale e këtyre kredive të lëshuara nga IFP-të dhe të garantuara nga FKGK, në rajone të ndryshme për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2022 është si në vijim:


**Tabela 100: Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara, 2021**

Shpërndarja rajonale 2022	Kreditë e miratuara, €
Prishtinë	3,634,600
Prizren	998,100
Pejë	925,000
Mitrovicë	634,300
Gjakovë	495,000
Gjilan	1,394,000
Ferizaj	718,000
Gjithsej	8,799,000

Burimi: FKGK



**Figura 48: Proporcioni i shpërndarjes së kredive, %**



Burimi: FKGK

Gjatë vitit 2022, nga 212 agro kredi të garantuara nga ana e FKGK-së në Dritaren Agro, IRF-të parashihnin mbi 6.4 mil. € rritje të qarkullimit të klientëve të tyre nga investimet e bëra si dhe 383 vende të reja pune të deklaruara mbi bazën e tanishme.

## **6.4 Sigurimet në fushën e bujqësisë**

Pajisja e fermerëve me një polisë sigurimi është një mundësi unike për të ndihmuar zhvillimin e bujqësisë në vend, si dhe për të rritur qasjen në financa për të gjithë fermerët kosovarë dhe për të krijuar mundësi të reja për të kaluar rreziqet me të cilat përballen çdo ditë. Sistemi i sigurimeve bujqësore të Kosovës po forcon bazat e tij, duke sjellë praktikatat më të mira ndërkombëtare në hartimin e produkteve më të përshtatshme për fermerët kosovarë.

### **Zhvillimi dhe Shitja e Produkteve Indeks të Sigurimit Bujqësor**

Në vitin 2022, gjithsej në dispozicion ishin dymbëdhjetë (12) produkte të sigurimit indeks që ofronin sigurim për rreziqe të ndryshme për mollën, rrushin, kumbullën, specin, dredhëzën, mjedrën, arrën, vishnjën, qershinë, fasulen, dardhën dhe misrin. Për dallim prej viteve të kaluara, nuk janë zhvilluar produkte shtesë të sigurimit indeks. Mirëpo, gjatë këtij viti kalendarik janë identifikuar disa faktorë shtesë të rrezikut për kultura të ndryshme si: breshëri te mjedra pranverore, verore dhe dredhëza, kurse temperaturat e larta te gruri. Këto produkte do të finalizohen gjatë vitit 2023, sepse për të konsideruar një produkt plotësisht funksional nevojitet të kalojë një periudhë kohore së paku 9-12 muaj, për qëllime të testimit.

Përveç produkteve të sigurimit indeks, në vitin 2022, kanë qenë të gatshme për pilotim/testim edhe tre produkte tradicionale që ofrojnë sigurim kundër breshërit për mollë, spec dhe rrush.

Këto kultura u zgjedhën bashkërisht nga MBPZHR-ja dhe IFC-ja bazuar në faktorë të ndryshëm si struktura e fermës, numri i fermerëve, kostoja e prodhimit, zinxhiri i vlerës dhe analiza e rrezikut për secilën kulturë.

Në vitin 2022, gjithsej produkte të sigurimit ishin pesëmbëdhjetë produkte - dymbëdhjetë (12) produkte të sigurimit indeks dhe tre produkte të sigurimit tradicional (shih tabelën e më poshtme).

**Tabela 101: Produktet e Sigurimit Indeks dhe tradicional për Kosovë për vitin 2022**

Lloji i kulturës	Rreziqet e mbuluara	Periudha e mbulimit
Molla	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Kumbulla	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Rrushi	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Mjedra	Temperatura të larta ekstreme	1 Korrik - 31 Gusht
Dredhëza	Ngricat pranverore	1 Mars - 30 Prill
Speci	Shirat e tepërta	15 Maj - 10 Qershor
Arra	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Vishnja	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Qershia	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Dardha	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Fasulja	Temperatura të larta ekstreme	25 Qershor - 05 Gusht
Misri	Temperatura të larta ekstreme	25 Qershor - 25 Korrik
Molla	Breshëri	15 Maj - 30 Shtator
Speci	Breshëri	10 Korrik - 30 Shtator
Rrushi	Breshëri	15 Maj - 30 Shtator


\*Shënim: Produktet e sigurimit mund të ndryshojnë çdo vit, pas një rishikimi vjetor.

Sa i përket shitjes së produkteve të sigurimit indeks, përgjatë vitit 2022, skemës së sigurimeve iu bashkuan një numër i përgjithshëm prej pesëmbëdhjetë (15) fermerësh. Këto polica sigurimi u lëshuan për rrushin e verës dhe kulturën e mjedrës - të dyja produkte të sigurimit indeks. Poliset e shitura kanë ofruar mbrojtje në pjesën perëndimore të Kosovës, përkatësisht në dy komuna, në komunën e Rahovecit dhe Pejës.

Gjithsej, një sipërfaqe prej 20.24 ha ishte siguruar, me sipërfaqe minimale të siguruar prej 0.30 ha dhe maksimale deri në 5.62 ha. Në përgjithësi, në vitin 2022, sipërfaqja mesatare e siguruar ishte 1.35 ha. Për të siguruar këtë sipërfaqe të kultivimit, fermerët paguan një çmim mesatar prej 138 € për policën e sigurimit, duke filluar nga një vlerë minimale prej vetëm 6 € deri në një maksimum prej 575 €. Këta fermerë kanë paguar gjithsej 2,070 € si premi, kurse shuma totale e sigurimit arriti vlerën prej 25,467 €.

Krahasuar me vitin 2021, edhe pse numri i fermerëve që kanë siguruar sipërfaqet e tyre ka rënë me 34%, sipërfaqja totale e siguruar është rritur dukshëm, me 298%. Ngjashëm, krahasuar me vitin 2020, numri i përgjithshëm i fermerëve që kanë siguruar sipërfaqet e tyre të kultivimit është zvogëluar për 72%, mirëpo sipërfaqja totale e siguruar është rritur me 28%, që shënon një trend pozitiv të rritjes së sipërfaqeve të siguruara.

**Figura 49: Sipërfaqja totale e siguruar në ha dhe nr. i fermerëve të siguruar**



Burimi: Sistemi Informativ i Sigurimit Bujqësor (SISB)

Po ashtu, pas përfundimit të periudhës së shitjes, gjatë rishikimit të produkteve siguruese ekzistuese dhe rezultateve të shitjeve, është vendosur që produkti sigurues indeks i specit të mos ofrohet për shitje gjatë vitit 2023, për shkak të mungesës së kërkesës nga ana e fermerëve për këtë produkt sigurues dhe ndryshimeve në periudha të kultivimit nëpër regjione të ndryshme të vendit.

Sa i përket shitjes së produkteve tradicionale të sigurimit, edhe pse këto produkte ishin gati për treg dhe përveç kësaj, ishin të përfshira në programin e pagesave direkte, nuk ka pasur interes nga fermerët për blerjen e këtij lloji sigurimi dhe as nga kompanitë e sigurimit për t'i shitur ato.

### **Dëmet/ humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit**

Për dallim me vitet e kaluara, përgjatë vitit 2022, fermerët e siguruar e të cilët kishin blerë poliset e sigurimit bujqësor nuk pësuan dëme. Pra, gjatë këtij viti, nga grupi i fermerëve që blenë sigurime bujqësore, asnjë nga fermerët nuk morën pagesa të dëmshpërblimit pasi që nuk kishte humbje në sipërfaqet e tyre të kultivuara për rreziqet që kishin blerë sigurim.

### **Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore**

**Zhvillimi i kapaciteteve tek vlerësuesit e parë të humbjeve bujqësore në Kosovë:** Përgjatë tre viteve të kaluara, përkatësisht gjatë 2018, 2019 dhe 2020, puna në sigurime bujqësore ishte fokusuar edhe në zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore që do të mundësonin funksionalizimin e plotë të produkteve tradicionale të sigurimeve. Duke pas parasysh që për sigurimet bujqësore tradicionale kërkohet vlerësim i humbjeve në terren, projekti i sigurimit ka trajnuar në vazhdimësi njëzet e pesë (25) vlerësuesit e ardhshëm të humbjeve, të cilët

përcaktojnë përqindjen e saktë të dëmit në kulturën e siguruar dhe kështu mundësojnë llogaritjen e dëmit dhe vlerën e dëmshpërblimit që do të marrin fermerët.

Ndërsa përgjatë vitit 2021 dhe 2022, projekti i sigurimeve bujqësore është fokusuar në licencimin apo krijimin e mundësive tjera alternative që këta vlerësues të certifikuar të dëmeve të fillojnë punën e tyre në terren. Për këtë arsye, projekti ka realizuar disa takime me kompanitë e sigurimeve dhe me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), për të mundësuar përdorimin e vlerësuesve ekzistues të dëmeve në sigurimet bujqësore. Bazuar në kërkesat ekzistuese për licencim, vlerësuesi i humbjeve duhet të ketë përvojë në fushën e sigurimeve dhe përvojë në fushën e bujqësisë. Nga vlerësuesit ekzistues të humbjeve të trajnuar në tre vitet e fundit, asnjë nuk i plotëson këto kritere. Prandaj, projekti i sigurimeve i ka rekomanduar institucioneve relevante që të numërohen (llogariten) trajnimet e vlerësuesve të humbjeve të ofruara nga IFC si përvojë e kërkuar në bujqësi.

Në kuadër të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, IFC në bashkëpunim të ngushtë me MBPZHR-në kanë vazhduar me organizimin e ngjarjeve të ndryshme me qëllim avansimin e sistemit të sigurimeve bujqësore dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore të sigurimit bujqësor. Përkatësisht, gjatë vitit 2022, IFC në bashkëpunim të ngushtë me MBPZHR-në ka organizuar katër punëtori me akterë të ndryshëm të sigurimeve bujqësore, tre takime koordinuese me MBPZHR-në dhe një takim në kuadër të grupeve punuese. Gjithsej janë organizuar 8 ngjarje me një numër të përgjithshëm prej 112 pjesëmarrësish.

Përveç këtyre ngjarjeve, projekti është fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të kompanive të sigurimit të cilat do të ofrojnë sigurim bujqësor. Për këtë qëllim janë organizuar gjithsej 3 trajnime, që kanë mbuluar tema nga zhvillimi i produkteve të sigurimit, produktet e disponueshme indeks të sigurimit dhe vlerësimi i humbjeve. Në 3 trajnime, gjithsej pjesëmarrës ishin 41 persona.

## **Kampanjat Publike Vetëdijësuese**

### **Ngjarjet me fermerë, kompani të sigurimit, banka komerciale dhe akterë të tjerë**

Si pjesë e projektit të sigurimit të bujqësisë, në vitin 2022, IFC në bashkëpunim të ngushtë me MBPZHR-në organizoi dhe zbatoi disa ngjarje në kuadër të marrëdhënieve me publikun në të gjithë Kosovën. Qëllimi i këtyre ngjarjeve ishte zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe rritja e ndërgjegjësimit për sigurimet në bujqësi.

Përgjatë këtij viti, puna në sigurime bujqësore kryesisht u fokusua në takime me qëllim promovimin e produkteve të disponueshme të sigurimit bujqësor, me fermerë dhe shoqata fermerësh dhe në përgjithësi ndërgjegjësimin e publikut dhe ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e sigurimit bujqësor. Përveç kësaj, pjesëmarrja në emisione televizive dhe publikimi i artikujve të ndryshëm në lidhje me sigurimet bujqësore ka qenë pjesë e aktiviteteve kyçe mbi ngritjen e vetëdijes mbi sigurimet bujqësore. Në përgjithësi, në vitin 2022, një numër prej 144 personave morën pjesë në një total prej 6 ngjarjeve të organizuara.

## **Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore**

Për shkak të problemeve teknike sidomos në zhvillimin e veçorive të reja në sistemin e vjetër informativ, pjesa më e rëndësishme e punës në sisteme informative përgjatë vitit 2022, ka qenë në zhvillimin e sistemit të ri informativ. Puna kryesore ka përfunduar në fund të vitit 2022, dhe sistemi i ri informativ pritet të lansohet në fillim të vitit 2023.

Gjithashtu edhe faqja e internetit [www.sigurimibujqesor.com](http://www.sigurimibujqesor.com) që u lansua në vitin 2019, u përditësua me materiale të reja gjatë vitit 2022.

### **Korniza ligjore**

Projekti i IFC-së për Sigurimet Bujqësore ka propozuar dispozita për të krijuar sistemin e sigurimeve bujqësore në Kosovë përmes miratimit të ligjit të ri për bujqësi. Ligji i ri për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i është dërguar Kuvendit për miratim. Drafti i këtij ligji ka marrë në konsideratë propozimet e projektit dhe përfundimisht, neni 21 i projektligjit të propozuar parashikon masat për menaxhimin e rrezikut bujqësor dhe rikthimin e potencialit të prodhimit bujqësor. Gjithashtu, projekti i IFC-së për Sigurimet Bujqësore ka punuar në akte nënligjore që do të finalizohen me hyrjen në fuqi të ligjit të ri.

## **6.5 Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive**

Programi për Zhvillim Rural për vitin 2022, bazuar në analizat e përmbledhura, analizën SWOT dhe analizën sektoriale ka nxjerrë objektivat afatmesme si në vijim:

- Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor duke përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, duke tërhequr fermerët e rinj, duke orientuar prodhimin sipas kërkesave të tregut, duke përmirësuar zinxhirin e vlerës dhe duke u fokusuar në kërkimin, inovacionin, teknologjinë e re dhe digjitalizimin;
- Të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të shoqërisë për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, duke kontribuar me një pjesë më të madhe në prodhimin vendor;
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisore, të cilat adresojnë sfidat e ndryshimeve klimatike duke arritur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës, zhvillimi i komunitetit dhe përfshirja sociale në zonat rurale dhe ndërtimi i administratave publike moderne, duke respektuar parimet e qeverisjes së mirë.

Masat e përkrahura në PZhR për vitin 2022, janë:

Masa 1: Investimet në asete fizike në ekonominë bujqësore;

Masa 3: Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;

Masa 7: Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve;

Masa 5: Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - " Qasja Leader".

Buxheti total për mbështetjen e këtyre masave dhe nën-masave ishte 26.3 mil. €, i ndarë për Masën 1 (13 mil. €), Masën 3 (5.8 mil. €), Masën 7 (7.2 mil. €) dhe Masën 5 (200,000 €). Tabela në vijim paraqet buxhetin e shpërndarë në mënyrë të detajuar sipas masave dhe nën-masave.

**Tabela 102: Buxheti i paraparë i PZhR, 2022**

Masa dhe nën-masa	Vlera në €
<b>Masa 1: Investimet në asete fizike në ekonomitë bujqësore</b>	<b>13,095,325</b>
1.1 Sektori pemë drufrutore	2,500,000
a) Arra dhe lajthia	500,000
1.2 Pemë manore	1,000,000
1.3 Sektori i perimeve dhe serrave	1,700,000
a) Sektori i serrave për fidane	1,500,000
1.4 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,195,325
1.5 Prodhimi i mishit/rritja e viçave	1,500,000
1.6 Prodhimi i mishit/rritja e derrave	200,000
1.7 Prodhimi i qumështit/lopë	1,500,000
1.8 Prodhimi i qumështit/dele dhe dhi	300,000
1.9 Pikat grumbulluese të qumështit	250,000
1.10 Prodhimi i rrushit	450,000
1.11 Prodhimi i vezëve	500,000
<b>Masa 3: Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore</b>	<b>5,836,473</b>
3.1 Përpunimit të qumështit	500,000
3.2 Përpunimit të mishit	800,000
3.3 Përpunimit të pemëve dhe perimeve	1,236,473
3.4 Përpunimi i verës	300,000
3.5 Pika grumbulluese/depo	3,000,000
<b>Masa 7: Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve</b>	<b>7,200,000</b>
7.1 Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike	600,000
7.2 Zhvillimi i turizmit rural dhe agro-turizmi	3,500,000
7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	700,000
7.4 Prodhimi i mjaltit	500,000
7.5 Aktivitetet jo-bujqësore në zonat rurale	500,000
a) Përpunimi i leshit të deleve	400,000
b) Prodhimi i humusit	200,000
7.6 Rritja e shpezëve të fshatit	300,000
7.7 Kultivimi i peshkut	500,000
<b>Masa 5: Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - " Qasja Leader"</b>	<b>200,000</b>
Numri i GLV-ve që aplikojnë	20
Buxheti për një GLV	10,000
<b>Gjithsej</b>	<b>26,331,798</b>

Burimi: Programi për Zhvillim Rural 2022

Në vijim janë të paraqitura projektet e miratuara në kuadër të PZhR-së, nga ku gjatë vitit 2022 kanë përfituar gjithsej 491 persona dhe shuma e aplikuar për projekte e miratuara ishte gjithsej

38.8 mil. €, shuma e miratuar ishte 35.9 mil. €, ndërsa shuma për pagesë (përkrahja publike) për këto projekte ishte gjithsej 24.2 mil. €.

Sipas masave shuma e paguar dhe numri i përfituesve ishte: për Masën 1 ishin gjithsej 382 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 20.2 mil. €, Masa 3 kishte gjithsej 6 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 995,238 €, Masa 5 kishte 6 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 59,695 € dhe Masa 7, kishte gjithsej 97 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 3 mil. €.

Në tabelë janë të paraqitura numri i përfituesve sipas nën-masave dhe vlera e tyre.

**Tabela 103: Projektet e miratuara PZHR, 2022**

Masa	Nën-masa	Nr. i përfituesve	Shuma e aplikuar	Shuma e miratuar	Shuma për pagesë
Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore	1.1 Sektori pemë drufrutore	52	4,691,312	4,405,621	3,083,935
	a) Arra dhe lajthia	29	2,354,544	2,088,163	1,461,714
	1.2 Pemë manore	17	1,333,337	962,287	673,601
	1.3 Sektori i perimeve dhe serrave	127	9,228,339	8,940,201	6,258,140
	a) Sektori i serrave për fidane	8	800,000	750,785	525,550
	1.4 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	33	3,118,619	2,807,456	1,965,219
	1.5 Prodhimi i mishit / rritja e viçave	39	3,550,522	3,212,659	2,248,861
	1.6 Prodhimi i mishit / rritja e derrave	4	341,434	284,346	199,042
	1.7 Prodhimi i qumështit / lopë	32	2,805,845	2,652,131	1,856,492
	1.8 Prodhimi i qumështit / dele dhe dhi	6	546,715	523,888	366,722
	1.9 Pikat grumbulluese të qumështit	2	175,604	149,577	104,704
1.10 Prodhimi i rrushit	18	1,018,314	946,929	662,850	
1.11 Prodhimi i vezëve	15	1,379,059	1,165,363	815,754	
<b>Gjithsej Masa 1</b>		<b>382</b>	<b>31,343,642</b>	<b>28,889,405</b>	<b>20,222,584</b>
Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	3.1 Përpunim të qumështit	1	305,950	302,200	151,100
	3.2 Përpunim të mishit	1	400,000	400,000	200,000
	3.3 Përpunimi të pemëve dhe perimeve	2	799,237	722,250	361,125
	3.4 Përpunimi i verës	1	472,000	393,640	196,820
	3.5 Pika grumbulluese /depo	1	172,387	172,387	86,193
<b>Gjithsej Masa 3</b>		<b>6</b>	<b>2,149,574</b>	<b>1,990,477</b>	<b>995,238</b>
Masa 5: Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - "Qasja Leader"	Përgatitja zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER	6	59,695	59,695	59,695
<b>Gjithsej Masa 5</b>		<b>6</b>	<b>59,695</b>	<b>59,695</b>	<b>59,695</b>
Masa 7: Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve	7.1 Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike	3	258,950	216,750	130,050
	7.2 Zhvillimi i turizmi rural dhe agro - turizmi	32	2,969,917	2,928,449	1,757,070
	7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	10	483,770	451,934	271,161
	7.4 Prodhimi mjaltit	36	966,373	799,791	479,875
	7.5 Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale	11	318,758	318,029	190,817
	b) Prodhimi i humusit	2	100,000	99,666	59,800
	7.6 Rritja e shpezëve të fshatit	1	30,000	29,260	17,556
7.7 Kultivimi i peshkut	2	199,966	184,711	110,826	
<b>Gjithsej Masa 7</b>		<b>97</b>	<b>5,327,734</b>	<b>5,028,591</b>	<b>3,017,155</b>
<b>Gjithsej Masa 1+Masa 3+Masa 5+Masa 7</b>		<b>491</b>	<b>38,880,645</b>	<b>35,968,168</b>	<b>24,294,671</b>

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - AZhB

## 6.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

### Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor

Shërbimi këshillues është i organizuar në formë të sistemit këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural, ku përfshinë të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Ky sistem përmbledh në vete sektorin publik dhe atë privat.

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore në MBPZHR, si çdo vit edhe për vitin 2022 ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve në nivel qendror dhe lokal, duke përkrahur dhe ofruar këshilla dhe trajnime. Të gjitha aktivitetet e DShKT si trajnimet për ngritje të kapaciteteve, trajnimet për certifikim, trajnimet për fermer, këshillat dhe publikimet, organizohen bazuar në Ligjin për Shërbime Këshilluese nr. 04/L-074, dhe udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj.

**Sistemi Këshillimor i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**, përdoret në vazhdimësi për të arritur objektivat e vendosura në PBZHR. Këto objektiva fokusohen në ngritjen e të ardhurave bujqësore nga feramat përmes konkurrencës së përmirësuar të tregut, prodhimtarisë dhe zhvillimit rural. Ndërsa fokus të veçantë duhet kushtuar:

- Njohurive bujqësore dhe aftësive për menaxhimin e fermerëve, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e tyre dhe të inkurajohet inovacioni;
- Menaxhimit të qëndrueshëm të pronave bujqësore, përfshirë përdorimin e përmirësuar të teknologjisë dhe metodave të prodhimtarisë bujqësore;
- Ruajtjes së ambientit (ujit, tokës dhe ajrit);
- Sigurisë së ushqimit dhe cilësisë;
- Veterinarisë, fito-sanitarisë, mirëqenies së kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, cilësisë dhe standardeve të higjienës;
- Zhvillimit të grupeve të fermerëve, raporteve mes prodhuesve, tregtarëve dhe inputeve nga furnitorët, si dhe cilësisë dhe vazhdimet të furnizimit me ushqim.

Gjatë vitit 2022, është hartuar Plani Strategjik i Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili ka për mision të mbështesë dhe promovojë transferimin e njohurive dhe teknologjive për të rritur produktivitetin, cilësinë, standardet e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me objektivat e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe përafrimin me Politikën Bujqësore të BE-së. Bazuar në këtë plan strategjik, synohet ofrimi i shërbimeve këshillimore profesionale për fermerë në bazë të partneritetit publiko/privat.

DShKT, gjatë vitit 2022 ka punuar me donatorë të ndryshëm si Caritasi Zviceran i cili ka ndihmuar me kapacitete në Hartimin e Planit Strategjik të SKKBZHR dhe me ILO projekti “Punët e rrezikshme për fëmijë në Bujqësi” ku së bashku është hartuar udhëzuesi për punët e rrezikshme në bujqësi, janë mbajtur trajnime për ngritje të kapaciteteve të këshilltarëve me temën “punët e rrezikshme të fëmijëve në bujqësi” me qëllim të sensibilizimit të komunitetit rural.



Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në Qendrat Informative Këshilluese Komunale (QIKK), janë organizuar aktivitete e rregullta për të përkrahur fermerët me këshilla teknike në sektorët e blegtorisë, bletarisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë dhe prodhimtarinë organike. Mirëpo vlenë të ceket se aktivitetet e zhvilluara në QIKK janë zhvilluar me një intensitet më të ulët dhe ka pas mangësi në realizimin e planit për arsye të mos realizimit të projektit “Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimit këshillues”, megjithatë pavarësisht kushteve të krijuara janë realizuar disa aktivitete në mbështetje të fermerëve: siç janë mbështetja e fermerëve në mbushjen e aplikacioneve për grande dhe subvencione, pranimi i dokumentacioneve për subvencione, janë shpërndarë materiale për ekstension si broshura, fletëpalosje, etj.

**Tabela 104: Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative**

Nr. i aplikacioneve për subvencione të pranuar nga këshilltarët	12,142
Nr. i fermerëve të informuar për grante dhe subvencione	6,607
Nr. i fermerëve të përkrahur në aplikim për grante dhe subvencione	4,245
Nr. i fermerëve të përkrahur në përgatitjen e projekteve	345
Materialet e dhëna në formë të broshurave dhe fletëpalosjeve	4,903
Nr. i fermerëve i përkrahur me këshilla teknike në zyre	5,683
Nr. i përfituesve me trajnime dhe këshilla në teren	1,840

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike; Sqarim: janë të paraqitura vetëm aplikacionet e pranuar nga këshilltarët komunal dhe për këtë dallon nga gjithsej numri i aplikacioneve për subvencione sepse gjatë procesit të aplikimit angazhohen edhe staf plotësues për pranim të aplikacioneve.

Lidhur me aktivitete e këshilltarëve në terren, brenda mundësive që kanë lejuar kushtet janë realizuar disa aktivitete me pajisjet e tyre që posedojnë për përkrahjen e fermerëve dhe për caktimin e disa parametrave dhe në bazë të tyre dhënien e këshillave.

**Tabela 105: Aktivitetet e zhvilluara në terren nga këshilltarët**

Nr. i mostrave të marra dhe dërgimi i tyre për analizë	84
Nr. i matjeve dhe përcaktimi i pH të tokës	32
Nr. i matjeve dhe përcaktimi i pH të ujit	24
Nr. i matjeve të kripëzimit në tokë - EC e që bazohet në përmbajtje të kripërave në tokë	29
Nr. i matjeve të temperaturës dhe lagështisë së ajrit në objekte të mbyllura	174
Nr. i matjeve të sheqerit në fryte dhe përcaktimi i afatit të vjeljes	73
Nr. i matjeve të fortësisë së fryteve dhe përcaktimi kohës së vjeljes	34
Identifikimi i dëmtuesve në kultura bujqësore	88

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Numri i kompanive të licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural është gjithsej 13, të paraqitura në tabelën në vijim.

**Tabela 106: Kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural**

Kompania	Komuna
IADK	Vushtri
Consult Engineering	Prishtinë
IKC	Ferizaj
ESG	Prishtinë
KDC	Gjakovë
NSH. KMI	Prishtinë
SH.P.K "PMC"	Prishtinë
Ekrem Strana B.I	Mitrovicë
Novus Consulting	Prishtinë
Kosovo Consulting Group SH.P.K	Gjilan
Agrovinifera Sh.P.K	Rahovec
Recura Sh.a	Prishtinë
Organika	Prishtinë

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

### **Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor**

Pas miratimit të Planit Strategjik të Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim rural, Shërbimi Këshillimor është në proces të zhvillimit strukturor të sistemit, me qëllim të ngritjes së efikasitetit në mbështetje të fermerëve.

Përmes web-faqes, po vazhdohet t'i jepet rëndësi e veçantë promovimit ku ofrohen informacione për të dhëna statistikore, këshilla dhe mesazhe sensibilizuese nga të gjitha fushat, ku varësisht periudhave kohore njoftohen fermerët për afatet e kryerjes së aktiviteteve të ndryshme bujqësore.

Edhe gjatë vitit 2022, kanë vazhduar vizitat në Qendrat Informative Komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, ku është bërë një analizë e thukët rreth organizimit dhe koordinimit më të mirë të aktiviteteve mes komunave dhe Ministrisë.

## **6.7 Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare**

Sa i përket zhvillimeve të politikave tregtare bujqësore, pas hyrjes në fuqi dhe fillimit të zbatimit të MSA dhe CEFTA-s për kapitujt 1-24, bazuar në të dhënat statistikore nga Doganat e Kosovës, vazhdon të vërehet se ka një rritje të eksportit për disa produkte bujqësore, por njëkohësisht vërehet edhe një rritje e importit të produkteve bujqësore nga shtetet e BE-së para fillimit të zbatimit të MSA-së.

Bazuar në zhvillimet e vitin 2022, me datë 27.10.2022 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me rekomandim të Komisionit Ndërmarrësor për Vlerësimin e Masave Mbrojtëse Anti-damping dhe Masave Kundër balancues, ka vazhduar masën e veçantë për vendosjen e një tarife shtesë prej 0.04 €/kg për miellin e importuar nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës. Kjo masë është vendosur me qëllim të mbrojtjes së këtij sektori dhe zhvillimit të industrisë së miellit, si dhe rritjes së prodhimit të grurit.

Reformat e Politikave të Përbashkëta Bujqësore gjatë dekadës së fundit kanë nxitur sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore të vendit në përmirësimin e orientimit të tij drejt tregjeve Evropiane dhe vendeve të tjera jashtë BE-së, duke u bërë kështu produktet tona bujqësore konkurruese me vendet e regjionit dhe më gjerë.

Si rezultat i kësaj, vlera e eksportit të produkteve agro-ushqimore është dyfishuar dhe Kosova është duke u bërë shtet konkurrues në disa nivele të zinxhirit të vlerave të produkteve bujqësore.

Sa i përket Legjislacionit Nacional, përmes të cilit do të rregullohet organizimi i tregut të përbashkët për produkte bujqësore, nga komisioni i MBPZHR në mbështetje të projektit “Ndërtimi i kapaciteteve për Kosovën në lidhur me Organizimin e Tregut të Përbashkët dhe Statistikat Bujqësore”, është përgatitur projektligji për Organizimin e Tregut për Produkte Bujqësore i cili tani është në lexim të dytë në Kuvendin e Kosovës.

## 7 Shtojcat

### 7.1 Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural

#### Legjislacioni kombëtar në fuqi për vitin 2022

Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural<sup>7</sup> (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27 Korrik 2009)

#### 7.1.1 Ligjet e miratuara gjatë vitit 2022

1. Ligji Nr. 08/L-095 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/9 Ligji për Kooperativat e Bujqve (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).
2. Ligji Nr. 08/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).
3. Ligji Nr. 08/L-086 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-114 për Pasurimin e Miellit, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/25.08.2022).
4. Ligji Nr. 08/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-085 për Bujqësi Organike, (Gazeta Zyrtare Nr. 29/01.09.2022).
5. Ligji Nr. 08/L-078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/26.08.2022).
6. Ligji Nr. 08/L-082 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).
7. Ligji Nr. 08/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësor, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/25.08.2022).
8. Ligji Nr. 08/L-080 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/5 Ligji i Kosovës për Farërat, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/26.08.2022).
9. Ligji Nr. 08/L-089 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/10 Ligji për Plehrat Artificiale, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/30.08.2022).
10. Ligji Nr. 08/L-085 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor, (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).
11. Ligji Nr. 08/L-091 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/30.08.2022).
12. Ligji Nr. 08/L-091 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/26.08.2022).
13. Ligji Nr. 08/L-087 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/30.08.2022).
14. Ligji Nr. 08/L-079 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/26.08.2022).
15. Ligji Nr. 08/L-084 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).

---

<sup>7</sup> Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, ka qenë në fuqi deri më datë 30.03.2023, nga data 30.03.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

16. Ligji Nr. 08/L-088 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-111 për Bletari (Gazeta Zyrtare Nr. 28/30.08.2022).
17. Ligji Nr. 08/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve (Gazeta Zyrtare Nr. 28/30.08.2022).
18. Ligji Nr. 08/L-083 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-8 për Verërat, (Gazeta Zyrtare Nr. 29/01.09.2022).
19. Ligji Nr. 08/L-083 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).
20. Ligji Nr. 08/L-112 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare Nr. 26/24.08.2022).
21. Ligji Nr. 08/L-120 për Ushqim (Gazeta Zyrtare Nr. 23/12.08.2022).
22. Ligji Nr. 08/L-070 për Pijet e Forta Alkoolike (Gazeta Zyrtare Nr. 16/04.07.2022).

### **7.1.2 Udhëzimet Administrative të miratuara në vitin 2022**

1. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 01/2022 për Formën dhe Përmbajtjen e Certifikatave Fitosanitare, të datës 12.04.2022.
2. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 02/2022 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2022, të datës 12.04.2022.
3. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 03/2022 për Mbrojtjen e Peshqve në Ujërat e Peshkimit, të datës 13.06.2022.
4. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 04/2022 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillimin Rural për vitin 2022, të datës 22.06.2022.
5. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 05/2022 për Përcaktimin e Rregullave Shëndetësore për Nën Produkte Shtazore dhe Produkte të Derivuara që nuk janë të Destinuar për Konsum nga Njeriu, të datës 15.07.2022.
6. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 06/2022 për Verifikimin e Produkteve Bujqësore dhe Artikujve Ushqimor nga Trupat Certifikuese, të datës 02.09.2022.
7. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 07/2022 për Detyrat, Procedurat për Mbrojtjen e Varietetit të Bimëve, Procedurat e Punës së Komisionit dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve, të datës 17.10.2022.
8. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 08/2022 Forma dhe Përmbajtja e Certifikatës për të Drejtat e Seleksionuesit të Bimëve, të datës 17.10.2022.
9. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 09/2022 për Mënyrën, Dinamikën e kryerjes së shërbimeve profesionale, Metodën e përcjelljes së përdorimit dhe vlerësimin e mjeteve për përdorim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, të datës 17.10.2022.
10. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 10/2022 Kriteret për Regjistrimin e Emrit të Varietetit të Bimëve, të datës 24.10.2022.

11. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 11/2022 për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrave Fitosanitar për Prodhimin, Paketimin, Përpunimin, Importin, Eksportin, Deponimin, Shpërndarjen e Bimëve, Produkteve Bimore dhe objekteve tjera, të datës 24.10.2022.
12. Udhëzimin Administrativ (MBPZhR) - Nr. 12/2022 për Themelimin e Këshillit të Blegtorisë, të datës 20.10.2022.
13. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 13/2022 për Luftimin dhe Çrrënjosjen e Sëmundjes së Brucelozës, Tuberkulozës dhe Leukozën enzootike të gjedhit, të datës 24.10.2022.
14. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 14/2022 të datës 02.12.2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) - Nr. 04/2022 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2022.
15. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 15/2022 Kriteret për Organizimin dhe Menaxhimin e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë, të datës 02.12.2022.
16. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 16/2022 për Sistemin Informativ të Tregut, të datës 14.12.2022.

## 7.2 Personat përgjegjës për Raportin e Gjelbër, 2023

Tabela e përmbajtjes		Personi përgjegjës
1	Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	
1.1	Niveli i zhvillimit socio-ekonomik	D. Hana
1.2	Puna dhe punësimi	D. Hana
1.3	Llogaritë ekonomike në bujqësi	D. Hana
1.3.1	Prodhimet bujqësore	D. Hana
1.3.2	Të ardhurat sipërmarrëse	D. Hana
1.3.3	Inputet në bujqësi	D. Hana
1.4	Çmimet e inpleteve dhe prodhimeve bujqësore	
1.4.1	Çmimet e inpleteve bujqësore	A. Maksuti
1.4.2	Çmimet e prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së	Sh. Duraku
1.5	Privatizimi i tokave bujqësore	D. Hana
1.6	Bizneset bujqësore - Agroindustria	D. Hana
2	Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij	
2.1	Përdorimi i tokës bujqësore	A. Maksuti
2.2	Prodhimtaria bimore	A. Maksuti
2.2.1	Drithërat	A. Maksuti
2.2.2	Perimet	D. Hana
2.2.3	Pemët	D. Hana
2.2.4	Vreshtat dhe verërat	D. Hana
	Vreshtat	D. Hana
	Verërat	D. Hana
	Analizat fiziko- kimike të verës	D. Hana
2.2.5	Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra	A. Maksuti
2.2.6	Kulturat industriale	A. Maksuti
2.3	Ujitja e tokës bujqësore	D. Hana
2.4	Blegtoaria	A. Maksuti
2.4.1	Gjedhet	A. Maksuti
2.4.2	Dhentë dhe dhitë	A. Maksuti
2.4.3	Derrat dhe kafshët tjera të fermës	A. Maksuti
2.4.4	Shpezëtaria	A. Maksuti
2.4.5	Bletaria	A. Maksuti
3	Pylltaria	S. Bajrami
4	Tregtia dhe trendet e konsumit	
4.1	Trendet e konsumit	D. Hana
4.2	Tregtia e përgjithshme	B. Dabiqaj/A. Maksuti
4.3	Tregtia e produkteve bujqësore	B. Dabiqaj/A. Maksuti
4.3.1	Tregtia sipas grupeve të shteteve	B. Dabiqaj/A. Maksuti
	Tregtia me vendet e CEFTA-s	B. Dabiqaj/A. Maksuti
	Tregtia me vendet e BE-së	B. Dabiqaj/A. Maksuti
	Tregtia me vendet e treta	B. Dabiqaj/A. Maksuti
4.3.2	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	B. Dabiqaj/A. Maksuti
	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	B. Dabiqaj/A. Maksuti
	Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)	B. Dabiqaj/A. Maksuti
5	Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit	D. Hana
5.1	Emetimi i gazrave serrë	H. Xhaferi
6	Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural	
6.1	Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve	A. Maksuti

6.2	Pagesat Direkte/Subvencionet	A. Maksuti
6.2.1	Pagesat Direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor Primi i sigurimi bujqësor	A. Maksuti A. Maksuti
6.2.2	Pagesat Direkte për blegtori dhe qumësht	A. Maksuti
6.2.3	Mbështetja e inputeve në bujqësi Mbështetja e fidanëve Mbështetja për naftë Mbështetja për pleh	A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti
6.3	Agro Kreditë dhe fondi garantues	Sh. Duraku
6.3.1	Agro Kreditë	Sh. Duraku
6.3.2	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKGK	Sh. Duraku
6.4	Sigurimet në fushën e bujqësisë Zhvillimi dhe Shitja e Produkteve Indeks të Sigurimit Bujqësor Dëmet/ humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore Kampanjat Publike Vetëdijësuese Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore	A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti
6.5	Projektet e zhvillimit rural - Grantet investive	D. Hana
6.6	Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor	D. Hana D. Hana D. Hana
6.7	Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare	D. Hana
7	Shtojcat	
7.1	Lista e ligjeve dhe akteve ligjore në lidhje me Bujqësinë, Pyllltarinë dhe Zhvillimin Rural Legjislacioni kombëtar në fuqi	D. Hana
7.1.1	Ligjet e miratuara gjatë vitit 2022	
7.1.2	Udhëzimet Administrative të miratuara në vitin 2022	D. Hana

**e-mailat kontaktues:**

[delvina.hana@rks-gov.net](mailto:delvina.hana@rks-gov.net)

[hakile.xhaferi@rks-gov.net](mailto:hakile.xhaferi@rks-gov.net)

[adelina.maksuti@rks-gov.net](mailto:adelina.maksuti@rks-gov.net)

[shkelqim.duraku@rks-gov.net](mailto:shkelqim.duraku@rks-gov.net)

[belgin.dabiqaj@rks-gov.net](mailto:belgin.dabiqaj@rks-gov.net)

[skender.bajrami@rks-gov.net](mailto:skender.bajrami@rks-gov.net)